përsheptuar²⁸. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se për sa kohë Kuvendi nuk mund të delegojë pushtetin e tij ligjberës, por ka detyrimin kushtetues të përmbushë kërkesat procedurale dhe lëndore për miratimin e ligjeve të cilësuar sipas nenit 81/2 dhe 83 të Kushtetutës, në raport me nenet 1, 2, 4, 7 dhe 116 të Kushtetutës, aq më pak Këshilli i Ministrave mund të ndërhyjë me akte normative me fuqinë e ligjit në ato fusha, rregullimi i të cilave, *expressis verbis*, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit²⁹.

Jurisprudenca kushtetuese ka dhënë kuptim të qartë për termat si nevojë dhe urgjencë, si kushte për nxjerrjen e aktit normativ apo për fuqinë ligjore të këtyre akteve dhe kufizimet në nxjerrjen e tyre³⁰.

Rregullimet e parashikuara nga Kushtetuta, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese paraqesin rëndësi në kontrollin dhe balancën e pushteteve midis pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, pasi duke gjykuar nga mënyra e përcaktimit të saj përcaktohen dhe modelet e qeverisjes shtetërore³¹.

Përfundime

Qëllimi i punimit ishte evidentimi i rëndësisë së mekanizmit të kontrollit demokratik i ushtruar nga parlamenti gjatë qeverisjes së vendit për një shtet sa më demokratik.

Grupet politike përgjithësisht përfaqësohen në komisione në përputhje me peshën e tyre numerike në Parlament. Një vëmendje e veçantë duhet të tregohet për grupet e vogla, në mënyrë që ato të jenë të përfaqësuara në komisione si anëtare ose si vëzhguese. Në pamje të parë krijohet përshtypja se funksioni i kontrollit është atribut ekskluziv vetëm i opozitës. Mos përfshirja reale e grupeve të shumicës në ushtrimin e funksionit të kontrollit zbeh së tepërmi atributin kushtetues të kontrollit nga ana e Parlamentit. Vetëm prania e anëtarëve të opozitës në komisione nuk mjafton për të garantuar një kontroll parlamentar efektiv.

Respektimi i parimeve kushtetuese dhe përmirësimi

aspekteve kryesore të kufizimit të pushtetit ekzekutiv, qoftë nga pikëpamja teorike legislative (kushtetuese-ligjore), ashtu dhe ajo praktike, i shërben procesit të integritetit dhe vetë zhvillimit institucional-administrativ, shtetit të së drejtës, në përgjithësi, dhe qeverisjes demokratike e qytetare, në veçanti.

Secili nga mekanizmat paraqet rëndësi të veçantë në funksionimin e shtetit, por në këtë shkrim dëshiroj të tërheq vëmendjen e rëndësisë së kontrollit parlamentar, i cili është drejtpërdrejt i lidhur me administratën qeverisëse. Me anë të këtij kontrolli, parlamentarët, nëpërmjet komisioneve të përhershme parlamentare, kanë të drejtën të informohen për çështjet e administrimit të pushtetit dhe të zbatimit të ligjeve. Gjithashtu për çështje të caktuara marrja dijoni konsiderohet e nevojshme për realizimin e qëllimeve dhe e detyrave të tyre, por gjithmonë brenda kuadrit të funksionit kushtetues. Ulja e vazhdueshme e efektivitetit të ushtrimit të kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit konsiderohet si përbërësi kryesor i asaj që quhet “*kriza e institucionit të Parlamentit*”³²

Në një shoqëri demokratike kjo mundësi që u jepet parlamentarëve, si përfaqësues të popullit rrjedh nga e drejta për të njohur dhe për të ditur se çfarë bëhet në emrin e tij. Prandaj kontrolli parlamentar ushtrohet edhe në aspektin e të drejtës kushtetuese të çdo shtetasi për të marrë informacionin e nevojshëm për çështjet me interes publik. Organet e pushtetit publik, që i nënshtrohen kontrollit parlamentar, duke transmetuar fakte e të dhëna përfaqësuesve të popullit, përmbushin njëkohësisht detyrimin kushtetues për të qenë transparentë në raport me publikun.

Bibliografia

1. Anastasi Aurela "E drejta Kushtetuese", Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2003.
2. Bufi, Ylli "Tempulli i demokracisë", shtëpia botuese OMBRA GVG, Tiranë 2010
3. *Debati kushtetuese*, Vëllim 1, Tiranë 2006.
4. *Debati kushtetuese*, Vëllim 2, Tiranë 2006.
5. E.Lee Rex. "Vështrime të një juristi për Kushtetutën", Shtëpia Botuese, "Nënë Tereza", Tiranë 2000.
6. Fasso' Guido *Historia e filozofisë të së drejtës*, Shtëpia Botuese "Luarasi" 2005.
7. Loloci Krenar "E drejta Kushtetuese", Shtëpia Botuese "DERADA", Tiranë 1997.
8. Loloci Krenar "Kushtetuta e re dhe nevoja për një mentalitet të ri", Shtëpia Botuese "Horizont" Tiranë 2009.
9. Martinez Temistocle, "*Diritto Costituzionale*" (settima edizione) riveduta e aggiornata, Shtëpia Botuese "Giuttre".
10. Meidani Rexhep "Kushtetuta, bilanci dhe perspektiva", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë, Tiranë 2009.
11. Meidani Rexhep Kushtetuta dhe Probleme të "Mekanikës" Qeverisë
12. Nowicki Antoni Marek "Rreth Konventës Evropiane", Tiranë 2003.
13. Omari Luan "Parime dhe Institucione të së drejtës publike", Botimet "Elena Gjika", Tiranë 2004.
14. *Qeverisja vendore në Shqipëri*, Botim i Shoqatës së Bashkive, Tiranë 2009.
15. Ruso Zhan Zhak "Kontrata Sociale" Shtëpia Botuese "Luarasi" Tiranë.
16. Sadushi Sokol "E drejta Administrative 2", Botimi i Tretë i Ripunuar, Tiranë 2005.
17. Sadushi Sokol "Kontrolli Kushtetuese" Shtëpia Botuese, BOTIMPEX Tiranë, 2004.
18. Sokoli Lekë "Metodat e kërkimit në shkencat sociale", Instituti i Sociologjisë 2009.
19. Traja Kristaq "Drejtesia Kushtetuese", Shtëpia Botuese "Luarasi, Tiranë 2000.
20. Vorpsi Arta "Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese", Tiranë 2011.
21. Zaganjori Xhezair "Demokracia dhe shteti i së drejtës", Shtëpia Botuese "Luarasi" 2000.
22. Zaganjori Xhezair; Anastasi Aurela; Çani (Methasani) Eralda "Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", Tiranë 2011.
23. Akte normative
24. "Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", viti 1978, ndryshuar me ligjin nr.6799, datë 29.06.1983.
25. "Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë", aprovuar nga Asambleja kushtetuese më 14.03.1946.
26. Baza Juridike e Gjykatës Kushtetuese, botuar nga Delta Point Studio, Tiranë 2009.
27. Kushtetua e Shqipërisë me interpretime të Gjykatës Kushtetuese, Botim i Alb Juris, Tiranë 2008.
28. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2009.
29. Ligji nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore Kushtetuese".
30. Ligji nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".
31. Rregullore e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
32. Vendime të Gjykatës e Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
33. Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Referenca

¹ Doktorante në Universitetin e Tiranë, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti Publik. Këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

² Koncepti i shtetit të së drejtës është sanksionuar në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

³ Neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁴ Funksionimi normal i shtetit të së drejtës nuk mund të kuptohet pa ekzistencën e një kushtetute të shkruar, pa njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe pa ushtrimin e veprimtarisë shtetërore në bazë të rregullave kushtetuese dhe ligjore (Referohu Zaganjori, Xhezair, “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 2002.

⁵ Marcel Prelot, (1898-1972), politolog dhe konstitucionalist francez, cituar nga P.Avril, J.Gicquel, *Droit parlementaire, Montchrestien*, Paris, 1996, f.2.

⁶ Neni 96 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon se: *Interpelancë është kërkesa me shkrim drejtuar Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit ose çdo anëtar tjetër të Këshillit të Ministrave, për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave ose lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre.*

⁷ Referohu në nenet 89 deri në 104 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

⁸ Bufi, Ylli “*Tempulli i demokracisë*”, shtëpia botuese OMBRA GVG, Tiranë 2010.

⁹ Referohu në nenin 24 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

¹⁰ Neni 18 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

¹¹ Neni 19 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

¹² Bufi, Ylli “*Tempulli i demokracisë*”, shtëpia botuese OMBRA GVG, Tiranë 2010.

¹³ Parlement danois, Reglement, art. 8.

¹⁴ Referohu në nenin 102 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

¹⁵ Les outils du controle parlementaire, Publie par l’UIP, 2007.

¹⁶ Referohu në ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

¹⁷ Referohu në pikën 1 të nenit 36 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

¹⁸ Referohu pikën 1/1 të nenit 36 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

¹⁹ Referohu në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

²⁰ Referohu në nenin 35 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

²¹ Subjekt i parashikuar nga neni 134 pika c e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

²² Gjykata Kushtetuese parashikohet në pjesa e tretë e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

²³ Referohu në nenin 131 shkronja “a” e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

²⁴ Referohu në nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

²⁵ Neni 101 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: Këshilli

i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

²⁶ Vendim nr.5, datë 05.02.2014 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

²⁷ Referohu në nenet 68 -77 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

²⁸ Referohu në shkronjën “e” të nenit 81, pika 2, të Kushtetutës.

²⁹ Vendim nr.5, datë 05.02.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁰ Referohu vendimit nr.24, datë 10.11.2006 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

³¹ Bufi, Ylli “ Tempulli i demokracisë”, shtëpia botuese OMBRA GVG, Tiranë 2010.

³² *Partitë në Parlament*, seria e hulumtimeve legjislativë, botim USAID, 2005.

³³ PhD candidate at the University of Tirana, Law Faculty, Public Department. Legal adviser at the Constitutional Court of the Republic of Albania.

Parliamentary limitation in the rule of law

Jonida Kondili

■ Abstract

In a democratic system where dominates the principle of the role of law, the governing power must be understood as the limitation of power and not as its growth. The purpose of this paper is to treat the constitutional limits during the government and specifically the restrictions exercised by the legislative body to the governing power. Parliament, like any other institution in the center of his activity as a controller to the government, has the protection of the rights and the freedoms of the citizens. The paper is divided into two parts. The first part treats the concept of limit of the power restrictions, especially the parliamentary limitation. The second part of the paper treats the concept of parliamentary committees, as mechanisms to exercise the function to control the governmental power. Finally, through a review I summarize the conclusions of the paper.



■ Keywords:

Power, Parliament, democratic constraints, parliamentary restriction, the parliamentary committee.



Uarda ROSHI, PhD Candidate
uardaroshi@hotmail.com

Klasifikimi i kontratës së qirasë financiare (leasing) sipas legjislacionit shqiptar

Vështrim i krahasuar me legjislacionet e tjera

3

Abstrakt

Për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe transformimeve të thella dhe të shpejta që po karakterizojnë kohët tona nevojat e bizneseve kanë ndryshuar thellësisht gjatë këtyre viteve. Për të plotësuar dhe për ti bërë ballë nevojave të tregut dhe marrëdhënieve ekonomike në ndryshim po shfaqen forma të reja të marrëdhënieve kontraktore. Në këtë kuptim qiraja financiare (leasing) është një praktikë e re tregtare e cila është zhvilluar me ritme të shpejta në shumë vende të botës përfshirë ekonominë në trazicon dhe ka si qëllim kryesor financimin e investimeve të bizneseve dhe individëve duke u dhënë mundësinë vecanërisht biznesevetë vogla dhe të mesme të përditësojnë të mirat materiale për të qënë sa më konkurrues dhe efikas në tregun vendas dhe te huaj.

Duke qënë një kontratë relativisht e re, komplekse, frut i kërkesave dinamike të operatorëve ekonomik klasifikimi i qirasë financiare (leasing) nuk ka gjetur një interpretim paqësor në doktrinë dhe në jurisprudencë në vende të ndryshme të botës. Vazhdimisht shkrimet doktrinare kanë theksuar rëndësinë e të kuptuarit adekuat të natyrës juridike të qirase financiare (leasing) dhe klasifikimin e saj në të drejtën private. Sqarimi i natyrës juridike paraqetjo vetëm rëndësi torike por kryesisht praktike duke qënë se ndihmon për të lehtësuar integrimin e kësaj forme financimi në sistemin e tëdrejtave dhe detyrimeve në europën kontinentale, përcaktimin e rregjimit fiskal, stimulimin e leasing financiar ndërkombëtar etj.

Në qëndër të këtij punimi është vendosur kontrata e qirasë financiare, e cila është analizuar duke iu referuar Kodit Civil, parashikimeve të ligjit të posacëm, si dhe nënjë vështim krahasues me legjislacionet e tjera. Gjatë gjithë analizës juridiko-doktrinare jam përpjekur ti jap shpjegim pyetjes: Cila është natyra juridike e kontratës së qirasë financiare dhe cili është klasifikimi i saj sipas legjislacionin Shqiptar?

Fjalët kyçe:

Kontratë, leasing, klasifikim, natyre juridike.



1. Origjina dhe evoluimi i kontratës së qirasë financiare

Kontrata e qirasë financiare (leasing) ka njohur një evolucion në trajtim dhe interpretim në raport me marrëdhëniet e tjera kontraktore. Për të kuptuar më mirë kontratën e qirasë financiare është e nevojshme të realizojmë një trajtim juridik në historinë e lindjes dhe zhvillimit të saj.

Është interesant fakti që marrëdhënie *kontraktore* të ngjashme me leasing bashkëkohor, të konceptuara për të përmbushur nevojat e tregtarëve të kohës datojnë që prej periudhës së antikitetit.¹

Këto marrëdhënie qiraje me funksion ekonomik dhe financues, përbëjnë në thelb origjinat e hershme të leasing-ut. Marrëdhëniet e para të qirasë së mallrave me qëllimi (latu sensu) financimi u shfaqën në SHBA gjatë viteve 1700² dhe prej vitit 1870 gjetën shtrirje edhe për mjetet e transportit (si anije, varka dhe lokomotiva).

Kjo skemë financimi është konsoliduar akoma më tej kur kompania prodhuese e makinave qepse “Singer Seeing”, e prezantoi atë si një alternativë të kontratës së shitjes. Rritja e kërkesave të konsumatorëve për një gamë gjithmonë e më të gjerë mallrash bëri që në fillimet e viteve 1900 një numër shoqëri të sillëshin si qiradhënës të pajisjeve duke i dhënë ato me leasing.³ Trajtën e saj bashkëkohore, qiraja financiare (leasing) e ka marrë në SHBA –në e pasluftës së dytë botërore, dhe më pas është importuar me sukses dhe nga vende të tjera të Europës. Në 1954 në SHBA u krijua U. S. Leasing Corporation si kompania e parë që operonte si një shoqëri leasing dhe ofronte shërbime të qirasë financiare identik me

kuptimin që ne i japin sot.

Pas këtij momenti kësaj skeme financimi iu veshën karakteristikat e posacme të një kontrate autonome.⁴

Në fund të viteve 50-të, fillim i viteve 60-të, leasingu financiar filloi të zhvillohej edhe në Europë dhe në vitet 1970 ky koncept lëvizi edhe drejt vendeve në zhvillim të Azisë, Amerikës së Jugut dhe Afrikës. Kompania e parë leasing në Evropë u krijua si rezultat i zgjerimit të kompanive amerikane. Fillimisht është praktika angleze që importoi një skemë të tillë kontraktore në vitin 1960, e më pas në Francë në vitin 1962 u krijua shoqëria e parë leasing e kontrolluar nga një grup bankash dhe shoqëriish sigurimesh. Leasing është transplantuar me sukses edhe në praktikën tregtare italiane në fillimin e viteve 1960 e prej kësaj periudhe ka njohur një zhvillim konstant.⁵ Shoqatat kombëtare të vendeve të mëdha evropiane federohen në Leaseurope.⁶ Vitet 1980 shënuan një njohje të leasing-ut financiar në të gjithë botën.

Në dekadat vijuese zhvillimi i qerasë financiare është konsoliduar, duke penetruar në tregun e instrumentave financiar për të mbuluar nevojat e reja dhe në ritje të bizneseve.

2. Kuptimi dhe pozicioni i kontratës së qirasë financiare në klasifikimin e kontratave

Nga pikëpamja ekonomike qiraja financiare (leasing) mund të përkufizohet si një teknikë financimit për investimet afatmesme dhe afatgjata në të cilën qiradhënësi vendos direkt në dispozicion të qiramarrësit pajisjet në vend të parave të nevojshme për blerjen e tyre. Kontrata e qirasë financiare lindi nga praktikatat tregtare dhe u shëndrua në një instrument të rëndësishëm financimi.

Në disa vende, si Francë, Belgjikë, Spanja, Portugali, Greqi, Turqia, San Marino instituti i qirasë financiare ka gjetur rregullim ligjor në një kohë relativisht të shkurtër.

Ndërsa në disa shtete të tjera për shkak të mungesës së një ligj specifik për rregulimin e kontratës, në zgjidhjen e

konflikteve gjukatat i janë referuar dispozitave të kodeve civile dhe tregtare që rregullojnë llojet e tjera të kontratave.

Në këto raste janë aplikuar herë dispozitat që rregullojnë kontratën e qirasë, e herë të tjera, dispozitat që rregullojnë shitjen e sendit me rezerve pronësie⁷. Për këto arsye në vende të tilla si Gjermani, Zvicra, Austria dhe vendet nordike doktrina dhe jurisprudenca luajnë një rol vendimtarë në rregullimin plotë të kontratës.

Kontrata e qirasë financiare në Shqipëri për herë të parë është rregulluar nga kodi civil i vitit 1994 dhe konkretisht në nenin 849 dhe më pas në mënyrë më të detajuar nga ligji specifik.⁸

Në nenin 849 parashikohet :

“Me kontratën e qirasë financiare, njëra palë detyrohet të vërë në dispozicion të palës tjetër, për një kohë të caktuar, një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, kundrejt një pagese me afate periodike, të përcaktuar në lidhje me vleftën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe, eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve. Sendi duhet të jetë fituar ose të jetë ndërtuar nga qiradhënësi sipas dëshirës dhe përshtimit të qiramarrësit, dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë, në mbarim të afatit të kontratës, kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar. Qiradhënësi përgjigjet ndaj qiramarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e sendit, si dhe për të metat e sendit. Me marrëveshje mund të parashikohet që qiramarrësi, para se të kërkojë nga qiradhënësi të drejtat e tij, duhet t’i drejtohet atij që i dha sendin (furnizuesit) për të drejtat e tij ose që i janë kaluar atij.”

Termi leasing e ka origjinën nga folja angleze “to lease”⁹“qiradhënie”, ose “të japësh me qira”.

Ligji Nr. 9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” i ndryshuar, në nenin I(9) dhe I(II) përcakton dy koncepte:“kontratë së qiraje” dhe “qira financiare”.¹⁰

Pra sic mund të evidentohet lehtësisht legjislatori shqiptar

përdor këto dy koncepte për t'u referuar leasing-ut. Me të drejtë lind pyetja :

- ***Leasing duke qënë një term i lidhur ngushtësisht me një institut të ri, të krijuar dhe të zhvilluar në një vend me gjuhë dhe traditë ligjore të ndryshme nga e jona a është e nevojshme përkthimi i tij në gjuhën shqipe ?***

- ***A janë termat e përdorur (kontratë qiraje, qira financiare), të përshtatshëm për të shprehur të njëjtin koncept të parashikuar nga legjislacioni anglo-sakson ?***

Duke pasur parasysh se “Marrëdhënia mes fjalës dhe konceptit nuk qëndron e njëjtë në të gjitha gjuhët e botës”,¹¹ personalisht mendoj se do të ishte më e përshtatshme që termi mos të përkthehej nga anglishtja ¹² për disa arsye:

- Pikë së pari nuk egziston ndonjë përkthim i termit leasing, nga legjislacioni shqiptar që të mund të konsiderohet i përshtatshëm për të pasqyruar të njëjtin koncept të parashikuar nga legjislacioni anglo-sakson.

- Mendoj se kjo zgjidhje mund të konsiderohet deri diku corientuese sepse në një farë mënyre lidh kontratën e qirase financiare me kontratën e qirasë tipike të parashikuar nga kodi civil, duke krijuar perceptimin e gabuar sikur kemi të bëjmë me mbivendosje. Pavarësisht ngjashmërive me kontratën e qirasë, kontrata e qirasë financiare për shkak të natyresdhe karakteristikave të saj unike gëzon një rregullim të posacëm ligjor dhe duhet të shmanget cdo lloj konfuzioni në praktikë.

- Termi “financiare” mund të krijoj një ide të gabuar mbi objektin e kësaj kontrate, ajo nuk ka për objekt dhe nuk i shtrin efektet mbi sende të konsumueshme, të përcaktuara në gjini (psh të hollat) por vetëm mbi sende të pakonsumueshme dhe individualisht të përcaktuara qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme nëpërmjet teknikës së investimit.¹³ Në ligjin e qirasë financiare kur flitet për sende me afat konsumimi i referohet konsumueshmërisë juridike

dhe në asnjë rast nuk duhet të ngatërohet me sendet e konsumueshme. Konsumueshmëri juridike i nënshtohen të gjitha sendet që vjeterohen me përdorim, psh mjete prodhuese, automjete etj por sende te tilla janë të pakonsumueshme.¹⁴

- Me të drejtë legjislatori ynë në nenin 849 të kodit civil nën titullin qira financiare, ka vendosur në kllapa termin anglo-sakson “leasing”¹⁵ për të orjentuar zbatuesit e të drejtës se kemi të bëjmë me një kontratë leasingu.

- Një zgjidhje e tillë është adoptuar nga shume vende të tjera përfshirë legjislacionin kosovar, në të cilin në ligjin nr. 03/L-103 për Lizingun, miratuar më 25. 06. 2009 përdor termat “lizingu financiar”, “lizingu operativ”, “kontratë lizingu”. Term ky i më i përshtatshëm për të pasqyruar të njëjtin koncept të parashikuar nga legjislacioni anglo-sakson.

Gjithashtu nga interpretimi i nenit I është qartësisht e kuptueshme se lizingu financiar është vetëm një nga llojet e lizingut. Në këtë linjë arsyetimi ligji në fjalë i shtrin efektet vetëm mbi 2 llojet e lizingut atë financiar dhe operativ.

- Dhe si përfundim mendoj se do të ishte zgjidhja më e përshtatshme në kuadër të zhvillimit me ritme të shpejta të leasing-ut ndërkombëtar, ku tregtarët u duhet të përballen jo vetëm me tradita ligjore të ndryshme por edhe me terminologji të ndryshme.

Në çfarë konsiston konkretisht marrëdhënia e qirasë financiare (leasing)?

Në thelb qiraja financiare (leasing) është një marrëdhënie juridike e konceptuar për t'iu përgjigjur nevojave të tre paleve që marrin pjesë në të e përkatësisht: interesit të qiramarrësit (për të përdorur një të mirë), interesit të qiradhënësit (që përfiton një interes ekonomik nga financimi i blerjes) dhe furnizuesit (që përfiton nga shitja e sendit). Qiraja financiare (Leasing) në praktikën tregtare të sistemeve të ndryshme ligjore ka ndjekur një praktikë pothuajse homogjene zbatimiti, duke e vënë theksin në vënein në jetë të një tërësie

veprimesh të nevojshme për realizimin e saj.

Realizimi i qirasë financiare kalon në këto faza :

1. Qiramarrësi i ardhshëm hyn në kontakt me një furnizues dhe identifikon sendin për të cilin ka nevojë duke specifikuar të gjitha karakteristikat dhe vecoritë që bëjnë të mundur dallimin e tij dhe negocion për cmimin.

2. Pasi ezaurohet kjo fazë qiramarrësi kontakton me një subjekt që ushtron veprimtari të qirasë financiare të quajtur qiradhënës dhe i kërkon këtij të fundit blerjen e sendin të zgjedhur prej tij pranë furnizuesit dhe dhënien e tij me leasing.

Kjo kërkesë merr vlerën e një propozimi kontraktor i cili përmban të gjitha elementet thelbësorë të kontratës dhe prodhon efekte juridike vetëm pas pranimit nga ana e qiradhënësit¹⁶

Në këtë rast qiradhënësi e vlerëson në kompleks propozimin e qiramarrësit dhe nëse bie dakort për të gjitha kushtet kjo fazë konkretizohet me hartimin dhe lidhjen e kontratës së qirasë financiare mes tyre. Në kontratë specifikohet kushtet bazë të saj.¹⁷

3. Qiradhënësi më pas njofton me shkrim furnizuesin për blerjen e sendit me qëllim dhënien e tij me leasing dhe lidh me këtë të fundit kontratën e furnizimit.

4. Palët me marrëveshje në kontratën e qirasë mund të parashikojnë që dorëzimi i sendit të bëhet nga qiradhënësi. Nëse dicka e tillë nuk është parashikuar sendi i dorëzohet qiramarrësit nga furnizuesi në vendin, kohën dhe mënyrën e caktuar në kontratën e furnizimit. Gjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë financiare qiramarrësit i kalojnë të gjitha rrisqet dhe perfitimet e lidhura me sendin, ndërkohë që qiradhënësi ruan të drejtën e pronësisë.

Ashtu sikurëse në legjislacionin tonë, në pothuajëse të gjitha sistemet ligjore në përfundim të afatit të kontratës qiramarrësi mund të zgjedh mes tre alternativave :

- a) të ushtrojnë opsionin e blerjes;
- b) të vazhdojnë ta mbajnë sendin me qera për një afat

tjetër;

c) tia kthejnë sendet qiradhënësit;

Megjithatë nuk mungojnë dhe përjashtimet psh: Në ligjin grek nuk përmendet opsionin i blerjes ndërsa në vendet nordike, në Angli dhe në Afrikën e Jugut një opsion i tillë nuk mund të egzistoj për shkak se prezenca e tij do të ndryshonte natyrën juridike të kontratës.

Në legjislacionin shqiptar kontrata e qirasë financiare parashikohet në dispozitat e kodit civil që rregullojnë kontratën e qirasë. Përkatësisht nga neni 826 deri në nenin 849 të Kodit civil parashikohen dhe rregullohen tri forma të vecanta të kontratës së qirasë (qiraja e sendeve me natyrë buqësore, qiraja e mjeteve prodhuese, dhe se fundi qiraja financiare). Kur flasim për lloje të vecanta të kontratave të qirasë do të kihet parasysh që për to do të zbatohen dispozitat e qirasë dhe vetëm për ato pjesë që rregullohen në mënyrë të ndryshme nga kushtet e përgjithshme të saj do të zbatohen dispozitat e posacme të secilit lloj¹⁸.

Në këtë linjë arsyetimi nëse do ti referohemi dhe terminologjisë së pëdorur në ligjin specifik (kontratë qiraje, qiradhënës, qiramarrës etj) konkludojmë në legjislacionin shqiptar kontrata e qirasë financiare është një kontratë e mirëfilltë qiraje dhe si e tillë bën pjesë në grupin e kontratave që shërbejnë për kalimin e nëndorësisë dhe të përdorimit të një pasurie.

Nga ana tjetër ligji për qiranë financiare ka bërë një trajtim të detajuar të kontratës, për më shumë në nenin 5 të tij përcakton natyrën tregtare të qirasë financiare.

Rrjedhimisht lind pyetja a është i drejtë ky klasifikim nga kodi civil apo duhet që kontrata e qirasë financiare të parashikohet si një kontratë e një lloji të vecantë (sui generis)?

Per tju pergjigjur kesaj pyetje duhet me pare te analizojme qellimin ne vetvete te kontrates se qirasë financiare si dhe

lidhjet e saj me kontratat e ngjashme të parashikuara në kodin civil, për të përcaktuar shkallën e ngjashmërisë dhe faktin nëse mund të klasifikohet si një prej tyre apo nëse duhet të klasifikohet si një kontratë më vete.

Disa nga faktorët e rëndësishëm që duhet të mbahen parasysh në përcaktimin e natyrës juridike të kontratës së qirasë financiare janë¹⁹:

- Qëllimi i marrëdhënies juridike të qirasëfinanciare dmth vënia në dispozicion të qiramarrësit të pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteti pa bllokuar kapitalin për blerjen e tyre me pak fjalë i lejon qiramarrësit përdorimin e aktivitet pa bërë menjëherë kalimin e pronësisë. Si cdo praktikë tjetër tregtare që është prodhim i kërkesave të operatorëve ekonomik ka në bazë të veprimtarisë së saj fitimin.

- Mjetet e parashikuara për arritjen e këtij qëllimi, përkatësisht lehtësitë dhe avantazhet ligjore e financiare.

- Roli i pastër financiar i qiradhënësit interesi i vetëm i të cilit qëndron në marrjen e investimit të vet në çmimin e blerjes, plus amortizimin, plus fitimin diferencë të mbuluar nga pagesat totale të qirasë;

- Roli dinamik i qiramarrësit i cili zgjedh vetë pajisjet dhe furnizuesin në pavarësi të plotë prej qiradhënësit.

Konventa UNIDROIT per Leasing Financair Nderkombetar e klasifikon kontratën si një “marrëdhënie të veçantë trelaterale” duke vënë theksin te karakteri inovativ dhe natura e saj sui generis.

Kontrata e qirasë financiare përmban elementë karakteristikë të kontratës së qirasë dhe të shitjes me rezervë pronësie por për shkak të karakteristikave të saj unike diferencohet nga secila prej këtyre kontratave.

Kështu në ndryshim nga kontrata e qirasë,

- qiradhënësi limitohet vetëm me vendosjen e sendit në dispozicion të qiramarrësit por nga ky moment me pranimin e tij të gjitha rreziqet që lidhen me sendin i kalojnë qiramarrësit.

- qiramarrësi në përfundim të afatit të kontratës mund të

ushtroj të drejtën e blerjes së sendit, e drejtë kjo që bie ndesh me natyrën e kontratës së qirasë, dhe që nuk parashikohet asnjëherë të kjo e fundit.

- qiradhënësi është gjithmonë subjekt i posacëm²⁰, ndryshe nga kontrata e qirasë ku subjekt mund të jetë cdo person fizik apo juridik që ka zotësi juridike për të vepruar

- Përgjithësisht kohëzgjatja e kontratës lidhet drejtëpërdrejtë me amortizimin e sendit, apo me natyrën e sendeve të dhëna me leasing.²¹Pra në parim kohëzgjatja e kontratës i korrespondon jetës ekonomike të sendit. Në këtë linjë arsyetimi duke pasur parasysh amortizimin e sendit në fund të kontratës, dhe faktin se qirradhënësi ka marrëkuivalentin e çmimit të sendit, pavarësisht nëse parashikohet apo jo opsioni final për ta blerë sendin palët ndjekin një qëllim ekonomik të ndryshëm nga kontrata e qirasë.

- Me zgjidhjen e kontratës para kohe për mosplotësim të detyrimeve nga ana e qiramarrësit, ose falimentim të tij sendi i kthehet qiradhënësit i cili mban kuotat e papaguara me pretendime për ato të pashlyera që aktualisht u ka kaluar afati.

Dallon nga kontrata e shitjes me rezervë pronësie cila ka për qëllim kalimin e pronësisë, (shitjen e një sendi duke paguar çmimin me këste) në të kundërt në rastin e kontratës së qirasë financiare kalimi i pronësisë në përfundim të afatit të kontratës përbën një eventualitet dhe qiramarrësi mund ta ushtroj ose jo këtë të drejtë.

Gjithashtu në rast se kontrata zgjidhet para afatit për faj të qiramarrësit pagesat e qirasë nuk do të trajtohen si këste blerje dhe shlyerja e tyre nuk krijon të drejta pronësie.

Një tjetër ndryshim lidhet gjithashtu me cilësinë e palëve kontraktuese, ku si e përmendëm dhe më lart në kontratën e qirasë financiare qiradhënësi është gjithmonë subjekt i posacëm. Kontrata e leasingut financiar lidhen kryesisht ndërmjet profesionistëve dhe sipërmarrësve në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së tyre.²²Njëkohësisht sendi që përdor qiramarrësi është zgjedhur e ndërtuar nga furnizuesi

sipas kërkesave të qiramarrësit, kusht ky që nuk parashikohet për bleresin te kontrata e shitjes me rezervë pronësie.

Pra pavarësisht ngjashmërive me kontratat e tjera të parashikuara në kodin civil, kontrata e qirasë financiare për shkak të karakteristikave të saj unike diferencohet nga secila prej tyre. Gjithashtu në klasifikimin e kontratës duhet të mbahet parasysh natyra financiare dhe relatiteti ekonomik i lindjes dhe zhvillimit të saj. Bashkohemi me mendimin se nuk kemi të bëjmë me një kontratë klasike të së drejtës së detyrimeve por me një kontratë e cila është formuar në bazë të praktikës ndërkombëtare afariste.²³

3. Vështrim krahasues me legjislacionet e huaja

Kontratat e para të leasing u shfaqën në Francë në fillim të viteve 60", më saktësisht në vitin 1962 me propozimin e tyre nga Locafrance. Legjislatori francez vetëm pak vite pas shfaqes të leasing-ut në praktikat tregtare, përkatësisht në 2 korik të vitin 1966 miratoi ligjin nr. 455 që bënte një rregullim të posacëm (ad hoc) të saj me një term krejtësisht të ri e pavarur, atë të "crédit-bail"²⁴

Shtyja për miratimin e një ligji ad hoc përvec qëllimit për të ofruar një përcaktim dhe rregullim të qartë të këtij institutit të ri kishte si qëllim vecanërisht kontrollin publik dhe efikas të shoqërive që operonin në fushën e leasing-ut. Termi i përdorur nga legjislatori francez crédit-bail shërben për individualizimin e kontratave të leasingun që kanë për objekt vetëm sendet (mallrat, pajisje kapitale) të desitinuara për përdorim profesional, dhe që përfaqësojnë sot prototipin kontraktual në kuadër të një gjinie komplekse kontratash të klasifikuara si kontrata leasingu. Në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës ofrohet mundësia për të blerë plotësisht apo pjesërisht sendin objekt kontrate në bazë të cmimit të paracaktuar paraprakisht (në të cilin përfshihen të paktën pjesërisht pagesat periodike).²⁵ Nga ky përkufizim është lehtësisht e kuptueshme fakti se objekt i kontratës mund të jenë vetëm sendet e desitinuara për përdorim profesional

pavarësisht natyrës së tyre si sende të luajtshme²⁶ apo të paluajtshme²⁷. Pra vihet re se sendet objekt kontrate, duhet të kërkohen në kuadër të ushtrimit të një aktiviteti tregtar (profesional) dhe nuk ka rëndësi natyra e tyre nëse janë të luajtshme apo të paluajtshme, materiale ose jomateriale, të reja apo të përdorura.

Nga ky fakt nënkuptohet se qiramarrës në kontratën e crédit-bail mund të jenë vetëm personat juridik, shoqëritë tregtare dhe kompanite, dhe këtë cilësi nuk mund ta ketë një person fizik që nuk është i regjistruar dhe që nuk ushtron një aktiviteti tregtar.²⁸

Subjekte që mund të ofrojnë shërbime të crédit-bail sipas të drejtës franceze janë gjithmonë të posacëm, banka ose institute financiare. Pra është kusht i domosdoshëm që ky i fundit të vishet me një formë të vecante juridike të parashikuar shprehimisht në ligj që të legjitimohet si palë në kontratë. Mosrespektimi i kësaj dispozite e bën kontratën të pavlershme, dhe ndaj subjektit parashikohet mundësia e aplikimit të penaliteteve.

Në fazat e para të zbatimit të kontratës, jurisprudenca franceze ka bërë një interpretim literal të përkufizimit ligjor të Crédit-bail, duke mohuar mundësinë e aplikimit të tij për formë të tjera kontratash si :²⁹

- Leasing- fabricant (qiranë financiare të drejtëpërdrejtë) (sipas së cilës qiradhënësi është në të njëjtën kohë dhe pronar i sendit dhe që lidh kontratën me qiramarrësin)
- Crédit-bail addossé (ku një prodhues merr në crédit-bail prodhimin e tij me qëllim dhënien e tij me leasing klientëve)

Megjithatë autorë të tjerë³⁰ kanë shfaqur mospajtimin e tyre me këtë interpretim, duke e vënë theksin në mungesën e një arsye të vlershme për një përjashtim të tillë. Për të plotësuar këtë vakum ligjor të krijuar është e nevojshme interpretimi ekonomik i dispozitave ligjore, të cilat e pozicionojnë crédit-bail mes qirasë dhe shitjes me kredi, duke nxjerr në pah natyrën financuese të vetë kontratës. Kjo pikëpamje ka gjetur mbështetje të gjerë në doktrinë.

Për shkak të kooegzistencës në kontratën e leasing-ut të elementëve të dy a më shumë kontratave, doktrina franceze e ka përcaktuar në mënyra të ndryshme e konkretisht :

- si një kontratë hibride
- si një bashkim i padukshem i shume kontratave (shitje, qira, propozim i njëanshëm shitje).
- një teori tjetër shumë e përhapur është dhe (teoria e grupeve te kontratave) sipas secilës qiraja financiare përbëhet nga një tërësi kontratash të njëanshme dhe me strukture komplekse, ku jo të gjitha kontratat kanë të njëjtën rëndësi, por egziston nje kontratë kryesore e nevojshme per realizimin e qëllimit final të marrëdhënies komplekse të leasing.³¹

Pavarësisht përhapjes së shpejtë në praktikat tregtare, sidomos në disa sektorë të vecantë si në tregun motorik, në Gjermani instituti i leasing nuk ka gjetur ende një rregullim ad hoc duke ia lënë vendin përcaktimeve pothuajëse uniforme të jurisprudencës dhe doktrinës.

Praktika gjyqësore dhe doktrina në përpjekje për të plotësuar hendekun ligjor të krijuar ka analizuar natyrën juridike të kontratës. Pikëpamja që ka gjetur më shumë mbështetje edhe mes gjyqtarëve është ajo që e kalsifikon kontratën si qira (Miete) sipas ish nenit 535 BGB.³² Duke qënë se elementi më i rëndësishëm i kontratës ka të bëjë me kalimin e së drejtës së përdorimit të një të mire dhe faktin se opsioni i blerjes përbën vetëm një eventualitet dhe nuk është gjithmonë pjesë e kontratës. Gjykata e kasacionit në gjermani (Bundesgerichtshof) në një vendim të saj nga njëra anë i jep rëndësi përfshirjes në tekstin e kontratës të së drejtës dhe mundësisë së qiramarrësit për të blerë sendin në përfundim të periudhës së kontratës, nga ana tjetër parashikon se ky opsion nuk është i mjaftueshëm për ta larguar në mënyrë përfundimtare nga poli i qirasë.

Klasifikimi i kontratës ka rëndësi prioritare për arsye se në varësi të tij do të përcaktohen dhe dispozitat e aplikueshme për institutin. Nëse pranohet natyra atipike e kontratës do ti referohemi kryesisht kushteve të përgjithshme

të kontratave, dhe nëse klasifikohet si qira është e nevojshme dhenia e argumentave për të interpretuar dispozitat që janë haptazi të papajtueshme me qiranë e zakonshme të parashikuar ne BGB.

Leasing në europë ka gjetur zbatim për herë të parë në Angli.³³Një element i vecantë i institutit të leasing në Angli është mosparashikimi i opsionit të blerjes së sendit në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës. Element ky që diferencon automatikisht leasing nga marrëdhëniet të tjera kontraktore (shitje me kusht, shitje me keste).³⁴Në hipotezën e parashikimit në kontratë të mundësisë së qiramarrësit për blerjen e sendeve do të ndryshonte tërësisht natyra juridike e kontratës, dhe nuk do të ishim më para një kontrate leasing, por përpara një kontrate (shitje me keste) hire –purchase.³⁵

Në Zvicer instituti i leasing nuk ka gjetur ende një rregullim ad hoc ndërkohë që mungon një interpretim paqësor i doktrinës dhe një linjë unike e vendimeve të gjykatës. Qirasë financiare leasing klasifikohet si kontratë sui generis, e cila përfshin në gjirin e saj elemente të qirasë, kontratës së shitjes me këste dhe kredisë. Në varësi të mbizotërimit të këtij apo atij elementi gjykatat zviceriane në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zbatojnë dispozitat e kontratave tipike të sipërpërmenduar.

Ne Itali kontrata leasing klasifikohet si një kontratë jotipike që ndërvihet midis sipërmarrjes-dhënëse dhe përdoruesit, në bazë të së cilës:³⁶

a) Sipërmarrja-dhënëse detyrohet që ti lejoj përdoruesit gëzimin e sendit për një afat të caktuar që zakonisht është më i vogël se afati i parashikuar i jetës ekonomike të së mirës materiale. Gjithashtu në favor të përdoruesit mund të jetë njohur e drejta e zgjatjes të afatit të kontratës ose në mbarim të afatit të kontratës e drejta për të fituar pronësinë. Është pikërisht kjo e drejtë që e largon këtë lloj kontrate nga skema e kontratës së qirasë dhe e afron atë me kontratën e blerjes me rezervë pronësie të përcaktuar nga neni 1523.

b) Përdoruesi nga ana e tij merr përsipër të gjitha rreziqet

në lidhje me sendin, (humbjen shkatërrimin etj) dhe detyrohet ti jap sipërmarrëjes-dhënëse një qira periodike, vlerë e cila tenton në lidhje me kohëzgjatjen e kontratës që të përputhet me vlerën kapitale të së mirës materiale, sëbashku me interesat përkatëse, kuotat e rrezikut e të fitimit të sipërmarrjes leasing. Gjithashtu në rastin e kohëzgjatjes së kontratës mund të jetë parashikuar një qira më e reduktuar nga ajo që duhej fillimisht ose në rastin e një opsioni blerjeje një cmim i vecantë.

Konkluzione

Qiraja financiare është një marrëdhënie juridiko-ekonomike komplekse e konkretizuar në dy kontrata autonome të lidhura në mënyrë funksionale dhe kronologjike mes tyre përkatësish : 1. Kontrata e qirasë financiare dhe 2. Kontrata e furnizimit. Kontrata e qirasë financiare është konceptuar për t'iu përgjigjur nevojave të tre paleve që marrin pjesë në këtë marrëdhënie juridike e përkatësisht: interesit të qiramarrësit (për të përdorur një të mirë), interesit të qiradhënësit (për të përfituar një interes ekonomik nga financimi i blerjes) dhe furnizuesit (që përfiton nga shitja e sendit). Nëpërmjet kësaj metode financimi bizneset mund të rinovojnë teknologjinë në mënyrë periodike pa bllokuar kapitalin e nevojshëm për blerjen e tyre dhe pa qenë e nevojshme të plotësojnë këkesat e një kredie bankare për kolateral apo garanci.

Në lidhje me klasifikimin e leasing konstatohet një qëndrim i diferencuar: Nga njëra anë vihet re tendenca e vendeve common law për ta kualifikuar kontratën si shitje me rezervë pronësie, e nga ana tjetër qëndrimi i vendeve romano-gjermaike të cilat pavarësisht nga shumëllojshmëria e pikëpamjeve të shprehura dhe ndërgjegjësimit për elementët diferencues e të vecantë të institutit, kanë mbështetur më shumë egzistencën e një lidhje mes leasing-ut dhe qirasë. Sipas një tjetër qëndrimi kontrata e qirasë financiare klasifikohet si një kontratë autonome e ndryshme

nga llojet e tjera te kontrave tradicionale të parashikuara në kodin civil përfshirë këtu edhe kontratën e qirasë. Në legjislacionin shqiptar kontrata e qirasë financiare parashikohet në dipozitat e kodit civil që rregullojnë kontratën e qirasë si një nga llojet e saj.

Megjithatë jemi të mendimit se natyra tregtare dhe karakteristikat e saj unike i japin kësaj kontrate origjinalitetin për të qëndruar si një kontratë me vete, duke bërë që të diferencohet nga kontratat e tjera të parashikuara në Kodin Civil. Në lidhje me terminologjinë e përdorur në ligjin e posacëm për qiranë financiare mendoj se do të ishte më e përshtatshme që termi mos të përkthehej nga anglishtja.

Në vitet në vijim pas miratimit të ligjit për qiranë financiare, nuk kemi pasur një zhvillim të konsiderueshëm të tregut të leasing-ut në krahasim me trendin e zhvillimit në vendet e tjera. Në Shqipëri qiraja financiare është ende në hapat e parë të trajtimit teorik dhe ka gjetur zbatim të koncentruar kryesisht në tregun motorik. Mungesa e informacionit mbi avantazhet e leasing-ut, infrastruktura ligjore, sistemi bankar, mungesa e studimeve ligjore në këtë fushë kanë qënë ndër faktorët kryesor që kanë cuar në moszhvillimin sa duhet të leasing-ut.

Literatura

- G. De Nova, *Il Leasing (hire and purchase)*, Milan, Giuffrè 1982
- Oxford advanced learner's dictionary of current english, Oxford, 1991
- R. Sacco "Introduzione al diritto comparato"
- Esperienze straniere in tema di locazione finanziaria, in Buonocore, Fantozzi, Alderighi, Ferrarini, *Il leasing*.
- Nuni, A. (2009). "E drejta Civile". TIRANË.
- Tutulani - Semini, M. (2006). " E drejta e detyrimeve dhe e kontatave" Pjesa e Posacme, TIRANË.
- Tutulani -Semini, M. (2006)" E drejta e detyrimeve dhe e kontatave" Pjesa e Përgjithshme,TIRANË.
- Lamani, A. (1962). "Procedura civile e Republikës së Shqipërisë" TIRANË.
- Shehu, A. (2000) "Pronësia", TIRANË.
- Mehdi J. Hetemi, « Detyrimet e kontratat », shtëpia botuese « Luarasi » Tirane, 1998
- UNIDROIT, Report on the contract of leasing (credit-bail) Rome, March 1975, Study LIX-Doc 1
- M, Albanese & A, Zeroli. (2012). "Leasing e Factoring". MILANO.
- L, ÉANG. (2011). "Une Analyse Juridique Sur Le Crédit-Bail"
- J, Vasili. (2009). "Kontrata Civile Jotipike", TIRANË.
- Profili privatistick e tributari, Giuffrè, 1975
- Francesco Galgano " E drejta Private" Luarasi, Tirane 1992
- Frignani A, *Leasing finanziario internazionale: analisi comparata*, in Contratti, 2000,
- DE NOVA G, *Nuovi contratti*, Torino, 1990
- Irena Plaku, Teza « Kontrata e qirase », ne kuader te marrjes se titullit « Magjistrat » , Tirane 201
- www.cscanada.net

Legjislacioni

- Convention on International Financial Leasing in 1988 Ottaëa: International Institute for the Unification of Private Law (UNIDROIT).
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 9396, datë 12.05.2005 "Për qiranë financiare" i azhurnuar me: Ligjin Nr.9823, datë 29.10.2007 & Ligjin Nr.9966, datë 24.7.2008.
- Ligj nr. 33/2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme"
- Cass.Civ. Sez, III, n.20592 del 29/09/2007

Referenca

¹Zbulimet arkeologjike në vitin 1983 në qytetin e lashtë sumeriane të Urit dokumentojnë egzistencën e formave të leasing që prej vitit 2010 para erës sonë. Këto forma fillestare të leasing-ut përfshinin kalimin me qira të tokës dhe veglave bujqësore individëve duke mundësuar në këtë mënyrë kultivimin dhe shitjen e prodhimeve të tyre me investime minimale. Në vitin 1750 para erës sonë mbreti Babilonas, Hamurab, impementoi ligjin e parë mbi qiradhënien të pasurisë së luajtshme.

Kulturat të tjera të kohëve të lashta, të tilla si Egjiptasit, grekët dhe romakët, kanë qenë të angazhuar në marrëdhënie qiraje që përfshinin sende të luajtshme e të paluajtshme. Në mijëvjeçarin e tretë para erës sonë në Egjipt pronarët jepnin me qira tokën me të gjitha pajisjet, skllëvërit dhe armatimet në këmbim të pagesës së taksave periodike.

Qiradhënia e anijeve ka qenë një fenomen në lulëzim që nga koha e fenikasëve. Lidhja e kontratave nëpërmjet së cilave një ose disa pjesë apo vetë anijet jepeshin me qira për një udhëtim, ose për një kohë të caktuar. Kjo marrëdhënie qiraje ka qenë në fakt një formë e pastër e leasing-ut të pajisjeve. Në rastin e lidhjes së kontratës për një afat të shkurtër vishej me tepër me tiparet e lisingut operativ. Ndërsa merte tiparet e qirasë financiare, në rastet kur kontrata lidhej për një afat të gjatë që zakonisht mbulonte pjesën më të madhe të jetës ekonomike të sendit. Në këto raste qiramarrësi ndonëse nuk kishte titullin e pronësisë gëzonte të gjitha të drejtat e detyrimit e pronarit.

²Trasaksione qiraje me qëllim financimi (që kishin si objekt kryesisht qere e kuaj) janë evidentuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fillim të shekullit të XVIII.

³Në 1900 kjo formë qiraje me qëllim financimi shtrihet në fusha të tjera (financimin e mjeteve të transportit masiv), fakt ky që ndikoj në zhvillimin me ritme të shpejta të shoqërive të leasingut si Union TNK Car dhe North American Car duke i shëndruar këto të fundit në furnizues të fuqishëm të shërbimeve të tilla.

Në mënyrë analoge shoqëria e telekomunikacionit “Bell Telephon System” filloj të praktikoj përveç shitjes qiradhënien e produkteve të saj.

⁴Me 1962 u krijua “American Association of Equipment Lessors, (AAEL)” që synon promovimin e leasingut në krahasim me disiplina të tjera analitike e në të njëjtën kohë, shoqëri si Xerox e IBM ndihmuan nëpërhapjen e përdorimit të leasingut.

Që prej vitit 1970, për shkak të një reduktim të dukshëm të normës së interesit në tregun e shërbimeve financiare, edhe bankat zgjeruan gamën e produkteve të ofruara me qira financiare.

⁵Më konkretisht nëse në vitin 1966 shuma e investimeve të financuara me leasing kapte vlerën 2 miliardë lire, në vitin 1980 kjo vlerë kapi vlerën e 1200 miliard, dhe vlerën 33.361 miliardë në vitin 1990.

⁶Leaseurope, Federata Evropiane e Shoqatave të kompanive leasing (e cila u themelua në vitin 1972 dhe përfaqësojnë një organ ombrellë që përfshin shoqatat anëtare për industrinë e leasing-ut në 33 vende)

⁷G. De Nova, *Il Leasing (hire and purchase)*, Milan, Giuffrè 1982, fq 493.

⁸Ligjinr. 9396, datë 12.05.2005 “Përqiranëfinanciare” I azhurnuar me: Ligjin Nr.9823, datë 29.10.2007 & Ligjin Nr.9966, datë 24.7.2008

⁹Oxford advanced learner’s dictionary of current English, Oxford, 1991, faqja 710.

¹⁰ nenin 1(9) - "Kontratë qiraje" është kontrata e qirasë financiare, që lidhet ndërmje qiradhënësit dhe qiramarrësit për përdorimin e sendit për një afat, sa pjesa më e madhe e afatit të konsumimit të sendit, përkundrejt pagesave periodike, shuma e të cilave është sa vlera reale në treg e sendit, por që arrin të mbulojë investimin e qiradhënësit dhe të sigurojë një fitim mbi investimin.

Nenin 1(11)- "Qirafinanciare" është marrëdhënia juridike, sipas së cilës qiradhënësi i blen furnizuesit një send të përzgjedhur nga qiramarrësi pranë furnizuesit dhe i aje patë qiramarrësit për ta përdorur për një afat të caktuar, kundrejt një çmimi të caktuar në kontratë dhe, me mbarimin e afatit të kontratës, qiramarrësi mund ta blejë sendin, të vazhdojë ta mbajë me qira për një afat tjetërose t'ia kthejë atë qiradhënësit

¹¹R. Sacco "Introduzione al diritto comparato" faqja 33.

¹²R. Sacco "Introduzione al diritto comparato", faqja 41-42 në lidhje me përkthimet ligjore,

"E drejta e krahasuar ka pranuar tre qëndrime që duhen të mbahen parasysht në rastin e përkthimeve ligjore :

- mund të heqë dorë nga përkthimi kur ky është i panevojshme dhe / i gabuar;
- të mund të identifikojë dallimet mes termit për të përkthyer dhe termit më të afërt në gjuhën në të cilën do përkthehet për të tu siguruar që diferenca të tilla të jenë të parëndësishme dhe vetëm pastaj të vazhdoj me përkthimin,
- të mund të krijoj neologjizmin e posacem për të shprehur kuptimin e termit të huaj."

¹³Revista "Jeta Juridike", Subjekte të kontratës së qirasë financiare (leasing), faqje 28.

¹⁴A.Shehu, Pronësia 2000, fq 11.

¹⁵Termi leasing është një koncept më i gjerë se qiraja financiare i cili në gjirin e tij përfshin leasing financiar, leasing operacional, leasing aksionar, leasingu bujqësor (agrikultural), leasingu lease-back, leasingu detar (naval), leasingu ajror (ëet lease dhe dry lease), leasingu i pasurive të luajshme dhe të paluajshme (imobilar), leasingu instrumental dhe shumë forma të reja të lindura nga praktikat tregtare. Qiraja financiare (leasing financiar) është vetëm një nga llojet e leasing-ut.

¹⁶M. Albanese, A. Zeroli, "Leasing e Factoring" 2012, fq 27-28

¹⁷Neni 12, Ligji nr. 9396, datë 12.05.2005 "Për qiranë financiare" i azhurnuar me: Ligjin Nr.9823, datë 29.10.2007 & Ligjin Nr.9966, datë 24.7.2008

¹⁸M. Tutulani Semini " E drejta e detyrimeve dhe e kontaktave" pjesa e posacme, 2006, fq 65

¹⁹ UNIDROIT, Report on the contract of leasing (credit-bail) Rome, March 1975, Study LIX-Doc 1, page 25

²⁰Qiradhënësimund të jetë vetëm banke, institucion financiar, apo person juridik i cili kryen vetëm veprimtari të kontratës së qirasë financiare dhe plotëson kushtet ligjore në lidhje me kapitalin e regjistruar.

²¹Përshebullohet përsendet e luajshme me afatkonsumimideri ne pesëvjetparashikohetnjëafat minimal tëpaktënnjëvjecar, përsendet e luajshme me afat konsumimi mbi pesë vjet parashikohet një afat të paktën dy vjecar dhe një afat të pakten tre vjecar për sendet e paluajshme

²²Nukpërjashtohetmundësiaqëqiramarrësitëjetë person fiziki pa regjistruar për zhvillimin e një veprimtarie tregtare, në këto kushte neni 5 i ligjit për qiranë financiare ka parashikuar se kontrata do të vlerësohet jo tregtare dhe do tu nënshtrohet rregullave të përgjithshme të kontratave.

²³ Mehdi J. Hetemi, «Detyrimet e kontratat », shtepia botuese « Luarasi » Tirane, 1998, faqja 349.

²⁴Duhetdiferencuarngracredit-bail :

a) la location avec option d'achat (qiraja me opsionin e blerjesnepërfundimtekohëzgjatjessëkontratësqë ka si objektvetëmallrat e destinuarapërpërdorimpersonaldhefamiliar)

b) la location de lungedurëe (qiraja me kohëzgjatjetëgjatëqëpërbënnjë instrument tërëndësishëmfinancimiporqë nukparashikonopsionin final tëblerjes)

²⁵Ngapërkufizimi i kontratësevidentohen 3 elementëesencialë: Blerja e sendit (mallrave, pajisiekapitale) nga (crédit-bailleur) qiradhënësime qëllimdhëniennëpërdorim, dhenia me qirafinanciare (bail) qiramarrësit kundrejtpagimit të pagesave periodike, parashikimi gjithmonë në favor të qiramarrësit e mundësisëpërtëblerësendinnëpërfundimtekohëzgjatjessëkontratës, përnjëcmimtëparacaktuarqëpërfshinedhepagesatperiodketëpaguara

²⁶ - bien d'équipement si si kompjutera fotokopje dhe pajisje te tjera te te njejtit lloj.

- matériel d'outillage pajisje te tjera te te njejtit lloj apo pajisje mekanike si traktor, vinc etj

²⁷ - të destinuara për përdorim profesional

²⁸- Megjithate personat fizik mund te lidhin kontrata « locations avec option d'achat », e thënë në mënyrë sipërfaqësore në shqip “qiraja me opsionin e blerjes”.

²⁹ LUCAS DE LEYSSAC C. - La giurisprudenza sul leasing in Francia, in La giurisprudenza sul leasing in Europa, a cura di G. SBISÀ e D. VELO, Milano, 1984, faqja 80

³⁰ LUCAS DE LEYSSAC C. - La giurisprudenza sul leasing in Francia, in La giurisprudenza sul leasing in Europa, a cura di G. SBISÀ e D. VELO, Milano, 1984, faqja 82

³¹ BERNARD TEYSSIE, Les groupes de contrats, 1975, 128

³²Pavarësisht se jurisprudenca ka pranuar përgjithësisht teorinë e klasifikimit të leasing si qira, nuk kanë munguar dhe kritikant nga doktrina të shoqëruara me propozime për kuadrin ligjor të kontratës. Disa si (P.Plathe) e klasifikojnë leasing si shitje për aq kohë sa kemi kalimin e të drejtës së pronësisë në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës. Të tjerë si (G. Stoppok) e konsiderojnë leasing si një kontratë sui generis.

³³ R. Goode, Commercial law, Oxford, 2004, 721, Industria e leasing- ut është sofistikuar gjithnjë e më shumë me kalimin e viteve duke i hapur rrugën shfaqes së llojeve të shumta të saj te projektuar për të plotësuar nevojat e ndryshme të biznesëve që operojnë në sektorë të ndryshëm. Edhe në angli, kontrata ka gjetur kryesisht zbatim për përdorimin e pajisjeve per arsye profesionale, dhe ka patur sukses në sektorin publik kryesisht ne ate te pushteti lokal.

³⁴Autonomi kjo shumë më e vështirë për tu përcaktuar dhe interpretuar në legjislacione të tjera.

³⁵Është një kontratë sipas të cilës pronari i kalon posedimin e sendeve qiramarrësit që merr përsipër të paguajë një tarifë periodike me opsionin për të blerë ato në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës.

³⁶ Francesco Galgano “ E drejta Private” Luarasi, Tirane 1992, faqja 545

Classification of financial leasing contract according to albanian legislation. Overview compared with other jurisdictions

Uarda ROSHI, PhD Candidate
uardaroshi@hotmail.com

Abstract

Due to technological developments and profound transformations over the years the business needs have changed radically. For coping with the market needs and the changing economic relations new forms of contractual relationships have emerged. In this context financial leasing is a new trading practice which is developing rapidly in many countries all around the world including the economies in transition, and aims mainly to finance the investments of the businesses and individuals enabling in particular small and medium businesses to update their material goods in order to be more competitive and efficient in the domestic and international market. Being a relatively new contract, product of the dynamic requirements of the economic operators, the classification of financial leasing has not found a peaceful interpretation in doctrine and jurisprudence in various countries of the world. Doctrinal writings have repeatedly emphasized the importance of an adequate understanding of legal nature of the financial leasing and its classification in private law. The clarification of the legal nature shows not only theoretical importance but mainly practical since it helps to facilitate the integration of this form of financing in the system of rights and obligations in continental Europe, defining the fiscal regime, promoting international financial leasing etc. This paper aims to provide a theoretical analysis of financial leasing, which is analyzed by referring to the Civil Code, the provisions of the specific law "On financial leasing", as well as in a comparative overview with other legislations. Throughout the doctrinal and legal analysis I have tried to give explanation to the question: What is the legal nature of financial leasing contract and what is its classification under Albania law?

Fjalët kyçe:

contract, leasing, classification, legal nature.



Dr. Indrit SHTUPI
Lektor
ShLUIJ "Wisdom Univeristy"

Dr. Arjan QAFA
Inspektor
"Këshilli i Lartë i Drejtësisë"

Kuadri kushtetues dhe ligjor në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, kundër diskriminimit

■ Abstrakt

Ky artikull ka për qëllim që të identifikojë një nga çështjet më të diskutueshme aktuale në fushën e të drejtave të njeriut, siç është diskriminimi. Kjo hapësirë e ligjit po përballlet sot me ndryshime të shpejta, mënyra të reja të së menduarit dhe jetuarit, të cilat na bëjnë që të reflektojmë në drejtim të njohjes dhe respektimit të së drejtave të individit, si dhe në lidhje me instrumentet e përdorura për mbrojtjen e tyre. Nëpërmjet këtij artikulli shkencor synohet prezantimi i zhvillimeve më të fundit, sidomos pas ligjit kundër diskriminimit dhe ndikimit që ka ky mbi shoqërinë shqiptare. Qëllimi për këtë temë është studimi i asaj që përfaqëson kuadri aktual kushtetues dhe ligjor mbi diskriminimin dhe asaj çka ky jep në luftën kundër këtij fenomeni si dhe i instrumenteve që do të përdoren dhe për t'u mbrojtur nga individët ose grupet e interesit. Gjithashtu nevojitet që të trajtohen në mënyrë të detajuar aspektet aktuale ligjore dhe kushtetuese të luftës kundër diskriminimit.

Fjalët kyçe:

Kushtetuta, diskriminimi, parimi i barazisë, të drejtat e njeriut, Bashkimi Europian, direktiva





1. Hyrje

Aspekti ligjor i luftës kundër diskriminimit është përmirësuar kohët e fundit me miratimin e një ligji që përpiket të adresojë këtë problem shoqëror. Në këtë kuadër do të shikojmë ç'farë parashikon kushtetuta në lidhje me barazinë e shtetasve dhe në lidhje me fenomenet diskriminuuese. Duke pasur dëshirën e mirë për të patur një vështrim të thelluar jo vetëm mbi aspektin formal të këtyre parashikimeve ligjore si kuadri kushtetutes dhe ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë kundër diskriminimit por dhe fushat ku ai e shtrin veprimtarinë e tij si dhe mjetet efektive që duhet të përdorë një individ që preket nga diskriminimi.

2. Një vështrim i përgjithshëm mbi diskriminimin, nocioni juridik i diskriminimit dhe kuptimi i tij

Diskriminimi ka ekzistuar qysh herët në historinë e njerëzimit. Sa i vjetër është si fenomen, po aq i larmishëm është në shumëllojshmërinë e shfaqjes së tij.¹ Në të vërtetë, ato që e ngritën dukshëm këtë fenomen si një problem në shumë plane të politikave sociale, qenë lëvizjet e shekullit XX. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, nën dritën e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror, u vu re se diskriminimi ishte një ndër shkaqet kryesore, si pasojë e të cilit individët nuk gëzonin dot plotësisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

Në shoqëritë shqipëtare, edhe pse jo në nivele shumë të larta mund të dallohen prirje të cilat kanë tipare

diskriminuere. Faktorët janë të shumtë dhe nuk duhen anashkaluar *faktori historik, kulturor dhe gjeografik*. Karastikat kryesore në marrdhëniet familjare në shoqërinë shqipëtare kanë qënë një ndarje e roleve në familje duke krijuar në një farë mënyre një pozitë dominuese të burrit në familje ndaj gruas duke krijuar steriotipe dhe në marrdhëniet në vazhdim.

Kur dëgjojmë fjalën “diskriminim”, shpeshherë bëjmë lidhjen me trajtimin jo të barabartë në familje e shoqëri të grave dhe vajzave, të të miturve dhe të moshuarve, trajtimin jo të mirë që u bëhet komuniteteve, si atij rom, egjiptian, LGBT,² në raport me persona të tjerë. Në të vërtetë, si në Shqipëri, ashtu dhe kudo në botë, ka edhe shumë individë e grupe individësh që diskriminohen për arsye të shumëllojshme. Klima sociale, politike dhe akademike ndikon në rritjen apo në uljen e tendencave për shfaqjen e sjelljeve diskriminuere në një shoqëri të caktuar. Mungesa e kohezionit social dhe e kujdesit për të gjitha grupet apo shtresat e një shoqërie përbën një element të rëndësishëm që prodhon diskriminim, pa harruar të përmendim këtu edhe faktorin historik të përcjelljes së zakoneve apo traditave me ngjyrimë diskriminuere për kategori të ndryshme të shtetasve.

Ka shumë përkufizime të konceptit të diskriminimit, të cilat derivojnë nga këndvështrime të ndryshme që i atribuohen trajtimit të tij.³ Megjithatë, ajo çka i bashkon, është fakti që, nëse flasim për diskriminim, gjithmonë gjejmë ‘dallim’ në trajtimin e personave ose të subjekteve të ndryshme, si sjellje negative në shumicën e rasteve, por edhe pozitive, në raste të tjera.⁴ Ka shumë mënyra me të cilat njerëzit mund të diskriminojnë, disa më pak të dëmshme, të tjerat shumë më tepër. Diskriminim mund të hasim edhe midis vetë grupeve të diskriminuara kundrejt njeri-tjetrit, pra diskriminim të shumëfishtë. Një person mund të diskriminohet për një ose disa “arsye”, si p.sh. *një vajzë rome, punonjëse e thjeshtë pastrimi, mund të diskriminohet nga*

punonjëset e tjera të pastrimit, por edhe si përfaqësuese e një komuniteti në pakicë.

Të drejtat e njeriut janë të drejta që i takojnë gjithë njerëzimit në mënyrë të barabartë, dhe të përhershme, pra, janë universale. Të shkelësh të drejtat e një personi, do të thotë të trajtosh personin pa dinjitet, sikur ai ose ajo nuk është një qenie njerëzore, pra ta diskriminosh atë. Në mirëmbajtjen e të drejtave të njeriut secili pranon përgjegjësinë për të mos shkelur mbi të drejtat e tjerëve dhe të mbështesë abuzimin që bëhet ndaj të drejtave të tyre.

Ka raste në të cilat fëmijë me aftësi të kufizuara nuk u jepen mundësi reale për arsimim normal; gra që marrin paga më të ulëta për arsye të gjinisë së tyre femërore; homoseksuale që ngacmohen për shkak të orientimit të tyre seksual; njerëz me ngjyrë (minoriteti romë) të cilët nuk mbrohen nga dhuna etj. Këto tendenca nuk janë në frymën e të drejtave të njeriut. “Konventa Evropiane mbi Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut” deklaroi se: të gjitha këto raste duhet të trajtohen pa asnjë diskriminim, dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi raca, ngjyra, besimi fetar, mendimi politik apo çdo mendim tjetër, origjinën kombëtare ose shoqërore, përkatësinë në një komunitet minoritar ose çdo situatë tjetër. (*neni 14 i Konventës*).

Nisur nga këndvështrime të ndryshme ka përkufizime të ndryshme në lidhje me diskriminimin mbi bazën e karakteristikave të personit. Megjithatë, përkufizimi ligjor i diskriminimit është më i ngushtë se përkufizimi i diskriminimit që mund të gjesh në fjalorë të ndryshëm. Si *koncept juridik diskriminim konsiderohet*; çdo formë e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose ndonjë preferimi, me qëllim të mohimit ose refuzimit të të drejtave të barabarta dhe mbrojtjes, si dhe paraqet mohim të parimit të barazisë dhe fyerje ndaj dinjitetit njerëzor.

Në përgjithësi mund të identifikohen tri elemente që janë të përbashkëta për të gjitha format e diskriminimit:

- *veprimet të cilat kualifikohen si diskriminuese, si dallimi,*

përjashtimi, kufizimi dhe preferimi.

· *shkaqet* e diskriminimit, pra karakteristikat personale si raca, ngjyra, prejardhja, origjina kombëtare/etnike, gjinia, mosha, integriteti fizik etj.

· *qëllimet dhe/ose pasojat* e diskriminimit, të cilat kanë për qëllim, parandalimin e viktimave të ushtorojnë dhe/ose t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre fundamentale.⁵

3. Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit në aspektin kushtetues dhe te nenit 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Parimi se qeniet njerëzore janë të barabarta dhe se kanë të drejta të njëjta përbën bërthamën e konceptit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, por edhe përpjekje dhe sfida e vazhdueshme e tij. Prandaj, ky parim është themel edhe për zhvillimin e mendimit filozofiko-juridik mbi të cilin bazohet koncepti, i cili nisët nga fakti se njerëzit nuk janë trajtuar si të barabartë – as në të kaluarën e as që për momentin kjo është arritur në tërësi. Që nga fillimi i njerëzimit, diskriminimi, qoftë në një formë, qoftë në tjetrën ka paraqitur problem. Sepse siç ka thënë Platoni, virtyti më i lartë është barazia, se na bën t'i japim secilit atë që i takon.

Ndalimi i diskriminimit ose parimi i mosdiskriminimit përshkon në vazhdimësi tërë legjislaionin ndërkombëtarë. Nuk ekziston asnjë dokument ndërkombëtarë ku nuk zbatohet ky parim ose në të cilin në mënyrë direkte apo indirekte nuk zbatohet. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut sanksionon në *nenin 14* të saj ndalimin e diskriminimit sipas të cilit: *Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, besimi fetar, mendimet politike apo çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, shoqërimi me një komunitet minoritar, pasuria, prejardhja ose ndonjë situatë tjetër.*⁶ E drejta për trajtim të barabartë ose mosdiskriminim, është e drejtë e veçantë, por edhe element përbërës i të gjitha të

drejtave të tjera. Barazia si parim është një standard që kushtëzon respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Barazia në ligj dhe para ligjit, si dhe ndalimi i diskriminimit janë parime të përgjithshme që kushtëzojnë gëzimin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Parimi i barazisë vepron jo vetëm në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë por dhe në ato të drejta që konsiderohen si jo themelore. Kjo pasi shteti është i detyruar të zbatojë normat e së drejtës ndërkombëtare por edhe për vetë faktin se *neni 18* i Kushtetutës parashikon barazi përpara ligjit. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në *nenin 18* sanksionohet se:

1. Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit;

2. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja etnia, bindjet politike gjendja ekonomike, përkatësia prindërore etj. Praktikisht diçka e tillë e shprehur dhe në vetë Kushtetutë ndeshet deri diku me probleme përse i përket monitorimit në praktikë.

Barazia në ligj dhe përpara ligjit është trajtimi i barabartë i të gjithë shtetasve, si në procesin ligjvënës, ashtu edhe në zbatimin e tij. Barazia ka dy kuptime: është parim kushtetues dhe e drejtë themelore (e drejta për trajtim të barabartë). Respektimi i parimit të barazisë kërkon ndërmjet të tjerave mosdiskriminimin e grupeve apo individëve në kushte të njëjta, pa arsye të perligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në menyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar kur individet dhe grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta, apo të ngjashme, apo kur ka një justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur kështu një raport të arsyeshëm dhe përpjestimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.⁷

Mosdiskriminimi është përkufizimi negativ i barazisë dhe ka kuptim restorativ (korrigjues). Ai nuk lejon dallime të

papërligjura dhe arbitrare dhe ka kuptimin e ndërhyrjes së shtetit për parandalimin dhe mënjanimin e situatave diskriminuuese. Ndryshime midis njerëzve ka dhe do të ketë gjithmonë diskriminim. Normalisht, në kushte të ndryshme, juridikisht, njerëzit trajtohen në mënyra të ndryshme. Në jetën e përditshme ekzistojnë dallime, por, që të jenë të përligjura, ato duhet të mbështeten mbi një bazë të arsyeshme dhe të jenë bërë sipas kriterëve objektive.

Si e *drejtë themelore*, barazia është një e drejtë subjektive, pra u përket si shtetasve shqipëtarë ashtu edhe të huajve e personave pa shtetësi, si individëve ashtu dhe personave juridikë. Ndërsa *si parim themelor* barazia bën pjesë srukturalisht në arkitekturën e të drejtave të tjera dhe sa herë që analizohet gjyqësisht një e drejtë themelore e një individi, parimi i barazisë hyn në lojë automatikisht. Shkelja e parimit të barazisë mund të ndodhë në raportin vertikal shtet-individ dhe në raportin horizontal individ-individ. Në raportin e parë shteti jo vetëm nuk duhet të çënojë parimin e barazisë por ka dhe detyrime të sigurojë respektimin e tij rigoroz. Në raportin horizontal Kushtetuta nuk përcaktohet me një qëndrim të shprehur.

Barazia para ligjit ka 2 kuptime, *së pari* : të gjithë shtetasit i nënshtrohen në të njëjtën mënyrë ligjit dhe *së dyti* ligji është i njëjtë për të gjithë. Ndalimi i diskriminimit, kuptimi i dytë konsiston në faktin që ligji duhet t'i trajtojë shtetasit në të njëjtën mënyrë dhe s'duhet të bëhet asnjë lloj diskriminimi. Megjithatë, barazia para ligjit nuk është e mjaftueshme. Është detyrë e shtetit që të eliminojë pengesat ekonomike dhe sociale, për të realizuar një barazi të vërtetë dhe reale. Koncepti i organizimit kushtetues modern e përvijon shtetin si një shtet social aktiv. Ka shtete ku roli aktiv në shoqërinë civile ndihmon në një shkallë shumë të lartë shtresat e dobëta të shoqërisë, ndërsa në vende të tjera kushtet e vështira ekonomike dhe praktika politike liberale të drejtimit e bëjnë të pamundur që shteti të luajë një rol aktiv. Megjithatë ka diçka që është e përbashkët: angazhimi i shtetit në shoqërinë

civile nëpërmjet një politike aktive në fushat sociale dhe ekonomike është një problem në radhë të parë politik.

Në disa raste diskriminimi ka qenë evident, në këto raste gjykata kushtetuese ose gjykata të tjera kanë ndërhyre duke i anuluar ato ose mos zbatuar ligjet diskriminuese, por në shumicën e rasteve është e vështirë të përcaktosh nëse ligji përmban një qëndrim diskriminues. Praktika e gjykatave të larta ose kushtetuese të vendeve perëndimore ka përpunuar një kriter të përgjithshëm, jo të gjitha trajtimet e diferencuara mund të konsiderohen antikushtetues, por vetëm në ato raste të cilat diferenca në trajtim është e paarsyeshme.

4. Ligji Nr. 10221, dt.04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (objekti, qëllimi, përbajtja)

Diskriminimi në shoqëritë e vogla dhe të mbyllura ka qenë një fenomen që ka ekzistuar dhe ekziston në shumë forma. “Në Shqipëri, sipas të dhenave, që ka Grupi Shqiptar për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ka shumë shkelje të të drejtave të njeriut. Individit ka probleme, që shpesh bëhen jetësore, si ajo e punës dhe e pronës apo dhe të drejta të tjera. Aktualisht ka një politikë të paangazhuar si duhet me problemet që shoqërojnë njerëzit, ka një shoqëri civile relativisht të dobët”. Kjo sollti më tej mendimin nga faktorë të ndryshëm në mbrojtje të të drejtave të njeriut për hartimin e një projektligji, i cili do të miratohej në kuvend si ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në këtë mënyrë mund të themi se ka ndodhur një zhvillim mjaft pozitiv, për të gjithë qytetarët e Shqipërisë: Është miratuar “Ligji Kundër Diskriminimit”. Përfundimisht ligji ka hyrë në fuqi më 13 mars 2010. Miratimi i këtij ligji është pjesë e detyrimeve që Shqipëria ka në kuadër të bashkëpunimit me Bashkimin Europian.

Objekti i ligjit është respektimi i parimit të barazisë të deklaruar në kushtetutë. Ligji nr.10221, date 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka si qëllim të parandalojë dhe të ndëshkojë të gjitha format e diskriminimit sipas fushave

konkrete, për shkaqe që kane të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë, prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër. Duke përdorur togefjalëshin “ose çdo shkak tjetër”, ligji nuk e kufizon mbrojtjen nga diskriminimi vetëm për shkaqet e parashikuara shprehimisht në të, por e lë të hapur llojin e shkaqeve për të cilat mund të shkaktohet një sjellje diskriminuese.

Qëllimet kryesore të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” janë:

a) *Barazia përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*

b) *Barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*

c) *Mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.⁸*

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” trajton specifikisht disa nga fushat dhe të drejtat të cilat janë më të prekshme nga sjelljet apo format e diskriminimit. Konkretisht, ligji parashikon shprehimisht mbrojtje nga diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur e për t’u zgjedhur dhe në ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë.

Ligji nr.I0221, date 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon një rregullim ligjor më të detajuar për mbrojtjen nga diskriminimi në *fushën e punësimit, të arsimit, si dhe në fushën e sigurimit të të mirave dhe shërbimeve*. Për secilën nga fushat e lartpërmendura, ligji përcakton format në të cilat mund të shfaqet diskriminimi, të drejtat e personit që pretendon se është diskriminuar, detyrat e subjektit drejtues, publik ose privat , që vepron në

këta sektorë, afatin brenda të cilit shqyrtohet ankesa për diskriminim dhe masat që duhet të merren nga subjektet në fjalë.

Ajo çfare është e rëndësishme me miratimin e këtij ligji, është implementimi i këtij ligji në praktikë. Natyrisht implementimi i këtij ligji në praktikën e gjykatave në RSH është në fazat e para të procesit. Fokusi i trajnimeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka qënë analiza e ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nga dy këndvështrime:

1. trajtimi i kuptimit të diskriminimit dhe situatat e kategoritë e mbrojtura nga diskriminimi; dhe

2. procedurat që ndiqen nga Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi dhe paraqitja e çështjes para gjykatës kompetente.⁹

Kuptimi i diskriminimit dhe i kategorive të mbrojtura u bë duke iu referuar kuptimit të direktivave të Bashkimit Evropian të përafuar me këtë ligj. *Direktiva 2000/43/KE* e Këshillit të europës dt.29 qeshor 2000, zbaton parimin e barazisë të trajtimit të personave panvarësisht nga raca dhe origjina etnike. *Direktiva 2000/78/KE* dt.27 nëntor e 2000 e Këshillit të Europës, e cila përcakton një kuadër të përgjithshëm për barazinë e trajtimit në çështjet e punësimit dhe të kushteve në punë. *Direktiva 2006/54/KE* dt.5 korrik 2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Europës, mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të barazisë së trajtimit mes meshkujve dhe femrave në fushen e punësimit etj.¹⁰

Nga ana tjetër, vetë kuptimi i direktivave u ilustrua me praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut u trajtuan gjithashtu për të parashtruar kuptimin e diskriminimit dhe mbrojtjes ndaj tij në këndvështrim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e

Republikës së Shqipërisë, dhe shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

Ky ligj, mbron çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike, ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash. Gjithashtu, elimini i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” garanton të drejtën e personave për t’u trajtuar në mënyrë të barabartë nga ligji dhe për të pasur dhe për të gëzuar të drejta e detyrime të barabarta në të gjitha fushat e jetës, si dhe për të mos u diskriminuar për asnjë arsye dhe në asnjë mjedis. Në jetën e përditshme të gjithë mund të vihemi në rrethana dalluese, përjashtuese ose parapëlqyese, për shkaqe nga më të ndryshmet ose nga subjekte të ndryshme, ndaj njohja e ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” na ndihmon për të mundësuar realisht të drejtën për mosdiskriminim.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është për t’u përshëndetur, pasi është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një hap konkret i

përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE. Ky ligj duhet përshëndetur për faktin se ka në objekt të tij mbrojtjen e kategorive më vulnerabël shoqërore nga të gjitha llojet e diskriminimit, paraqitet në momentin e duhur dhe rrit shkallën e përgjegjësisë së institucioneve shtetërore për të garantuar mos diskriminimin në një shoqëri demokratike si kjo e jona. Megjithatë duhet pranuar që në këtë ligj ka një risi, pasi ai ka sjellë një element të ri në kuadrin ligjor shqiptar, ka parashikuar krijimin e strukturës së Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Qëllimi i ngritjes së kësaj strukture është rritja e efektivitetit në zbatimin e parimit të ndalimit të diskriminimit në përgjithësi dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji në veçanti.¹¹

Konkluzionet

Si përfundim mund të themi se parimi i barazisë është një parim shumë i rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe funksionimin e një shoqërie demokratike, por i vendosur dhe me zbatimin e parimeve të tjera që kanë të njëjtën frymë dhe që luajnë një rol të rëndësishëm në respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të individit.

Ndikimi i të drejtave të njeriut në të gjithë botën është rritur dhe forcuar gjatë këtyre viteve. Në kuadër të zhvillimeve të tyre të fundit, shumë vende të botës kanë miratuar ligje kundër diskriminimit. Mbrojtja nga diskriminimi, natyrshëm përben thelbin dhe moralin e çdo ligji që rrjedh nga aktet ndërkombëtare, nga kushtetutat kombëtare dhe nga çdo burim tjetër i së drejtës që dallon një shoqëri demokratike, tolerante nga një shoqëri e kundërt me këto, pra në thelb intolerante. Aktualisht, konstatojmë se në vend ekziston një bazë e mirë ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacion i cili është pasuruar cilësisht.

Miratimi i ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është një hap shumë i rëndësishëm në rritjen e shkallës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ai u

krijon mundësi individëve të ndryshëm, t'i drejtohen një organi, që konsiderohet garant i mbrojtjes së të drejtave të tyre, në rast diskriminimi, jo vetëm ndaj veprimeve të padrejta të administratës publike, të shtetit por edhe të subjekteve private. Ligji kundër diskriminimit parashikon sanksione për këdo nga organizmat shtetërorë apo private që nuk respektojnë të drejtën themelore të punësimit apo të drejta të tjera.

Ky ligj vjen në kohën e duhur, si përmbushje jo vetëm e detyrimeve që vendi ynë ka në kuadër të integritetit për garantimin e të drejtave të njeriut për të gjitha grupet dhe individët, por edhe si një kërkesë e brendshme për kompletimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtave të njeriut dhe të mos diskriminimit.

Bibliografia

- Block, W.E. (2010). "The Case for Discrimination".
- Grupi Shqipëtar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Raport lidhur me projektin "Trainimi i gjyqtarëve të rrethit Gjyqësor Tiranë me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi", (2011).
- Ligji Nr.8137, datë 31.7.1996 për "Ratifikimin E Konventës Evropiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".
- Ligji. Nr.10221, dt.04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
- Meçaj, V. (2011). "Barazia dhe Ndalimi i Diskriminimit në këndvështrimin ligjor dhe social", Komiteti Shqipëtar i Helsinkit, Tiranë.
- Omari, L. & Anastasi, A. (2010). "E Drejta Kushtetuese", Tiranë.
- Pincus, F. L. (2003). "Reverse Discrimination: Dismantling the Myth".
- Raport vjetor "Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit" (2010).

Burime nga Interneti

- http://www.ahc.org.al/doc/barazia_dhe_ndalimi_i_diskriminimit_Manual_OJF.pdf

Referenca

- ¹ Block, W.E. (2010). "The Case for Discrimination", fq. 55.
- ² Qëndron për komunitetin e lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve.
- ³ Pincus, F. L. (2003). "Reverse Discrimination: Dismantling the Myth", fq. 2.
- ⁴ Meçaj, V. (2011). "Barazia dhe Ndalimi i Diskriminimit n, këndvështrimin ligjor dhe social", Komiteti Shqipëtar i Helsinkit, Tiranë, fq. 9.
- ⁵http://www.ahc.org.al/doc/barazia_dhe_ndalimi_i_diskriminimit_Manual_OJF.pdf
- ⁶ Ligji Nr.8137, datë 31.7.1996 për "Ratifikimin E Konventës Evropiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".
- ⁷ Omari, L. & Anastasi, A. (2010). "E Drejta Kushtetuese", Tiranë, fq.78.
- ⁸ Ligji. Nr.10221, dt.04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
- ⁹Grupi Shqipëtar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Raport lidhur me projektin "Trainimi i gjyqtarëve të rrethit Gjyqësor Tiranë me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi", (2011).
- ¹⁰ <http://pdfsearchpro.com/ii-module-nga-ceshtje-te-te-drejtave-te-njeriut-pdf.html>
- ¹¹ Raport vjetor "Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit" (2010), fq. 23.

Constitutional and legal framework against discrimination in the Republic of Albania

Dr. Indrit SHTUPI
ShLUJ “Wisdom Univeristy”

Dr. Arjan QAFA
Inspector, “High Council of Justice”

■ Abstract

This article aims to identify one of the most controversial current issues in the field of human rights, discrimination. This area of law is facing today rapid changes, new ways of thinking and living, which make us reflect in terms of recognition and respect for individual rights, as well as the instruments used in the protection of them. Choosing this scientific article supported by my intention to introduce the latest developments, especially after the law against discrimination and the influence it has over the Albanian society. The impetus for this theme is to study what is the current constitutional and legal framework on discrimination, what it provides in the fight against this phenomenon, and what are the instruments to be used and to be protected by individuals or interest groups. Also it intended to deal in detail with the current legal and constitutional aspects of the fight against discrimination and largely stopped the study of anti-discrimination law.

■ Keywords:

Constitution, Phenomen, Discrimination The Principle of Equality, Human Rights, for European Union, Directive.



Florjan Kalaja*

Gjyqtari i ekzekutimit në procesin civil

* Autori i shkrimit është gjyqtar i Kolegjit Civil në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.



Abstrakt

Ky shkrim është bazuar në një propozim të drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë për amendimin e Vendimit Nr. 238/1/a, dt. 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore” të Këshillit të Lartë të Drejtësisë². Propozimi im ka qenë që në nenin 1 pika 2 të këtij vendimi të shtohet shkronja “c” me parashikimin: “c – paditë dhe kërkesat gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një tituli ekzekutiv, për të cilat gjyqtari kompetent është ai që përcaktohet sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile”. Qëllimi është që të krijohet centralizimi i figurës procedurale të gjyqtarit të ekzekutimit në procesin gjyqësor civil, e konkretisht në fazën fundore të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv.

Shkrimi është konceptuar në tre pjesë. Pjesa e parë jep tablonë procedurale të modelit të gjyqtarit të ekzekutimit në ligjin procedural civil, administrativ dhe penal. Pjesa e dytë jep problematikat kushtetuese, konventore dhe ligjore të mungesës së gjyqtarit të ekzekutimit si figure procedurale e centralizuar në procesin gjyqësor civil. Pjesa e tretë jep zgjidhjet e mundshme për problematikat e individualizuara

Fjalët kyçe:

gjykatës ekzekutimi, çështjet kushtetuese, titulli ekzekutiv, decentralizimi





1. Hyrje

Ky shkrim është bazuar në një propozim të drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë për amendimin e Vendimit Nr. 238/I/a, dt. 24.12.2008 “*Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore*” të Këshillit të Lartë të Drejtësisë². Propozimi im ka qenë që në nenin I pika 2 të këtij vendimi të shtohet shkronja “c” me parashikimin: “c – *paditë dhe kërkesat gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një tituli ekzekutiv, për të cilat gjyqtari kompetent është ai që përcaktohet sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.*”. Qëllimi është që të krijohet centralizimi i figurës procedurale të gjyqtarit të ekzekutimit në procesin gjyqësor civil, e konkretisht në fazën fundore të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv.

Shkrimi është konceptuar në tre pjesë. Pjesa e parë jep tablonë procedurale të modelit të gjyqtarit të ekzekutimit në ligjin procedural civil, administrativ dhe penal. Pjesa e dytë jep problematikat kushtetuese, konventore dhe ligjore të mungesës së gjyqtarit të ekzekutimit si figure procedurale e centralizuar në procesin gjyqësor civil. Pjesa e tretë jep zgjidhjet e mundshme për problematikat e individualizuara.

2. Gjyqtari i ekzekutimit në llojet e ndryshme të proceseve gjyqësore

Tre ligjet procedurale gjyqësore në Republikën tonë kanë parashikuar rregulla të posaçme për normimin e fazës përfundimtare të procesit gjyqësor, konkretisht ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Qëllimi i kësaj kërkesë është të

përqëndrohet ekskluzivisht në momentin dhe mënyrën se si ligjet procedurale japin dhe atribuojnë kompetencë gjyqësore për çështjet gjyqësore të ekzekutimit të vendimit në fazën përmbarimore.

Kështu Kodi i Procedurës Penale, që në krye të herës dhe që nga momenti i hyrjes në fuqi, në nenin 470 me titull “*Gjykata kompetente për ekzekutimin*” ka disponon se: “*1. Gjykata që ka dhënë vendimin është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij. 2. Kur ekzekutimi ka të bëjë me disa vendime të dhëna nga gjykata të ndryshme, kompetente është gjykata që ka dhënë vendimin, i cili ka marrë formë të prerë i fundit.*”. Sjell në vëmendjen se Kodi i Procedurës Penale ka hyrë në fuqi në vitin 1995.

Më tej Kodi i Procedurës Civile, megjithëse i ka dedikuar norma të tëra fazës përmbarimore³, nuk ka parashikuar asnjë normë të posaçme për të atribuuar kompetencën gjyqësore për të gjitha çështjet që gjenerojnë dhe vënë në lëvizje gjykatën gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Them “*normë të posaçme*”, pasi ka vetëm normë të përgjithshme, që do të thotë normë që ezaurohet universalisht për të titulluar një gjyqtar natyral. Kështu në paragrafin e tretë të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile disponohet se: “*Padia iu caktohet gjyqtarëve me short.*”.

Praktika gjyqësore, në bazë dhe për zbatim të nenit I paragrafi dytë i Kodit të Procedurës Civile, ka sheshuar me zbatim të pakontestuar dhe të paqtë se, ky rregull do të zbatohet jo vetëm për paditë por edhe për çdo kërkesë dhe gjykim gracioz. Kështu, edhe pse ligji mungon, nuk është parë pengesë që me analogji ai të zbatohet. Kjo do të thotë se në gjykatat e Republikës realizohet procedura e shortit elektronik për kërkesat e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit, për paditë përmbarimore dhe për çdo kërkesë që gjenerohet nga palët gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Duket sakaq se, një vit më vonë nga miratimi i Kodit të Procedurës Penale, legjislatori ndyshoi *ratio* dhe braktisi figurën

procedurale të gjyqtarit të ekzekutimit në procesin civil. Tashmë në vend të centralizimit të figurës procedurale të gjyqtarit të ekzekutimit, ai u decentralizua dhe në këtë mënyrë gjyqtar ekzekutimi mundet të bëhet çdo gjyqtar që procedura e shortit elektronik individualizon.

Vitet kaluan shpejt dhe kjo qasje e dytë e legjislatorit duket sikur revokoi dhe braktisi të parën. Megjithatë gati 16 vjet më vonë, konkretisht në vitin 2012, legjislatori miratoi Ligjin 49/2012 për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ. Neni 66 i këtij ligji në pikën I disponoi se: *“1. Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, gjyqtari apo kryetari i trupit gjykues, që ka dhënë vendimin, me kërkesë të palëve ose të përmbaruesit gjyqësor, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, urdhëron kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre.”*

Kështu 17 vite më vonë legjislatori konfirmoi se nuk e ka braktisur *ration* që e detyroi atë të krijonte figurën e posaçme të gjyqtarit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor në procesin penal. Përkundrazi u provua se në të vërtetë mosparashikimi i një norme të tillë në Kodin e Procedurës Civile ndoshta ka qenë një pakujdesi dhe harresë në nxitim e sipër për të patur një ligj procedural të ndryshëm nga një kohë që nuk duhet të kthehet më.

Me Vendimin Nr. 238/I/a, dt. 24.12.2008 *“Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”* të Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë detajuar procedurat e realizimit të shortit.⁴ Në nenin I pika 2 e këtij Vendimi përcaktohet se: *“2. Bëjnë përjashtim nga hedhja në short, këto raste: a – kërkesat penale gjatë hetimeve paraprake, për gjykimin e të cilave bëhet planifikimi i gjyqtarëve nga kryetari i gjykatës sipas ligjit nr. 9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18, pika 3, gërma “c”; b – kërkesat civile të natyrës urgjente si: lëshim i urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes,*

sigurimi i padisë, apo çdo kërkesë tjetër me karakter të ngutshëm procedural, si dhe për kërkesat penale të parashikuara nga gërma “a” e kësaj dispozite, të paraqitura gjatë periudhës së lejes vjetore. Këto kërkesa, mund të mos i nënshtrohen procedurave të shortit të mësipërm, por i kalojnë për shqyrtim gjyqtarit të planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga kryetari i gjykatës.”.

Më tej Vendimi ka parashikuar edhe një përjashtim tjetër nga realizimi i procedurës së shortit për caktimin e figurës së gjyqtarit natyral. Kështu neni 5 i Vendimit disponon se: *“Çështjet e caktuara me short dhe për të cilat është disponuar më parë nga gjykata me vendim jopërfundimtar të pushimit të gjykimit ose me vendim për kthimin e akteve, - kur nga përmbajtja e padisë është i mundur indentifikimi se është e njëjta çështje – përjashtohen nga shorti dhe i kalojnë automatikisht të njëjtit gjyqtar. Bëjnë përjashtim, rastet e pamundësisë objektive për marrjen e saj në gjykim.”.* Sigurisht kjo normë quasi ligjore, e denjë që të qenë një nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, dhe pse jo fjalia e dytë e nenit 154/a, paragrafi i tretë e Kodit, justifikohet nga nevoja për të garantuar parimin e gjyqtarit natyral të çështjes.⁵

Megjithatë, edhe pas katër vitesh nga konfirmimi ligjor i nevojës për të patur një gjyqtar ekzekutimi, tabloja ligjore procedurale është: gjyqtari ekzekutimit është një figurë procedurale në procesin gjyqësor administrativ dhe penal por jo në atë civil. Ndërkohë që kjo figurë procedurale centralizohet në procesin gjyqësor administrativ dhe penal, decentralizohet në procesin gjyqësor civil.

3. Problemet ligjore të decentralizimit të gjyqtarit të ekzekutimit në procesin civil

Problemet që shkakton kjo mënyrë procedimi janë të shumta dhe prekin aspekte kushtetuese, konventore dhe ligjore.

Sjell në vëmendje se ekzekutimi i detyrueshëm i titujve

ekzekutiv në përgjithësi, e sidomos ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës në veçanti, konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar sipas ligjit. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar⁶. Karakteri unitar i procesit civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt si në fazën e gjykimit, ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm⁷. Kështu, ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një titulli ekzekutiv e sidomos i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut⁸. Në këtë mënyrë ligji procedural ka ndërfaqet si moderator të këtij procesi gjykatës dhe shkallës së parë të vendit të ekzekutimit.⁹ Duke qenë se gjykata është moderatori, duhet të kuptohet dhe të kihet parasysh se gjykimet gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm duhet të rrezatojnë çdo element standart të së drejtës së procesit të rregullt ligjor. Kështu Republika e Shqipërisë, që me ratifikimin e K.E.D.Nj., ka marrë përsipër dhe është zotuar ndërkombëtarisht për të organizuar sistemin e brendshëm ligjor, nënligjor dhe infrastrukturor në mënyrë të tillë që të përditësohen të gjithë elementet e së drejtës për proces të rregullt ligjor.¹⁰

Problemi i parë që ka kjo mënyrë konceptimi i ligjit, e kryesisht ometimi i tij, i aktit nën ligjor të sjellë në vemendje më lart dhe praktikës gjyqësore të sheshuar nëpërmjet një zbatimi të paqte të shortit në caktimin e çdo çështje gjyqësore të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, është mosrespektimi i *parimit të ekonomizimi procesual*¹¹. Ky parim është derivat i drejtëpërdrejt i procesit të rregullt ligjor dhe më konkretisht i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm¹². Në arritjen e këtij konkluzioni mbaj parasysh jo kuptimin e ngushtë (*stricto sensu*) të këtij parimi, d.m.th. jo vetëm kohën fizike apo kohëzgjatjen e procedimit¹³, pasi kjo u trajtua në

paragrafin më lart këtij shkrimi, por kuptimin e gjërë (*lato sensu*) të këtij parimi, d.m.th. të gjitha të mirat procesuale që ai mbrojnë dhe është destinuar të mbrojë.¹⁴

Vlerësoj se çdo proces civil gjyqësor që konstituohet në Republikën tonë shënon momentin ku organet shtetërore gjyqësore nisin e më pas zhvillojnë veprimtarinë procedurale dhe e gjitha kjo tërësi veprimesh fizike dhe procedurale kushton kohë, burime njerëzore, burime natyrore dhe para. Kështu që nga çështja e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit, paditë e mundshme përbarimore¹⁵ dhe çdo kërkesë tjetër që bëhet nga subjektet procedurale gjatë fazës përbarimore në gjykatë, gjykata është e detyruar të hapë nga një fashikull të ri gjykimi; të hedhë shortin elektronik; të ngarkojë axhendën e një gjyqtari; të angazhojë një sekretare, kancelarin, nëpunësin; të detyrojë subjektin të paraqesë provat nga e para dhe çdo veprim tjetër procedural që kryehet për gjykimin e një çështje gjyqësore në ritin e zakonshëm të gjykimit.

Ky *modus operandi* procedural ngarkon subjektet e fazës përbarimore me shpenzimet e shumëfishit të çdo kërkesë apo padie që paraqitet prej tyre në gjykatë. Ky *modus operandi* procedural konsumon gjyqtarët intelektualisht dhe krijon një garcesë fiktive në axhendat dhe kohën fizike të tyre, pasi për çështje të ekzekutimit të të njëjtit titull ekzekutiv mundet të shorthohen potencialisht të gjithë gjyqtarët e një gjykate dhe shumëfishi i çështjeve të tilla mundet të krijojë situatën e pazakontë që të kërkohet delegimi i gjyqtarëve nga gjykata të tjera. Secilit prej gjyqtarëve u duhet të shpenzojë kohë *ab initio* për të kuptuar kazusin e çështjes dhe të njihen me historikun e çështjeve nga e para. Kjo *modus operandi* shkakton konsumimin intelektual të gjyqtarëve.

Problemi i dytë që shfaqet nga kjo *modus operandi* është shkelja e standartit të *parimit të afatit të arsyeshëm* në gjykimin e çështjeve të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Vlerësoj se, duke angazhuar gjyqtar të ri për çdo nënçështje gjyqësore të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli

ekzekutiv të caktuar, krijohen kushtet faktike infrastrukturore të tilla, që për ezaurimin e secilës prej tyre do të marrë kohën nga e para dhe si një çështje e pavarur secila prej tyre. Vlerësoj se nuk mundet të konsiderohet afat i arsyeshëm një kohë e tillë, e diktuar si e nevojshme nga një model i gabuar i atribuimit të kompetencës, nëpërmjet decentralizimit të figurës procedurale të gjyqtarit të ekzekutimit.

Duhet të mbahet parasysh në këtë drejtim që potencialisht çdo veprim përmbartimor mundet të bëhet objekt gjykimi brenda pesë ditëve në gjykatë. Nëse sjellim në vëmendje se sa veprime përmbartimore ndërmerren për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, atëherë kuptohet se sa gjyqtarë do të konsumohet për ekzekutimin sipas ligjit të vetëm një titulli. Duke qenë se ligji lejon mundësinë e zhvillimit dhe konstituimit të disa proceseve paralele me objekt nënçështje që në thelb kanë karakter unitar juridik, pasi bëhet fjalë për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, krijohen premisat për pezullimin e gjykimit, me qëllim që të pritet zgjidhje e një çështje tjetër e lidhur ngushtë me të, apo mundet të krijohet premisat për zvarritjen e gjykimit me të njëjtën logjikë.

Problemi i tretë që krijon kjo *modus operandi* e decentralizimit të figurës procedurale të gjyqtarit të ekzekutimit, nëpërmjet shortimit të çdo nënçështje të krijuar nga ekzekutimi i detyrueshëm i një titulli ekzekutiv, është krijimi i premisave për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*. Gjykata Kushtetuese ka theksuar vazhdimisht¹⁶ se, doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementët thelbësorë të shtetit të së drejtës. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin.

Vlerësoj se duke u decentralizuar figura e gjyqtarit të

ekzekutimit gjatë fazës përbarimore të procesit civil krijohet premisa që gjyqtarë të ndryshëm të vendosin ndryshe për çështje të ndryshme të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv. Kjo do të passjellë mungesën e sigurisë juridike dhe të parashikueshmërisë apo të krijimit të pritshmërive të ligjshme në praktikën gjyqësore dhe në vendimet gjyqësore që do të dispozojnë mbi kërkesat apo paditë përbarimore gjatë ekzekutimit të një titulli ekzekutiv të njëjtë. Sigurisht ekzistenca e proceseve paralele dhe partikularizimi gjyqësor i fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli ekzekutiv, kur në fakt të gjitha ato janë dhe duhet të jenë dhe trajtohen juridikisht si një proces i vetëm¹⁷, unitar dhe i pandashëm, krijojnë premisa për dhënien e vendimeve gjyqësore kontradiktore, që kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe që zvarrisin apo pezullojnë procedurat përbarimore në mënyrë të paarsyeshme.

Problemi i katërt që krijon kjo *modus operandi* e decentralizimit të figurës procedurale të gjyqtarit të ekzekutimit, nëpërmjet shortimit të çdo nënçështje të krijuar nga ekzekutimi i detyrueshëm i një titulli ekzekutiv, është krijimi i premisave për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* dhe më konkretisht cenimin e *parimit të gjyqtarit natyral të çështjes*. Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese kompetenca e gjykatës është trajtuar si një ndër elementet përbërës dhe thelbësor i gjykatës së caktuar me ligj.¹⁸ Megjithatë në të drejtën pozitive në fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk parashikohet në mënyrë eksplicite parimi i gjyqtarit natyral të çështjes¹⁹, dispozitat ligjore në frymën e tyre, parimet kushtetuese dhe *sidomos* jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se rendi jonë juridik një ndër elementët kryesor të gjykatës së caktuar me ligj ka standartin e gjyqtarit natyral.²⁰ E drejta kushtetuese evropiane²¹ dhe ajo procedurale konceptin e gjyqtarit natyral e paraqesin si të drejtë themelore të individit²², ku *ratio* e krijimit dhe mbrojtjes kushtetuese të kësaj figure autoritative shtetërore është tek nevoja për të qenë tej çdo dyshimi dhe

mundësie i paanshëm përgjatë gjithë procesit gjyqësor.²³

Për të kuptuar se kur duhet të jetë gjyqtari natyral i çështjeve të ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli ekzekutiv gjatë fazës përmbyllëse të procesit, fillimisht sjell në vëmendje modelin e individualizimit të ligjit procedural penal dhe ligjit procedural gjyqësor administrativ, të cilat përcaktojnë se gjyqtari që do të gjykojë të gjitha çështjet e fazës përmbartimore të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë do të jetë ai që ka dhënë vendimin.

Më tej në një përcaktim denjë për t'u quajtur si fillim gjyqtari ekzekutimi neni 511 shkronja "a" e Kodit të Procedurës Civile përcakton se gjykata kompetente për të lëshuar urdherin e ekzekutimit, kur titulli ekzekutiv është vendim gjyqësor detyrimi që ka marrë formë të prerë, do të jetë ajo që ka dhënë vendimin. *Ratio* e përbashkët e këtyre tre legjislacioneve bën të konkludohet se në të vërtetë gjyqtari natyral i çështjeve të ekzekutimit të detyrueshëm është dhe duhet të jetë gjyqtari që ka dhënë vendimin. Kjo *ratio* përfocohet dhe komplementohet, në qëllimet juridike të synuara për t'i bërë realitet, edhe nga parimet e ekonomizimit procesual, afatit të arsyeshëm dhe sigurisë juridike.

4. Zgjidhjet kushtetuese për krijimin e gjyqtarit të ekzekutimit

Ajo që ligji procedural civil e ka normuar si një fillim gjyqtari ekzekutimi është neni 510 i Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë përcakton se: "*Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, i cili: a) për rastet e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit, brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor; b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, që u është dhënë fuqi në zbatim të dispozitave të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata e apelit brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së*

kërkesës së kreditorit; c) për rastet e parashikuara nga shkronja “ç” e nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata e vendit ku është dhënë vendimi brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit; ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, lëshohet nga gjykata e vendit ku detyrimet që përmban titulli ekzekutiv do të përmbushen, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit.”.

Në këtë mënyrë ligji procedural civil jep indicjet bazë të një zgjidhje ligjore për ometimin e tij në çështjen në dukje të mosnjohjes së gjyqtarit të ekzekutimit. *Ratio* që kërkon të përcjell ligji, me këtë teknikë legislative të adresimit të gjykatës kompetente për veprimin e parë gjyqësor që shënon faza e ekzekutimit të detyrueshëm, është që gjyqtari i ekzekutimit duhet të konceptohet sipas kritereve që ndiqen për të titulluar gjyqtarin që do të lëshojë urdhërin e ekzekutimit.

Në Europë ka modele legjisacionesh që e kanë krijuar gjyqtarin e ekzekutimit edhe në procesin civil. Kështu Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Italisë ka krijuar figurën e posaçme të gjyqtarit të ekzekutimit të detyrueshëm dhe sakaq ka përcaktuar se të gjitha kërkesat e palëve përgjatë kësaj faze do të gjykohen nga i njëjti gjyqtar²⁴, ndryshe nga ligji jonë i cili nuk e ka rregulluar këtë çështje, duke mbetur në dorën e shortit për t'u caktuar gjyqtarët që do të gjykojnë çdo kërkesë që rrjedh nga e njëjta çështje e ndodhur në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.²⁵ Kështu, duke mos e partikularizuar shqyrtimin gjyqësor gjatë kësaj faze, por duke e centruar atë tek një gjyqtar konkret, ky legjisacion parashikon e për çdo çështje që ndodhet në ekzekutim të detyrueshëm ka një fashikull të posaçëm në gjykatë²⁶ (shiko nenin 488 të këtij Kodi), ku dokumentohet çdo veprim përmbartimor dhe çdo shqyrtim gjyqësor për çfarëdo kërkesë që kreditori apo debitori i bëjnë gjykatës. Të njëjtën gjë bën edhe pjesa respektive e Kodit të Procedurave Civile të Ekzekutimit të Republikës së Francës. Në këtë mënyrë

ravijëzohen edhe modele të tjera legjisacionesh procedurale civile europiane që kanë adoptuar këtë *modus operandi* për gjyqtarin e ekzekutimit gjatë fazës përmbartimore.

Përsa kam parashtruar dhe argumentuar më lart, del konkluzioni se në të vërtetë mosnjohja e gjyqtarit të ekzekutimit nga ligji procedural civil është një ometim i paqëllimshëm se sa i mirëmenduar dhe i qëllimshëm për ta patur këtë figurë gjyqtari të decentralizuar. Në këto kushte konkludohet se në të vërtetë mosnjohja e kësaj figure procedurale me filozofinë e centralizimit nuk është mandatore apo e detyrueshme nga ligji.

Në të tilla kushte njohja e saj nga praktika gjyqësore, apo nga normimi në akte nënligjore që rregullojnë detajimin e atribuimit të çështjeve gjyqtarëve nëpërmjet procedurës së shortit elektronik, nuk është e ndaluar dhe nuk përbën sakaq cenimin e standartit të gjykatës së krijuar me ligj²⁷, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit të K.E.D.Nj.. Mbetet vërtetë të artikulohen dhe adresohen zgjidhjet tashmë, mbasi ngjan të jetë i qartë kumti më i rëndësishëm i filozofisë së ligjit procedural dhe për më tepër i filozofisë së elementeve përbërës të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

Zgjidhja e parë adreson ndryshime në ligjin procedural civil, në mënyrë që ometimi i pakujdesshëm të ndreqet pa ekuivoke *pro futuro*. Natyrisht procesi ligjvënës dhe vetë ligjvënësi nuk vihet në lëvizje me kaq thjeshtësi dhe procesi ligjbërës mund të mos vij kurrë nga apatia dhe burokracia e këtij institucioni për t'u marrë me çështje të konsideruara si teknikalitete ligjore.

Zgjidhja e dytë mbetet që drejtuesit e gjykatave së bashku me gjyqtarët të krijojnë një praktikë gjyqësore të konsoliduar për mënyrën se si regjistrohet çështjet, si administrohen nga sekretaria dhe se si i caktohen gjyqtarëve paditë apo kërkesat e realizuara nga subjektet përmbartimore gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli të caktuar. Megjithatë, megjithëse besoj shumë në potencialin vetërregullues dhe zhvillimor të praktikës gjyqësore dhe

jurisprudencës në përgjithësi, dyshoj shumë se gjyqtarët do të gjejnë një dakordësi të tillë ideale. Mungesa e sigurt e dakordësisë nga gjykata në gjykatë dhe nga gjyqtari në gjyqtar do të krijojë një situatë pasigurie dhe larmie në caktimin e trupit gjykues të çështjeve përmbartimore, aq sa të kthejë mbrapsht që tani propozimin e sapo bërë si adresim për zgjidhje.

Zgjidhja e tretë vlerësoj se mundet të vij nga vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili, në bazë dhe për zbatim të nenit 118 të Kushtetutës dhe nenit 1 dhe 2 shkronja “f” dhe nenit 9 të Ligjit 9877/2008 për pushtetin gjyqësor dhe Vendimit Nr. 238/I/a, dt. 24.12.2008 “*Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore*” të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet të amendojë nenin 1 pika 2 me shkronjën “c” të munguar prej vitesh. Propozimi për ndryshimin e këtij vendimi ka të bëjë me parashikimin në shkronjën “c” të nenit 1 pika 2 të tij se: “*c – paditë dhe kërkesat gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një tituli ekzekutiv, për të cilat gjyqtari kompetent është ai që përcaktohet sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.*”.

Në këtë mënyrë jepet një e dhënë tjetër me këtë akt nënligjor për zbërthimin e kumtit që ka synuar të sjell legjislatori në nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile. Kështu me këtë ndryshim të propozuar do të konkludohet dhe qartësohet se: a) gjykata që ka dhënë vendimin gjyqësor detyrimi të formës së prerë titull ekzekutiv është gjyqtari që ka dhënë vendimin, i cili do të jetë gjyqtari natyral i ekzekutimit për këtë lloj titulli; b) gjykata apelit që lëshon udhërin e ekzekutimit për vendimet e gjykatave të huaja dhe gjykatat e huaja të arbitrazhit është në të vërtetë gjyqtari i caktuar me short, i cili është edhe gjyqtari i ekzekutimit për çdo padi apo kërkesë që gjeneron ekzekutimi i detyrueshëm i atij titulli ekzekutiv; c) se gjykata e vendit ku detyrimet do të pëmbushen për rastet e parashikuara nga shkronja “ç” e nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile është pikërisht gjyqtari i caktuar me short, i cili do të jetë gjyqtari natyral i çdo gjykimi

përmbartimor që do të gjenerojë ai titull; dhe ç) gjykata ku detyrimet sipas rasteve të shkronjave “d”, “dh” dhe “e” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile do të jetë pikërisht gjyqtari që shorti do të caktojë, i cili do të gëzojë cilësinë e gjyqtarit natyral dhe të paracaktuar për çdo kërkesë apo padi që paraqitet nga subjektet përmbartimore gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm në gjykatë për llogari të ekzekutimit të atij titulli.

Bibliografia

E drejta pozitive

1. Kushtetuta;
2. Kodi i Procedurës Civile;
3. Kodi i Procedurës Penale;
4. Ligji 49/2012 për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ;
5. Kushtetuta e Republikës së Italisë;
6. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut;
7. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
8. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Italisë;
9. Kodi i Procedurës Civile të Ekzekutimit të Republikës së Francës;
10. Rregullore mbi Gjyqësorin të 16-24 Gushtit 1790 të Francës;
11. Karta Kushtetuese e Carlo Alberto (Statuti Albertin);
12. Vendimi Nr. 238/1/a, dt. 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me

short të çështjeve gjyqësore” i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

Jurisprudencë

1. Çështja “*Qufaj v. Shqipërisë*” e Gj.E.D.Nj.;
2. Çështja “*Burdov v. Russia*”, Kërkesa 59498/00, paragrafi 34, Seksioni III, Gj.E.D.Nj. 2002;
3. Çështja “*Lyubov Stetsenko v. Russia*”, Kërkesa 26216/07, Vendimi dt. 17.04.2014;
4. Vendim nr. 27, datë 20.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese;
5. Vendim Nr. 20, dt. 04.04.2014 i Gjykatës Kushtetuese;
6. Çështja “*Kud’sa v. Poland*”, Dhoma e Madhe e Gj.E.D.Nj., Ap. no. 30210/96, ECHR 2000-XI;
7. Çështja “*Driza v. Albania*”, Seksioni IV i Gj.E.D.Nj., App no. 33771/02, Vendim dt. 13.11.2007;
8. Vendimi Unifikues Nr. 20315, dt. 20.09.2006 të Seksioneve të Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë;
9. Vendim i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë Nr.11243-00014-00-2011 i Regj.Themeltar, Nr.00-2011-74 i Vendimit (25), dt. 25.01.2011;
10. Vendim Nr. 40, dt. 11.03.2002 i Gjykatës Kushtetuese;
11. Vendim nr. 35, dt. 20.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese;
12. Vendim Nr. 26, dt. 02.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese;
13. Vendim Nr. 25, dt. 10.11.2006 i Gjykatës Kushtetuese;
14. Vendim Nr. 25, dt. 10.11.2006 i Gjykatës Kushtetuese;
15. Vendim Nr. 9, dt. 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese;
16. Vendim Nr. 11, dt. 04.04.2007 i Gjykatës Kushtetuese;
17. Vendim Nr. 23, dt. 08.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese;
18. Vendim Nr. 36, dt. 15.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese;
19. Vendim Nr. 7, dt. 09.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese;
20. Çështjes “*Driza v. Albania*”, Seksioni IV i Gj.E.D.Nj., App no. 33771/02, Vendim dt. 13.11.2007;
21. Vendim Nr. 23, 23.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese;
22. Vendim Nr. 7, dt. 09.03.2009 i Gjykatës Kushtetuese;
23. Vendim Nr. 31, dt. 01.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese;
24. Vendimi Nr. 16, dt. 27.03.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

Doktrinë

1. Kalaja, “Dilema Kushtetuese I”, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Janar 2016, Tiranë;
2. Ana Maria Soldi, “Manuale dell’Esecuzione Forzata”, Terza Edizione, Wolters Kluwer italia S.r.l., Cedam, Milano 2012;
3. Florjan Kalaja, “Gjykimi në mungesë në procesin civil”, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Qershor 2014, Tiranë;

Të tjera:

1. http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_perditesuar_822.pdf;
2. <http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/Konventa%20Europiane%20per%20te%20Drejtat%20e%20Njeriut.pdf>;
3. <http://www.altalex.com/documents/codici-altalex/2015/01/02/codice-di-procedura-civile>;
4. <http://www.quirinale.it/qrnw/statico/costituzione/pdf/Costituzione.pdf>;
5. <http://www.kld.al/korniza-ligjore/akte-n%C3%ABnligjore/vendime-an/vendim-nr-238-1-a-dat%C3%AB-24-12-2008-1>;
6. Skresa “Peticion” dt. 25.02.2016 të gjyqtarit z. Florjan Kalaja të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Kolegji Civil, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Referenca

² Skresa “Peticion” dt. 25.02.2016 të gjyqtarit z. Florjan Kalaja të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Kolegji Civil, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

³ Shiko nenin 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

⁴ Shiko në web: <http://www.kld.al/korniza-ligjore/akte-n%C3%ABnligjore/vendime-an/vendim-nr-238-I-a-dat%C3%AB-24-12-2008-I>.

⁵ Shiko Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 31, dt. 05.07.2011.

⁶ Rasti i parë që ndryshoi praktikën gjyqësore dhe mënyrën doktrinarë të të konceptuarit të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm në Shqipëri ishte çështja “*Qufaj v. Shqipërisë*” e Gj.E.D.Nj. Në këtë çështje Gj.E.D.Nj., në vazhden e jurisprudencës konstante të saj, afirmoi për Shqipërinë se faza e ekzekutimit të detyrueshëm është pjesa fundore dhe integrale e procesit gjyqësor civil dhe si e tillë meriton të gjitha garancitë dhe vemendjen e nenit 6 të K.E.D.Nj.

⁷ Shiko çështjen “*Burdov v. Russia*”, Kërkesa 59498/00, paragrafi 34, Seksioni III, Gj.E.D.Nj. 2002 dhe çështjen “*Lyubov Stetsenko v. Russia*”, Kërkesa 26216/07, Vendimi dt. 17.04.2014, paragrafi 80.

⁸ Shiko Vendimin nr.27, datë 20.06.2007 dhe Vendimin Nr. 20, dt. 04.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

⁹ Florjan Kalaja, “Gjykimi në mungesë në procesin civil”, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Qershor 2014, Tiranë.

¹⁰ Shiko çështjen “*Kud’ya v. Poland*”, Dhoma e Madhe e Gj.E.D.Nj., Ap. no. 30210/96, paragrafi 152, ECHR 2000-XI. Gjithashtu shiko çështjen “*Driza v. Albania*”, Seksioni IV i Gj.E.D.Nj., App no. 33771/02, paragrafi 68, Vendim dt. 13.11.2007.

¹¹ Shiko qëndrimin e mbajtur në Vendimin Unifikues Nr. 20315, dt. 20.09.2006 të Seksioneve të Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë.

¹² Megjithëse Kushtetuta dhe ligji nuk e artikulojnë në mënyrë eksplicite, institutet procedurale dhe vetë ligji procedural është hartuar duke pasur parasysh këtë parim, psh. egzigenca e ekonomisë procesuale sqaron filozofinë e instituteve të bashkëndërgjyqësive aktive dhe pasive procedurale, *simultaneus processus*, kalimi dhe zëvendësimi procedural, personat e tretë, ndërhyrja kryesore, *perpetuatio iurisdictionis*, litispendeca, bashkimi i padive, bashkimi i kërtimeve apo bashkimi i çështjeve etj.

¹³ Ky interpretim është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Vendimin Nr.11243-00014-00-2011 i Regj.Themeltar, Nr.00-2011-74 i Vendimit (25), dt. 25.01.2011, në të cilin ndër të tjera shprehet se: “*Ky Kolegj vlerëson se sa më sipër ka lidhje edhe me zbatimin dhe respektimin e parimit të ekonomisë gjyqësore, si dhe të përfundimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Në rast se gjykatat do të ndryshonin kompetencën tokësore sa herë që paditësi do të ndryshonte ndërgjyqësinë, atëherë do të ndodheshim përpara faktit që çështjet të mos përfundonin asnjëherë brënda afateve të arsyeshme ligjore, dhe pasojat që mund të vinin do të ishin të rënda dhe të pariparueshme, duke bërë që të cënoheshin neni 28 i K.Pr.Civile, si dhe nenet 6/1, 13 të KEDNJ.*”

¹⁴ Florjan Kalaja, "Dilema Kushtetuese I", Shtëpia Botuese "Fan Noli", Janar 2016, Tiranë.

¹⁵ Shiko nenin 609 për padinë e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, nenin 610 për padinë e kundërshtimit të veprimit përbarimor dhe nenin 613 për padinë e të tretit gjatë fazës përbarimore të Kodit të Procedurës Civile.

¹⁶ Shiko Vendimin Nr. 40, dt. 11.03.2002; Vendimin nr. 35, dt. 20.12.2005; Vendimin Nr. 26, dt. 02.11.2005; Vendimin Nr. 25, dt. 10.11.2006; Vendimin Nr. 25, dt. 10.11.2006; Vendimin Nr. 9, dt. 26.02.2007; Vendimin Nr. 11, dt. 04.04.2007; Vendimin Nr. 23, dt. 08.06.2007; Vendimin Nr. 36, dt. 15.10.2007; Vendimin Nr. 7, dt. 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁷ Shiko paragrafin 68 të çështjes "*Driza v. Albania*", Seksioni IV i Gj.E.D.Nj., App no. 33771/02, Vendim dt. 13.11.2007.

¹⁸ Shiko Vendimin Nr. 23, 23.07.2009; Vendim Nr. 7, dt. 09.03.2009; Vendim Nr. 31, dt. 01.12.2005; Vendimi Nr. 16, dt. 27.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹ Vlerësoj të sjell në vemendje se ky koncept, për herë të parë në historinë juridike, është prezantuar përgjatë revolucionit francez, në Rregulloren mbi Gjyqësorin të 16-24 Gushtit 1790, konkretisht në Nenin 17 të saj. Nga ky moment ky parim u bë pjesë e pashmangshme e çdo Kushtetute franceze 1790-1795 dhe u afirmua si parim themelor në të gjitha Kushtetutat simotra evropiane moderne. Në Itali ky parim u prezantua për herë të parë në vitin 1948 në Kartën Kushtetuese të Carlo Alberto (Statuti Albertin). Sot ai është parashikuar shprehimisht në nenin 25.I e Kushtetutës së Republikës së Italisë.

Qëllimi i filozofisë libertine revolucionare përkundër absolutizmit ishte që të ndalohej çdo pushtet ekzekutiv apo legjislativ, sidomos pushteti mbretëror, të krijonte enkas gjykata të reja speciale me qëllim kontrollin e lëndës dhe vendimmarrjes së pushtetit gjyqësor dhe të gjyqtarëve në çështje të caktuara. Pra, në kuptimin etimologjik dhe historik ligjor koncepti dhe krijesa ligjore e gjyqtarit natyral është stipuluar për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të qytetarit ndaj arbitraritetit të absolutizmit nëpërmjet garantimit sakaq të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Krijuesit e kësaj norme kishin parasysh se pëmanenca e autoritetit gjyqësor të gjyqtarit natyral deri në përfundimin e çdo mosmarrëveshje të caktuar atij sipas ligjit në fuqi për gjykim do të përbënte një barrierë për spostimin e gjyqtarit dhe garanci absolute për realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarit. Kështu, edhe sot parimi i gjyqtarit natyral, pasi ka kaluar në kapërcyellin e filozofive të ndryshme juridike dhe shtetformuese, ka ruajtur destinimin e tij juridik duke u prezantuar në të drejtat kushtetuese moderne evropiane, shtetin e së drejtës dhe më konkretisht në të drejtën procedurale civile dhe penale.

²⁰ Për herë të parë ky koncept dhe parim kushtetues është prezantuar me Vendimin Nr. 31, dt. 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese, por megjithëse është sjellë rishtazi në jurisprudencën e saj në funksion të trajtimit të rëndësisë së çështjes së shortit i është referuar në vendim dimensionit të së drejtës kushtetuese evropiane të këtij parimi.

²¹ Shiko p.sh. nenin 25.I të Kushtetutës së Republikës së Italisë e cila disponon se askush nuk mund të shmanget nga gjyqtari natyral i parakonstituuar sipas ligjit.

²² Konceptin e gjyqtarit natyral e parashikojnë edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe K.E.D.Nj. në nenin 6.I.

²³ Florjan Kalaja, "Dilema Kushtetuese I", Shtëpia Botuese "Fan Noli", Janar 2016, Tiranë.

²⁴ Ana Maria Soldi, "Manuale dell' Esecuzione Forzata", Terza Edizione, Wolters Kluwer italia S.r.l., Cedam, Milano 2012, faqe 203.

²⁵ Florjan Kalaja, “Gjykimi në mungesë në procesin civil”, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, Qershor 2014, Tiranë.

²⁶ Shiko nenin 488 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Italisë.

²⁷ Në Vendimin Nr. 31, dt. 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese thuhet ndër të tjera se: *“Caktimi i gjyqtarit pa short, jashtë kriterëve të përcaktuara rigorozisht në ligj, në kuptim të respektimit të parimit kushtetues të një gjykate të caktuar me ligj, ngre probleme serioze kushtetutshmërie. Duke pasur parasysh se besimi i qytetarëve te sistemi i drejtësisë është një nga elementet thelbësore të mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, është e domosdoshme që gjykata të jetë dhe të shfaqet e paanshme në sytë e publikut të gjerë. Debati në jurisprudencën dhe doktrinën europiane, nëse termi “gjykatë” kur flitet për gjykatë të caktuar me ligj, i takon vetëm gjykatës të identifikuar si organi kompetent për lëndë dhe territor për të zgjidhur çështjen konkrete dhe jo gjyqtarëve si persona fizikë është një problem i cili është zgjidhur pikërisht nga neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile. Ky nen ka parashikuar se gjyqtari “natyral” për të zgjidhur çështjen konkrete, është ai që identifikohet pasi është hedhur shorti dhe çdo procedurë e ndryshme ligjore jo vetëm do t’i binte ndesh ligjit, por do të ishte njëkohësisht në kundërshtim me standardin e sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës.”.*

Judge of Execution in the Civil Trial

Florjan Kalaja

■ Abstract

This article is based on a proposal of the High Council of Justice to amend the Decision Nr. 238/1 / a, dt. 24.12.2008, "On the separations procedures with a respective round of court cases", at the High Council of Justice. My proposal was that Article 1, paragraph 2 of this decision must be added the letter "c" forecast, "c – that claims and demands during the mandatory execution of a executive title, for which the competent judge is the one specified by Article 511 of the Code of Civil Procedure." The goal is to create the procedural image centralization of the execution judge in civil court proceedings, namely downstream compulsory execution of the executive title.

The article is conceptualized in three parts. The first part presents the procedural picture model of execution judge in the civil, administrative and criminal law procedural cases. The second part presents constitutional issues that lack the absence of legal (konventore) judge to perform and executate, as a centralized figure of the procedure in civil court proceedings. The third section provides possible solutions for the individualized problematics.



■ Keywords:

Civil Trial; Execution judge in the civil; constitutional issues; The executive title.



Mag. Marjeta KODRA
ShLUIJ "Wisdom University"

Terreni i investimeve të huaja në Shqipëri

6

**Abstrakt**

Investimet e huaja direkte (IHD) shërbejnë si katalizatorë për zhvillimin e ekonomive pritëse dhe luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e privatizimit. Vendet e Ballkanit Perëndimor, duke qënë ekonomi në zhvillim, synojnë të përfitojnë sa më shumë investime të huaja direkte. Në këtë aspekt, ky shkrim diskuton vështirësitë që hasin bizneset e huaja në vendin tonë, si dhe lehtësirat që vendi ynë u ofron atyre në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Nga njëra anë do të analizohen databazat e IHD për vendet e rajonit dhe do të nxirren konkluzione. Nga ana tjetër, nëpërmjet historive të suksesit apo të dështimit të bizneseve të huaja në tregun shqiptar, ky shkrim do të nxjerrë në pah problematikat konkrete.

Fjalët kyçe:

Investimet e huaja direkte, vështirësitë e biznesit, incentivat.




Hyrje

Investimet e huaja direkte (IHD) luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Por nga ana tjetër, nuk është e lehtë terheqja e tyre. Stabiliteti ekonomik dhe klima e biznesit janë faktore vendimtarë në përzgjedhjen apo jo si vend pritës. Për të kuptuar sesi vlerësohen këto faktorë për Shqipërinë na vijmë në ndihmë rezultatet e vrojtimeve të institucioneve të ndryshme. Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham) si dhe Shoqata Gjermane e Industrisë dhe e Tregtisë në Shqipëri (DIHA), kanë kryer në mënyrë të pavarur vrojtimet e përvitshme. Më poshtë jepen në mënyrë të përmbledhur rezultatet kryesore të këtyre vrojtimeve për vitin 2015:

· Për herë të pestë BERZH nxjerr rezultatet e vroitimit rreth „**Klimës dhe Performancës së biznesit (BEEPS V)**”. Në këtë sondazh, i cili përfshin periudhën 2012-2014, morën pjesë 15.883 kompani nga 30 vende të Europës Lindore dhe Azisë. Në përgjithësi ky sondazh tregoi përmirësime në disa faktorë për vendin tonë, sic janë: gjykatat, licensimi dhe aftësitë për furnizimin me energji elektrike. **Energjia elektrike, Sektori informal si dhe Korrupsioni** rezultuan si më problematikët nga ky vrojtim. Rreth 40.2% e kompanive pjesmarrëse raportuan se ishin të prekur nga konkurrenca e pandershem në sektorin

informal, një shifër kjo më e ulët se mesatarja për vëndet e Europes Juglindore (SEE) 48.6%. Ekonomia informale mendohet të përbëjë rreth 36.2% të PBB (Produkti i Brendshëm Bruto) për periudhën 1996-2012. **Ekonomia informale** për bizneset e vogla e te mesme, dhe **praktikat korruptive** për bizneset e mëdha u spikatën si pengesa të mëdha në mjedisin e biznesit në Shqipëri. Ky sondazh tregoi se gjatë 5 viteve të fundit ka më pak pengesa nga sistemi gjyqësor, nga çështjet e lidhura me licensimin e biznesit dhe lejeve (sistemi one-stop-shop) si dhe të doganave.

Figura 1 Vlerësimi i faktorëve sipas BEEPS V, 2015¹



Burimi: BERZH (2015)

Shërbimi i furnizimit me energji elektrike duket të jetë përmirësuar shumë, por gjithsesi mbetet një pengesë kryesore për ndërmarrjet në Shqipëri. Shkëputjet e energjisë elektrike duket të jenë ulur në krahasim me një vit më parë por gjithsesi mbetet shqetësuese për ndërmarrjet. Për më tepër, nëse një vit më parë disa prej tyre nuk paguanin energjinë elektrike, këtë vit të gjithë duhet të shkurtojnë investimet e tyre dhe të vihen në rradhë për të likujduar faturat e prapambetura të energjisë. Vlen për tu përmendur që cmimi i energjisë elektrike në Mal të Zi dhe Maqedoni është gati 40% më i ulët sesa në Shqipëri. Në keto kushte, bizneset po perballen me rritje të kostove dhe ulje të kërkesës,

duke i vënë në pozita më të vështira për të rritur investimet e tyre.

Nga databaza e BERZH rezultojnë 69 projekte gjithsej (të mbyllura apo aktive) në Shqipëri, me një vlerë prej 665,6 milionë Euro. Ndërkohë që për momentin Banka Botërore numëron **23 projekte aktive**. Këto projekte kryesisht janë në sektorin e energjetikës, mjedisit dhe sektorit financiar.

· **Dhoma Amerikane e Biznesit (AmCham)** publikoi në prill 2015 “**Indeksin e Biznesit për periudhën 2013-2014**”, me pjesmarrës anëtarët e kësaj dhome. Këtë vit biznesi shqiptar u vlerësua me 42,77 (nga 100 pikë të mundshme), rezultat ky që përfaqëson një trend rritës krahasuar me një vit më parë, ku u vlerësua me 40,21 pikë. AmbCham deklaroi se 3 janë problemet kryesore të biznesit në Shqipëri:

- *Ekonomia informale* 28,04 ndërkohë që një vit më parë është vlerësuar me 24,49

- *Burokracia qeveritare* 31,31 ndërkohë që një vit më parë është vlerësuar me 26,02

- *Dhe monopoli apo konkurrenca e pandershme* 31,78 ndërkohë që një vit më parë është vlerësuar me 29,85.

- **Shoqata Gjermane e Industrisë dhe e Tregtisë (DIHA)** publikoi po në prill 2015 rezultatet e „**Anketimit për Klimën e Biznesit dhe Investimeve në Shqipëri 2015**”, ku pjesmarrësit në këtë vërtetim ishin anëtarët e po kësaj dhome. Anketimi është kryer në bashkëpunim me Dhomat Gjermane të Tregtisë me Jashtë (AHK) në Rajonin e Europës Qendrore dhe Juglindore. Situata ekonomike **për vete biznesin** u vlerësua nga 23% e pjesmarrësve „mire”, 48% „e pandryshuar” dhe nga 29% e pjesmarrësve „e keqe”. Faktorët bazë ekonomik ishin vlerësuar kryesisht më pozitivisht sesa një vit më parë. Vlerësimi i **situatës aktuale ekonomike në Shqipëri** ka ndryshim pozitiv krahasuar me rezultatet e një viti më parë. 19 % e të anketuarve e vlerësojnë si “të mire” situatën ekonomike (ndërkohë që vitin e shkuar

ishin vetëm 13%), 34 % e kompanive e vlerësojnë si “deri diku të kënaqshme”, ndërkohë që 47 % e të anketuarve e vlerësojnë atë si “negative,” vlerë kjo që në vitet 2013 dhe 2014 ishte mbi 60%. Edhe pritshmëritë për të ardhmen, që anëtarët kanë në lidhje me Shqipërinë si një vend për të bërë biznes, e përforcojnë këtë tendencë pozitive. Për më tepër, vetëm 66 % e bizneseve që operojnë tashmë në Shqipëri, do të investonin sërish në këtë vend ndërkohë që më parë kjo shifër ka qenë mbi 80 %. **Vlerësimin më pozitiv** për këtë vit e kanë marrë faktorët: “kualifikimi i punonjësve” (2.69), “kostot e punës” (2.84) - me një tendencë të lehtë përkeqësimi nga viti i mëparshëm, “produktiviteti” dhe “arsimi akademik i punonjësve” (2.84). Sipas kësaj dhome, faktorët me pak te votuar për vitin 2015 janë:


- Kushtet për kërkim dhe zhvillim me 3,66 ndërkohë që një vit më parë me 3,74
- Lufta kundër kriminalitetit dhe korrupsioni 3,72 ndërkohe që një vit më parë me 4,0
- Transparenca e tenderave publike 3,77 ndërkohë që një vit më parë me 3,97 ²

Investimet e huaja direkte në Shqipëri dhe rajon

Nga databaza e Bankës së Shqipërisë arrihet të merret një informacion mbi sektorët kryesorë të IHD në Shqipëri për vitet 2007-2013 (Figura 2), ku vihet re se industria nxjerrëse, sektori financiar dhe post&telekomunikacioni janë sektorët që kanë tërhequr më tepër IHD në vitin 2013 me përkatësisht 732, 780 dhe 785 milion Euro. Sektori i ndërtimit ka qënë relativisht mirë në vitet 2008-2009 (196 milion Euro në 2008) e më pas konstatohet një trend rënës 2010-2011. Në vitin 2013 për këtë sektor, rregjistrohet një vlerë prej 84 milion Euro.


Nëse hedhim një vështrim në rajon (Figura 3) vërejmë se Mali i Zi, edhe pse rregjistron një trend negativ të IHD për kokë që prej 2009, sërish mbetet i pari në rajon për thithjen e tyre. Ndërsa Shqipëria duket të pozicionohet më mirë dhe ka një rritje të vazhdueshme që prej vitit 2011.

Figura 2 IHD sipas sektorëve në vendin tonë 2007-2013



Burimi: Banka e Shqipërisë (2015)


Figura 3 Rrjedhja e IHD për frymë në milion Euro për rajonin 2008-2013



Burimi: WIIW (2014)

Ndërkohë i njëjti trend regjistrohet për Malin e Zi edhe përsa i përket rrjedhjeve të IHD si përqindje e PBB (Figura 4). Shqipëria sërish karakterizohet nga një trend rritës dhe në vitin 2013 kap një vlerë prej 9,4 % e PBB (vlera më e lartë e arritur në këtë 5 vjeçar), ndërsa Mali i Zi 10,10 %.

Figura 4 Rrjedhja e IHD si përqindje e PBB (2008-2013)



Burimi: WIIW (2014)

Investitorët që nuk “zgjedhin” Shqipërinë

Kompanitë italiane **Geox**, **Ferrero Rocher** dhe **Benetton**, pas një studimi tregu që bënë në rajonin e Ballkanit, vendosën të mos investojnë në Shqipëri. Edhe pse Shqipëria ofron një pozitë më të favorshme gjeografike (në krahasim me vendet e tjera), burime të pasura natyrore, forcën e lirë e të kualifikuar të punës, si dhe një popullsi relativisht të re, keto kompani iu drejtuan Serbisë.

Ferrero Rocher njihet për perpunimin e lajthisë dhe ishte e interesuar për prodhimin e lëndës së parë në Shqipëri, sidomos në terrenin e Veriut, e cila njihet për ciësine e mirë të lajthisë. Ky investim do të hapte rreth 1500 vënde pune dhe sipas vlerësimeve të tregut, Shqipëria ishte më e avantazhuar ndaj të gjithë fqinjëve tanë si për tokën, kultivarin autokton të lajthisë shqiptare, regjimin rregullator, fiskal dhe krahun e punës. Sipas burimeve të kompanisë Ferrero Rocher, arsyet për moshyrjen e kësaj kompanie në Shqipëri ishin:

- mospunimi i terrenit të nevojshëm për prodhimin e lajthive,
- cmimi i lartë i trojeve dhe problematika me pronësitë e tyre
- politikat mjaft aktive të Serbisë dhe ofrimi i incentivave më konkurruese në rajon.³

Të njëjtën problematikë me pronësitë pati edhe kompania e madhe zviceriane e përpunimit „Nestle”, e cila tentoi të hyjë në territorin shqiptar para 4 vitesh, por nuk i zgjidhi dot problemet e pronësisë mbi tokën.

Firma Geox në vitin 2014 zgjodhi Serbinë pas incentivave që iu ofruan nga ky shtet. Në këmbim të punësimit të rreth 1250 punonjësve, qeveria e Serbisë e ka subvencionuar me 11.2 milion euro, pra 9.000 euro për cdo vend punë, duke mbuluar kështu gati gjysmën e vlerës së investimit. Toka iu ofrua falas dhe kompania u përjashtua nga tatim fitimi për 3 vitet e para.

Ne vitin 2011 Benetton, një tjetër kompani në kërkim të partnerëve industrial jashtë Italisë, zgjedh Serbinë, edhe pse Shqipëria që zgjedhja me e afërt mbas një studim tregu të rajonit. Benetton ka investuar rreth 43.2 milion euro dhe qeveria serbe e ka subvencionuar me 9000 eur për cdo vend pune të krijuar. Kjo kompani ka punësuar 2700 persona në objektin e saj në qytetin jugor të Nishit. Benetton filloi prodhimin në ambientet e zotëruara nga fabrika e tekstilit Nitex duke shtrirë bashkëpunimin edhe me bizneset lokale, të cilat janë në gjëndje të përmbushin standartet e kërkuara nga Benetton. Ajo po arrin të zhvillojë ciklin e mbyllur në këtë vend.⁴

Kompania **Meggle Albania**, e vetmja kompani gjermane në industrinë ushqimore në Shqipëri, lajmëroi mbylljen e linjës së prodhimit në fund të marsit 2015. Meggle Albania operonte prej 5 vitesh në tregun shqiptar nën markën FAST. Mjedisi shqiptar dhe kushtet e vështira të tregut shihen si shkaqe kryesore që kjo firmë nuk ka arritur të përmbushë objektivat e veta. Sipas kësaj kompanie, tregu shqiptar nuk ka kapacitetet e mjaftueshme për ta furnizuar këtë kompani me qumësht të cilësive së lartë. Konkurrentët e tjerë, ia dalin të prodhojnë në kapacitetet e kërkuara, por cilësia e qumështit nuk është ajo e standarteve të kërkuara. Pra, konkurrenca e pandershme bëri që Meggle Albania të hedhë sytë nga Maqedonia për të përmbushur standartet e veta.

Feramat shqiptare kryesisht janë të vogla, me 5-10 lopë dhe nuk arrijnë të mbulojnë të gjithë tregun shqiptar.

Kompanitë e ndërtimit po largohen drejt Malit të Zi, Kosovës e Maqedonisë për shkak të shitjeve të pakta, taksave të rritura dhe borxheve të larta bankare. Tregu i ndërtimit në Shqipëri mbas një bume në 2011 (vërehet edhe nga Figura 1) ka pësuar një rënie të ndjeshme. Frenimi i lejeve të ndërtimit si në Tiranë, ashtu edhe në rrethet e tjera të vendit ka bërë që kompanitë e ndërtimit tu drejtohen vendeve të tjera të rajonit.

Mungesa e stabilitetit ligjor për sipërmarrjet është faktori i parë që frenon investimet e huaja. Pasurimi i legjislacionit shqiptar është një hap pozitiv për vendin në këndvështrim afatgjatë, por në këtë fazë duket të bëhet pengesë për të thithur investimet e huaja. Ndryshime te shumta në bazën ligjore sjellin një pasiguri juridike dhe një përshtjellim edhe të situatës ekonomike, duke frenuar dëshirën për të investuar në Shqipëri.

Implementimi i **sistemit të ri të deklarimit online** nga Administrata Tatimore që nga 1 Janar 2015 solli konfuzion si për ndërmarrjet ekzistuese, ashtu edhe për ndërmarrjet e reja. Një mori ndryshimesh në aspektin Ligjor (rreth 12 Vendime dhe Udhëzime të reja që në javët e parat të vitit 2015) sollën gjithashtu vështirësi në kuptimin, dhe zbatimin e tyre. Ligji i ri për TVSH, Nr 92/2014, përvec rregullimit të disa sektorëve që më parë nuk ishin të ërcaktuar, ka sjellë edhe një mori ndryshimesh të reja.⁵ Sigurisht këto ndryshime janë të nevojshme dhe për mirë, por gjithsesi duan kohë, mund dhe para që të kuptohen dhe të implementohen. Të gjitha këto ndryshime ligjore e fiskale pritet të jenë pozitive në periudhë afatgjate, si për Shtetin në funksionin e rregullatorit, ashtu edhe për agjentet e tregut, individët dhe bizneset. Në mënyrë të përmbledhur, këto janë ndryshimet kryesore ligjore që prej 1 Janarit 2015:

- paga minimale në rang kombëtar nga 21.000 Lekë në 22.000 Lekë.

- Kufiri minimal për llogaritjen e kontributeve për sigurimet shoqerore dhe shëndetësore nga 19.406 lekë ne 22.000 lekë

- Tatimi në burim nga 10% në 15%

- Tatimi mbi fitimin nga 10% në 15%

Tatim fitimi, sic mund ta shikojmeënga përmbledhja e mësipërme, ka arritur në 15%, edhe të ardhurat që realizohen nga kursimi i këtyre fitimeve taten tashmë 15%, nga 10% që ka qënë më parë. Gjithashtu edhe rritja e cmimit të energjisë elektrike i nxjerr sipërmarrjet shqiptare jashtë lojës konkurruese në rajon. Vështirësitë e investitorëve të huaj në Shqipëri listohen si më poshtë:

- Kostoja e lartë e transportit (edhe pse kemi një pozitë të favorshme gjeografike, kushton me shume transporti psh.,nga Shqipëria drejt Gjermanisë, sesa nga Maqedonia drejt Gjermanisë)

- Pasiguria ligjore (ndryshime të shumta në legjislacion, si dhe problematikat e pronësisë së tokës)

- Korrupsioni

- Ekonomia informale (bëhet shkak për të mos përballuar konkurrencën e pandershme)

- Barra fiskale (rritje e taksave në krahasim me 2 vite më parë, si dhe ndryshime në sistemin online të deklarimit).

Investitorët që “zgjedhin” Shqipërinë

Dy kompani të mëdha gjermane, **Forschner Albania** dhe **PSZ Albania**, të fushës së prodhimit të kabujve, pas njw studim tregu tw kryer pwr rajonin e Ballkanit vendosin tw investojnw nw Shqipwri.

PSZ Albania shpk e ka filluar aktivitetin në prill të 2013 me rreth 30 punonjës, të cilët montonin sisteme kabllore per makineritë. Fuqia punëtore e PSZ mbizotërohet nga femrat, duke qenë se puna konsiston në punime dore, që kërkojnë shkallë të lartë precizioni. Momentalisht kompania ka 60 punonjës dhe drejtuesit janë të sigurtë se në Shqipëri ka ende potencial.

Kompania tjetër më e re prodhuese është Forschner Albania shpk, e cila prodhon sisteme kabllorë për sektorin

automobilistik. Kryesisht aktiviteti i kesaj kompanie është i formës fasone. Pra, lënda e parë importohet nga Gjermania, prodhohet këtu dhe sërish eksportohet drejt Gjermanisë, për kompaninë mëmë. Forscher gjithashtu iu desh të „peshonte” incentivat midis Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë.

Kompani të njohura ndërkombëtare po interesohen të zhvendosin fabrikat e prodhimit në Shqipëri. Prodhuesi japonez i automjeteve „Nissan” është duke studiuar tregun e rajonit të Ballkanit, për të realizuar procesin e montimit të automjeteve, teksa po kërkon të tërhiqet nga vende të tjera të Europës Juglindore për shkak të rritjes së kostove. Sërish pozicioni gjeografik dhe kostoja e ulët e transportit, si rrjedhojë e afërsisë me detin, e nxjerrin Shqipërinë për momentin si më të preferuarën. Përveç kësaj, nëertimi i një parku të ri logjistik (Tirana Business Park), si dhe miratimi i një Zone të lirë në Spitallë me 213 ha dhe me sektorin kryesorë atë të industrisë automotivë shihet si një tjetër tërheqje për investimin. Prodhuesit e makinave, sidomos mbas krizës së vitit 2008, janë në kërkim të tregjeve që ofrojnë kosto më të ulëta. Për rastin në fjalë Maqedonia konkurrin me taksat më të ulta dhe funksionim perfekt të zonave të lira ekonomike. Ndërkohe Serbia konkurrin me burimet njerezëre (know-how) dhe taksat e ulëta.⁶

Maqedonia ka 6 zona ekonomike industriale të zhvilluara dhe aktive. Këto zona janë të përjashtuara nga TVSH, tarifatat doganore, Tatimit mbi Fitimi si dhe Tatimi mbi Pasurinë për një periudhë 10 vjetecare.

Shqipëria ka 9 zona të pazhvilluara për parqe industriale dhe 3 zona të lira ekonomike. Asnjëra prej këtyre zonave nuk është aktive për momentin. Legjislacioni shqiptar përjashton mallrat që hyjnë në “Zonën e Lirë” nga TVSH-ja dhe tarifatat doganore. Trualli shtetëror jepet me cmimin simbolik 1 euro.

Nga këto histori suksesi mund të përmbledhim se tregu shqiptar konkuron në rajon me:

- Koston e ulët të fuqisë punëtore (Shqipëria ofron pagën më të ulët minimale me 22.000 lekë në muaj)
- Fuqinë punëtore të re (popullsia e Shqipërisë është relativisht e re, nëse e krahasojmë me atë të rajonit).
- Pozitën gjeografike (shërben si pikë lidhëse ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, si dhe afërsia me detin)
- Incentiva konkrete për sektorë të vecantë (si psh sektori fason, përjashtimin nga TVSH dhe tarifatat doganore për mallin porosites, i cili sërish është i destinuar të eksportohet).

Projekte të mëdha investimi në Shqipëri

Për momentin tre janë projektet më të mëdha të investimit në Shqipëri⁷:

- **Gazjellësi transadriatik (TAP)** me një investim prej 1 miliardë euro pritet të fillojë në qershor të 2015 dhe të përfundojë në fund të vitit 2019. Puna për ndërtimin e gazjellësit prej 211 km gjatësi në territorin shqiptar kërkon ndërtimin e rreth 58 rrugëve dhe 2 urave të reja. Ky projekt pritet të sjellë të ardhura direkte për ekonominë shqiptare në vlerën e 500 milionë eurove dhe të ardhura indirekte në vlerën e 243 milionë eurove. Përveç përfitimeve në shifra shpresohet që në të ardhmen Shqipëria të ketë akses në furnizimin me gas. Kjo pikë nuk parashikohet në projektin aktual. Gjithsesi shpronësimet (rreth 55 pronarë) mbeten një mision shumë i vështirë për projektin TAP. Këshilli i Ministrave përmes një vendimi ka miratuar tjetërsimin e tokave bujqësore në truall. Këto parcela ndodhen në Korçë, Berat dhe Fier.

- **2 Hec-et në lumin Devoll** të kompanisë norvegjeze Statkraft (e rregjistruar në Shqipëri me emrin Devoll Hydropower sha), të cilat gjenden në fazën e ndërtimit. Banjë dhe Moglicë janë 2 stacione hidroenergjetike me një kapacitet prej 256 MË. Stacioni i Banjës mendohet të përfundojë në fund të vitit 2017, ndërsa ai i Moglicës në fund të 2019. Ky investim ka vlerën e 535 milionë euro.

- **Rruga e re e Arbërit** e cila iu dha në prill 2015

me koncesion kompanisë kineze China State Construction Engineering Corporation pritet të përfundojë në fund të 2018. Ky projekt kushton 270 deri në 300 milion euro, dhe 30% do të vetëfinancohet nga kompania kineze dhe 70% nga Banka shtetërore kineze Chinese Exim Bank. Ky segment është 35 km i gjatë dhe kalon në verilindje të Shqipërisë. Qeveria shqiptare ka hartuar një projektligj të vecante për koncesionin e rrugës së Arbërit.

Këto projekte ëmbashku pritet të gjenerojnë në 3-4 vitet e ardhshëm rreth 2 miliardë euro për ekonominë shqiptare, që llogaritet si 17% e PBB për Shqipërinë. Zhvillimi i këtyre projekteve shihet si burimi kryesor i rritjes dhe impaktit në punësim, duke hapur rreth 15 mijë vende pune. Frytet e këtyre projekteve pritet të vilen në vitin 2017. Për vitin 2015 priten të kenë një efekt prej 0.5% në rritjen ekonomike të vendit, pasi investimet për momentin po fokusohen në infrastrukturën mbështetëse.


Vlen për tu përmenduar edhe rëndësia që kanë projektet e organizatave apo institucioneve ndërkombëtare në ekonominë shqiptare.

- BE ka marrë përsipër një projekt për infrastrukturën në Shqipëri, me një fond prej 130 milion euro nëpërmjet programit **IPA II** (Instrument for **P**re-Accession **A**ssistance). Në këtë mënyrë vendi ynë do të ketë lidhje më të fortë me vendet kandidate të Ballkanit Perëndimor.

- Duke u bazuar në të dhënat e fDimarkets.com në Shqipëri, janë **6 projekte aktive** me një kapital investimi gjithsej 53.2 milion dollarë dhe nga këto projekte krijohen rreth 282 vende pune. Kjo është një shifër relativisht e ulët nëse krahasohemi me vendet e tjera të rajonit, si Mali i Zi dhe Maqedoni, ku kjo e fundit qartazi është pozicionuar më mirë si në vlerën e kapitalit ashtu edhe në numrin e vendeve të hapura të punës me rreth 13.791

vënde të reja pune. Për Serbine dhe për Kosovën, ky portal nuk publikon të dhëna.

Figura 5 Projektet në 24 muajt e fundit për vëndet e rajonit



Burimi: fDimarkets 2015

Hapat e ndërmarra për të lehtësuar hyrjen e IHD-ve në Shqipëri

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm kundrejt investimeve të huaja. Në këtë kuadër, vlen të përmendet ngritja e **Këshillit të Posacëm për Investimet** (Prill 2015) me mbështjetjen e BERZH. Sipas Ministrit Ahmetaj, në cilësinë e Kreut të Këshillit të Investimeve të Shqipërisë, ky është një projekt që ka filluar me firmosjen e Memorandumit të Mirekuptimit mes Qeverisë Shqiptare dhe BERZH. Qëllimi i Këshillit të Investimeve është mundësimi i një dialogu të drejtpërdrejtë dhe aktiv mes biznesit dhe qeverisë, parashtrimi i problematikave të lidhura me klimën e biznesit dhe investimeve, raportimi i rasteve të praktikave të padrejta dhe abuzive ndaj biznesit, lufta ndaj korrupsionit, evazionit dhe informalitetit, si dhe sugjerimin e mekanizmave ligjore dhe proceduriale për parandalimin, eliminimin dhe zgjidhjen e tyre.⁸Sipas AIDA „Këshilli i Investimeve është një platformë që mbledh bashkë biznesin, qeverinë dhe institucionet financiare ndërkombëtare për të trajtuar pengesat e investimeve, duke lehtësuar klimën e tyre. Marrëveshja për të rienergjuar procesin e reformave në

ekonomi, synon të përmirësojë dialogun mes biznesit dhe autoriteteve, të forcojë klimën e investimeve dhe të promovojë mirëqeverisjen.”⁹

Qeveria ka ndërmarre disa hapa të tjera në aspektin legjislativ për sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja. Projektligji **“Mbi Investimet Strategjike”** do të jetë një bazë më e gjerë ligjore mbi investimet në territorin e Shqipërisë. Ky është një projekt pilot në bashkëpunim me BERZH.

Ideja e parqeve industriale është sinjalizuar në Shqipëri që në vitin 1995 me anë të Vendimit Nr.284, datë 5.6.1995 „Për Krijimin e Parqeve Industriale” më qëllim që të nxiten investimet e huaja dhe të krijohen kushte sa më të përshtatshme për zhvillimin e biznesit e sidomos të prodhimeve industriale, të krijohen parqet industriale në rrethe të ndryshme të vendit, mbi bazën e studimeve përkatëse. Më tej ideja e parqeve industriale është zhvilluar në krijimin e **Zonave të Lira Ekonomike** të cilat mund të ndihmojnë në thithjen e investimeve të huaja. Për këtë qëllim një tjetër projektligj **„mbi TEDAs – Technical Development Areas”** është hartuar dhe pritet të miratohet në qershor 2015. Sipas publikimeve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ashtu edhe nga AIDA, për momentin janë 3 Zona të lira ekonomike në Durrës (Spitalla), Shkodër (Koplik) dhe Vlorë. Qëllimi kryesor i këtyre zonave është ofrimi i incentivave konkurruese me vëndet e tjera të Ballkanit, të cilat i kanë tashme të zhvilluara këto zona të lira ekonomike. Investitorët do të lirohen nga TVSH, nga tarifat e importit, si dhe do ti ofrohen një mori incentivash. Shqipëria në garën e vështirë rajonale të investimeve, konkurren me burimet natyrore dhe pozitën gjeografike.

Përfundime

Tërheqja e Investimeve të huaja direkte në territorin e Shqipërisë duket të jetë një nga prioritetet kryesore të ekonomisë tonë. Ndryshime legjislative si dhe hartimi i ligjeve

të reja për rregullimin dhe mbarëvajtjen e tyre në territorin shqiptar duket se kanë fituar vëmendjen e duhur. Lufta në rajon për Investimet e huaja direkte sa vjen e bëhet më e ashpër, për vetë faktin se IHD përmirësojnë gjendjen ekonomike teëvendit pritës. Shqipëria konkurron kryesisht me krahun e lirë të punës dhe pozitën gjeografike. Maqedonia nxjerr në pah taksat e ulëta dhe zonat industriale funksionale. Mali i Zi me taksa të ulëta dhe krahun e lirë të punës. Ndërkohë që Serbia konkurron me burimet njerëzore (Know-how) si dhe taksat e ulëta. Shqipëria bëhet e vështirë për thithjen e IHD kryesisht për problematikat që hasen me pronësinë e tokës, korrupsionin dhe klanet politike, ekonomine informale, e cila ndikon direkt tek konkurrenca e pandershme në treg, barra fiskale, si dhe pasiguria ligjore e cila i përmbledh edhe tre pikat e përmendura më lart.

Me gjithë hapat e ndërmarra për përmirësimin e mjedisit së biznesit në Shqipëri, duket se ka akoma shumë punë, deri sa këto ndryshime legjislative të perthithen dhe të vlerësohen nga investitorët e huaj. Investimet e mëdha në territorin tonë për momentin sigurojnë vazhdimësinë e rritjes ekonomike dhe zgjerimin e tregut të punës për vitet pasardhëse.

Bibliografi

1. AIDA (2015), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit te investimeve, „Krijohet Këshilli Shqiptar i Investimeve”, Publikuar me 23 Prill 2015, <http://aida.gov.al/?p=5869&lang=al> Aksesuar me 5 Maj 2015.
2. Banka Boterore (2015), Projektet aktive per Shqiperine, http://www.worldbank.org/en/country/albania/projects/all?status_exact=Active&qterm=&lang_exact=English , Aksesuar me 5 Maj 2015.
3. Banka e Shqiperise (2015), Databaza Statistkore mbi Investimet e Huaja direkte sipas sektorit ekonomik, http://www.bankofalbania.org/ëeb/Statistika_230_1.php?evn=agregate_detaje&evb=agregate&cregtab_id=688&periudha_id=5, Aksesuar me 1 Maj 2015.
4. BERZH (2015) Rezultatet e Vrojtimit mbi Klimen dhe performancen e Biznesit, Profili i Shqiperise (Business Environment and Enterprise Performance Survey (BEEPS) V Country Profile) <http://ebrd-beeps.com/wp-content/uploads/2015/04/albania.pdf>, <http://ebrd-beeps.com/countries/albania/>, Aksesuar me 5 Maj 2015.
5. Dhoma Amerikane e Biznesit (2015), Indexi i Biznesit 2014-2015, Publikuar ne Prill 2015 <http://www.amcham.com.al/wp-content/uploads/2015/04/ABI-2014-ang.pdf>, Aksesuar me 1 Maj 2015.
6. fDiMarkets (2015), Databaza statistikore sipas vendeve te fdimarkets, <http://www.fdimarkets.com/explore/> Aksesuar me 5 Maj 2015.
7. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes (2015), „Krijohet Këshilli i Investimeve. Ministri Ahmetaj: finalizim i bashkëpunimit të suksesshëm me BERZH”, Postuar me 15 Prill 2015 <http://www.ekonomia.gov.al/neësroom/lajme/krijohet-keshilli-i-investimeve-ministri-ahmetaj-finalizim-i-bashkepunimit-te-suksesshem-me-berzh> Aksesuar me 5 Maj 2015.
8. Monitor (2015), Revista ekonomike Nr. 2, (663), 19 Janar 2015, “Lemshi i taksave”, faq 14
9. Monitor (2015), Revista ekonomike Nr. 8, (669), 2 Mars 2015, “Investimet e medha”, faq 10
10. Monitor (2015), Reviste ekonomike Nr.14 (675), 13 Prill 2015, “Investitoret lene Shqiperine te joshur nga Serbia”, faq 16
11. Monitor (2015, Reviste ekonomike, Nr 18 (679), 11 Maj 2015, “Ofrohet Nissan per montimin ne Shqiperi”, faq 28
12. Shoqata Gjermane e Industrise dhe e Tregtise- DIHA (2015), „Vrojtimi mbi situaten ekonomike ne Shqiperi 2015”, Publikuar ne Prill 2015.
13. WIIW (2015), Databaza Statistkore e “The Vienna Institute for International Economic Studies” <http://wiiw.ac.at/albania-overview-ce-I.html>, Aksesuar me 1 Maj 2015.

Referenca

¹Elektriciteti, Sektori informal, Korrupsioni, Administrimi i taksave, Aksesimi nw tokw, Paqwndrueshmwria politike, Aftwsitw e forcws punwtore, Transporti, Krimi, Gjykatat, Licensimi i biznesit, Rregullimet e tregut tw punws, Dogana dhe Tregtia.

²Sistemi i perdorur i vleresimit: I-shume mire, 6- shume keq.

³Revista Monitor (2015), Nr 14 (675), 13 prill 2015, faq 16

⁴Revista Monitor (2015), Nr 13, (674) 6 prill 2015, faq 21

⁵Revista Monitor (2015) 19 janar 2015, faq 14

⁶Revista Monitor (2015) Nr 18(679) 11 maj 2015, faq 28

⁷Revista Monitor (2015), Nr 8 (669), 2 mars 2015 ,faq 10

⁸Bazuar ne: <http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/krijohet-keshilli-i-investimeve-ministri-ahmetaj-finalizim-i-bashkepunitit-te-suksesshem-me-berzh>

⁹Bazuar ne: <http://aida.gov.al/?p=5869&lang=al>

Field of foreign investment in albania

Mag. Marjeta KODRA
ShLUJ”Wisdom University”

■ Abstract

Foreign direct investment (FDI) serve as catalysts for the development of the host economy and play an important role in the privatization process. Western Balkan countries, as emerging economies, aim to attract as much foreign direct investment as possible. In this respect, this article discusses the difficulties encountered by foreign businesses in our country, and the advantages that our country offers them in comparison with other regional countries. On one side, databases of FDI in the region will be analyzed and some conclusions will be drawn. On the other side, this article will highlight specific issues through the stories of success or failure of foreign businesses in the Albanian market.



■ Keywords:

foreign direct investment, business difficulties, incentives.



Jetmira FEKOLLI
ShLUJ "Wisdom University"
Fakulteti i Shkencave Sociale Universiteti i Tiranës

Ndikimi i së shenjtës në psikologjinë e mendimit të njeriut

7



Abstrakt

Të flasësh, aq më pak të studosh të shënjtën, është e vështirë. Pasi në ky argument lidhet me irracionalen, qe aq më pak mund ta gjesh te konkretizuar në realitet. Që të studjosh të shënjtën duhët së pari të kthehemi pas në kohë, të zbulojmë ato mistere mistike që fsheh veprimtaria fetare, duhet te depërtosh në psikologjinë e mendimit njëëzor për të zbuluar atë copës të vlefshme fetare që i nevojitet njëriut. Për të mos harruar së fundmi aspektin reativ të aktivitetit. Për të hyrë në thelb të problemit, lindin pyetjet më thelbësore: C'është e shenjta? Si lindi ky koncept dhe pse na nevojitet ai? Për çfare arsye u ndje nevoja që të bëhej pjesë e jetës njëëzore? Si e trajton Frojdi këtë koncept? Ceshtja që shpreh një rëndesi të madhe është që besimi në të shënjtën vjen si domosdoshmëri e brëndshme apo e jashtme? Dhe si mundet që feja të ketë një ndikim të tillë mbi jetën e individëve saqë ata të jenë aq te pregatitur të sakrifikojnë hetën e tyeë për idealet e saj? për të analizuar te gjitha keto ceshtje na nevojitet një zbulim në kulturat njëëzore të ndryshme. Shume njëërëz e identifikojne fene si një qënie supreme që na komandon te sillemi në mënyrë të moralshme në këtë botë dhe që premtion një jetë tjetër në të ardhmen e përjetshme.

Fjalët kyce:

Koncepti i se shënjtës, besimi, frika nga ndëshkimi, feja, ankthi nga e panjohura



Hyrje

Synimi i kësaj teme është se si koncepti mbi të shenjtën, funksionet e besimit kanë kontribuar në mënyrën e ndërtimit dhe besimit shoqëror dhe psikologjik në të njëjtën kohë. Nga fillimi deri më tani, ku edhe ne e ndjejmë ndryshimin që ka sjellë shoqëri, që mendonin se Zoti i lëvizte si gurë shahu, ndaj dhe duhej të qëndronin konfort sipas mendimit të asaj kohe si të drejtë. I besonin një statujë ose një kafshe që mendonin se ishte e dërguara e Zotit ose si pasqyrim i figurës së tij. Shoqëritë primitive ishin ato të cilat mendonin se Zoti gjendej mes tyre, edhe në ato moment kur ata nuk ishin vigjilent ndaj saj. Mendonin se molla bie nga pema pasi e rrëzoi Zoti, të tilla mendime dhe shumë të tjera karakterizonin ato kohë. Studimi ynë i mëvonshëm, vinte nga mungesa e informacionit dhe njohurive që ata kishin për jetën në përgjithsi dhe jetën e tyre në vecanti. Shoqëritë nën efektin e evolucionit, i ndryshuan këto koncepte. Tani më njeriu nuk mendonte më se Zoti ishte mes tyre, që po i vëzhgonte ose ndëshkonte. Tashmë çështja e fesë dhe besimit është individual. Mund të besosh edhe në fe të ndryshme nga ajo e familjes apo asaj që ke lindur, mjafton që besimi fetarë të mbushi atë boshllëk që vetë njeriu ia rezervon besimit. Për të folur për argument të ndryshme në lidhje me këtë koncept se pari duhet të merret parasysh lindja e këtyre fenomeneve, ngjarjeve etj. Ndaj për të studjuar fene na nevojitet një kthim pas në histori, pasi feja nuk është trajtuar sic mund të trajtohet sot. Ne e dime që në periudha të para

të ndërtimit të shoqërisë njërëzore, feja ishte “leva” rregullatore shoqërore. Ajo karakterisohen më ekzistencën e një fuqie supreme të mbinatyrme e cila udhëhiqte tipe sjelljesh, udhëzonte veprimtari të caktuara, dhe “frikesonte” për ndëshkime në rast devijimesh. Kjo u duk si më efikase për të mbajtur të lidhur dhe për të impunuar respektin mes shoqërisë njërëzore.

Mirepo ç’është në të vërtetë feja? Cili është roli i saj në jetën e njeriut? Feja përfshin një kompleks simbolesh tek njeriu, ndjenjtja e nderimit, ose të frikes dhe që janë të lidhura me ritualet ose ceremonialet e kryera prej një komuniteti besimtarësh.¹

Cila është rëndësia e faktorëve psikologjik?

Frojdi ishte një ndër ata studjues I cili psikologjia e tij do të vërtitej në shume çështje me peshë në jetën njërëzore. Ata të cilët gezojen dhe shqetësojnë jetën njërëzore. Për vet kohën kur jetoi Zigmund Frojdi, ai studjoi dhe vuri në paranoje moralin e para luftes. Cdo bashkësi që varej nga fryma kombëtare dhe fetare, për të mos u shpërbere, e sheh veten të detyruar të frenojë sjelljet agresive, seksuale, anarkike të individit dhe të mbaje ato të nënshtruara mbrapa digave të moralit dhe ligjit. Me anë të këtyre katalizatorëve dhe menyrave të tjera, cdo bashkësi është përparësi të mposhte instiktet primitive. Edhe kur spartanet e çojnë disiplinën e tyre deri në mizori, e bëjnë me qellim që të pastrojnë racën, të krijojnë një brez burror. Dhe duke u nisur nga këtu ashtu si Nicja me Cekan, Frojdi me mendimin e tij të drejtëpërdrejtë, pro ose kunder, pohim ose mohim, duke i prurë rrugët të gjitha alternativeve që këne vend për dilema Mendimi e Frojdit dhe metoda që ai krijoi nuk është se u prit me shumë entuziazëm në aferat shoqërore. Fakti se ai vuri theksin në instiktet seksuale, pafajsinë fëmijërore në këtë fushë, interpretimi i ëndrrave, ishin një bombë e papritur për shoqërinë. U kërkua faktori me ngulm dhe kur ai doli se ishte Frojdi, iu vërsulën me gjithë mullëfin e prishjes së imazhit

të bukur shoqëror që egzistonte deri më tani. Por Frojdi nuk e fshehu autorësinë e këtij veprimi madje e argumentoi atë. Lëvizja e Frojdit synonte zbatimin e metodës për shërimin e neurozave, të cilat ishin sëmundje psikike të shfaqura nga shtypjet shoqërore dhe dëshirave të brendshme të njeriut. Shumë ishin të prekur nga kjo sëmundje dhe e panë këtë metodë si zgjidhje drejt shërimit. Duke qënë se filozofia e Frojdit mbulonte fushën e brendshme të njeriut, ajo mund të hasi edhe kundërshtime. Pasi të studiosh botën e brendshme, gjëja më e pamundur që mund të bësh në këto raste është të vendosësh vula dhe të shpallësh teori.

Në fillim Brojeri dhe Frojdi përdorën hipnozën si instrument dërimi psikik. Më vonë u konstatua se kjo metodë nuk ishte më e mira e mundshme. Pasi së pari individit duhej të ishte personalisht dhe i vetëdijshëm për simptomën që të mund të çlirohej prej saj. Ndaj Frojdi futi në psikoanalizë termin teknik “pavëdije”, në një kuptim krejt tjetër nga ajo që i jep filozofia universale. Ai deklaroi : -” Të gjithë aktet psikike janë para së gjithash produkte të pavetëdijes, kalimi në të vetëdijshmen i paraprin një veprim i komanduar nga vet individi.”² Pavetëdija nuk ishte pra ajo ana e patregueshme dhe mbeturinë e shpirtit, por ajo është lënda e parë e tij dhe vetëm një pjesë e vogël e saj del në sipërfaqen e ndricuar të vetëdijes. Jeta jonë psikike shfaqet si një luftë e vazhdueshme mes dëshirave, mes së vetëdijshmes dhe pavetëdijshmes, veprimit të përgjegjshëm dhe instikteve. Në këtë mënyrë, Frojdi me metodën e tij, të psikologjisë së thellësive zbulon një botë psikike të panjohur. “Vetëm në sajë të tij psikologjia shkencore bëhet studim i shpirtit citon Cvajg.³ Popujt e kohrave mistike i intrigonte mënyra se si vinte, për shembull, ëndërra tek ta. Duke krijuar bindjen, në mungesë të informacioneve të tjera, se ëndërrat vinin tek ne nga një fuqi mbinjerëzore, si vullneti i perëndive

Frojdi ishte vërtet i saktë në studimet e tij por këto rezultate ai i nxori nga një numër rastesh që egzaminoi. Por a mund të krijosh teori për masën më të madhe të njerëzve

kur studion pjesën më të vogël të shoqërisë. Në material e sipër, Frommi dhe Jungu i kanë paraqitur kundërshtitë e tyre për teoritë e Frojdit. Kritika e dytë ndaj filozofisë dhe shpjegimeve të sipërpërmendura është fakti se Frojdi si parësorë ka vëvë instiktin seksualë, që edhe na drejtojnë, edhe na nxisin, edhe na bëjnë të tërhiqemi.

Humbja e idealit të “së shenjtës”

Në fakt cdo shoqëri, kur i referohet një periudhe të shkuar, e identifikon vetem me shoqëri moderne dhe ajo e shkuar ishte tradicionale. Të tillë do ta quajmë dhe ne shoqërinë aktuale, një shoqëri moderne. Ajo që e karakterizon më së shumti shoqërinë tonë është efekti i globalizimit dhe hapja ndaj tij. Nuk është hasur më parë ky process ndaj dhe mendoj se kemi një arrye të fortë për ta quajtur veten modern. Procesi i globalizimit nuk erdhi vet, ose sic mund të themi i ra rruga këtë nga njerëzimi, ai erdhi rezultat i punës së njeriut dhe dëshirës së këtij të fundit për tu bërë pjesë e tij. Solli një paketë sjelljesh dhe mendimesh duke bërë që disa nga ato aktualet të liheshin pas, madje të harroheshin. Më kryesorja ka qenë mëshimi në forcën e shkencës dhe krijimi i njeriut matematikor. Tani më njeriu nuk shihte më me sytë në qiell për të gjetur zgjidhjet, por në male me libra dhe mbi makinë llogaritëse. Nëse konkludimi ishte pozitiv atëherë themi se jemi mirë. Besimi në të Zot, jo më mbi të shenjtën, u kthye si e domosdoshme në ato momente ku njeriu nuk shihte rrugëzgjdhje racionale tjetër në horizont. Edhe nëse kjo zgjidhje vjen atëherë mendohet se ishte vullnet i Zotit ose jo.

Sot për të na kujtuar fenë, janë ato momente ku kalon pranë një institucioni fetarë, kur dëgjon një këmbanë a një këngë ose në raste festash fetare ku në televizione u kushtohet një pesë minutshë për të uruar besimtarët. Besimtarë janë tashmë ata që mbartin dhe identifikohen me një fe të caktuar dhe jo më ata që e besojnë vërtetë atë që predikon feja. E vetmja kategori që zbaton me përpikmëri ritualet fetare dhe bëson në të ashtëquajturën “fjala e Zotit” janë vetëm

përfaqësuesit e brezit të shkuar, personat e moshës së tretë. Dhe kjo kategori nuk është se përfshihet e gjithë në këtë përgjithësim, por shumica prej tyre po.

Nëse do të realizoje një anketim rreth studimit të besimit fetar të rinjtë, jam e bindur se shumica kanë për tu përgjigjur se besojnë në Zot, por jo në Kishë e Xhami, në prift e në hoxhë. Edhe unë jam një ndër ata të rinj. Kam dëshirën e mirë në besimin në Zot, por jo te ai person që është si gjithë të tjerët dhe që pretendon të luajë rolin e Zotit ndër ne. Për të mos folur pastaj për skandalet që janë bërë të njohura në publik, shfrytëzimet që institucionet fetare bëjnë me fondet monetare që i delegohen atyre dhe së fundmi skandalet seksuale me të rinjtë të kryra prej priftërinjve.

Duket se shoqëria jonë tani nisi të kuptojë filozofinë e Frojdit por e kapi atë nga këmbët. Frojdi ishte vërtet për clirimin e instiktit seksual nga shtypja, por në ditët tona ky kuptim mori përmasat e Xhamping (fjalë angleze që nënkupton kërcim së larti me fuqi të madhe). Kjo ishte thjesht një krahasim në favor të temës, pasi pak të rinj e njohin sot Frojdin dhe c'përfaqëson mendimi I tij. Ai është më së tepërmi i detyruar për tu njohur nga të rinjtë që u nevojitet në studimet e tyre. Për masën tjetër të të rinjve, që përbëjnë shumicën, është më e njohur filozofia e Rihanës, Jenifer Lopez, etj. (këngëtarë të njohur).

Feja, llojet e saj, kryesisht ajo monoteiste

Njeriu në rrethin e civilizimit, shtypja e instikteve seksuale, shfaqja e simptomave dhe neurozave, janë të gjitha tema që për Frojdin kanë rëndësi po aq sa edhe fenomeni që I ndrydh ato. Nga cu tha më sipër, atëherë lind pyetja: *cila është lidhja e tyre me fenë dhe besimin?* Vet Frojdi ishte antifetar I deklaruar, e luftoi fenë për frymën që ajo shpërndante në shoqëri duke e kufizuar njeriun në limitet etij. E mban kështu njeriun të gozhduar nën një linjë të përcaktuar duke mos e lejuar të përdorë intelektin e tij dhe duke shuar konceptin e individualitetit. Individu tani më ishte pjesë e masës duke I

humbur vlerat personale. Një përgjigje e shkurtër dhe e qartë për pyetjen e bërë do të ishte; *feja dhe besimi, përveçse fenomene shoqërore, janë edhe procese psikike, pjesë e përpunimit dhe e botës së brendshme të njeriut*. Ky mendimtar kundërshtoi praktikat fetare sepse bënë cmos për të shtypur instiktet seksuale, që sillte edhe në rrethin social kufizime për krerët e besimit fetar (klerikët, priftërinjtë, murgeshat nuk mund të martoheshin dhe duhej të hiqnin dorë njëherë e përgjithmonë nga dëshirat seksuale). Duke bërë kështu që imponimi i besimit të sillte pasoja psikologjike, simptoma, neuroza.

Metoda e tij psikoanalitike mund të zbatohet në teorinë e fesë dhe mitologjisë po aq sa mund të zbatohet në fushat e historisë, kulturës. Jetojmë, flasim, evoluojmë, kujtojmë, sakrifkohemi për shoqërinë. Sepse fundja njeriu jashtë këtij organizimi do të barazohej me të gjitha qëniet e tjera të natyrës. Pa elementin arsye dhe bashkshoqërim, njeriu nuk do të kishte më ato efekte mbi natyrën, nuk do të mund të përdorej më shprehja: “Njeriu masa e të gjitha gjërave” (Protagora). Ashtu si flasim për të tashmen, mendojmë e planifikojmë të ardhmen, por pa arritur të kujtojmë të shkuarën që na con pas në kohë për të bërë të mundur të krahasojmë, pse jo për të qënë të kënaqur për arritjet.

Shoqëria njerëzore nuk ka qënë gjithmonë kjo që ne e hasim në cdo aspekt të jetës, me sy hapur apo me sy mbyllur. Kthimi në kohë na shuan nga egzistenca mjaft sende, fenomene, etj, të cilat të parët nuk i kanë disponuar dhe megjithatë i kanë zëvendësuar, ose nuk u janë nevojitur, pasi nuk i njihnin fare. Por jo cdo gjë ikën me kohën dhe fenomenet po ashtu. Organizimi në farefisni, organizimi shoqëror, sic e quajmë ne, ka mjaft aspekte positive po aq sa ka edhe negative.

Një nga problemet që ka qënë vërtet shqetësues në shoqëritë njerëzore dhe që për Frojden është burim, kanë qënë kontrolli i instikteve seksuale. Por a kontrollohen instiktet?

Është e pranueshme edhe përgjigja jo. Por nuk mund të jetë gjithmonë e pranueshme sepse mund të shndërrohen në shkatërruese. Një nga problemet më imediate që iu shfaq si më emergjente organizimeve njerëzore ishte kontrolli i instikteve seksuale brenda grupimeve. Jo vetëm për problemet gjenetike por edhe e izolonte grupin, pengonte zgjerimin e tij në marrëdhëniet me jashtë. “Ndalimi I incestit ishte mënyra për të realizuar qëllimet e tyre të caktuara. Përshebull indigjenët e Australisë shihen si një racë e vecantë. Ata ushqehen vetëm me mishin e kafshëve që vrasin dhe rrënjë që i nxjerin nga toka. Midis tyre ska as prijës, as mbretër, nuk ka as gjurmë feshë në formën e adhurimit të qënieve të larta. Në vend të të gjitha institucioneve fetare e sociale, australjanët kanë sistemin e totemizmit. Fiset e tyre ndahen në familje të vogla ose klane ku secila mban emrin e totemit të vet. Ai është I trashëgueshëm, I trajtuar si engjëll mbrojtës dhe ndihmës në parashikimin e së ardhmes. Detyrimi ndaj tij sillte edhe ndëshkime. Përkatësia në totem qëndronte në themel të gjithë detyrimeve shoqërore. Kudo që egzistonte totemi ka edhe një ligj, sipas të cilit antarët e të njëjtit totem nuk duhet të hyjnë në marrëdhënie seksuale me njeri-tjetrin dhe as të lidhen në martesë.⁴

Për të folur për fenë, përveçse do të nevojitej një kthim pas në kohë për të zbuluar burimin e saj, e për të ardhur deri më sot ku bashkëjetojnë me ne. Sa u tha më sipër jo cdo gjë që duhet të mbajë emrin fe mund të jetë fetare. Cdo element që lidhet me besimin në faktorë të tjerë të psikologjisë dhe shpirtit tonë mund edhe ta karakterizojmë si fe. Nga studimet e deri më tanishme, fetë janë të disa tipeve. Tipologjia e feve ka të bëjë me rëndësinë e origjinës së faktit fetarë. Përshebull ka fe luftrake, fe kombëtare (të lidhura me një popull), fe universale (për të gjithë), fe mistike (mishërimi i realitetit tokësor, egzistenca e një absoluti).⁵

Vec ndarjes në tipologjitë e feve ka një ndarje më të madhe e cila lidhet me kuptimin e së shenjtës dhe kanalizimin e besimit. Ndër to shfaqet për shpjegim politeizmi dhe

monoteizmi. Politeizmi është konceptimi i hyjnive dhe përendive me emra dhe fuqi të caktuara që I identifikojnë. Ato mes tyre kanë një rregullsi hierarkike dhe mund të marrin karakter kozmofik, zoomorfik, antropomorfik. Karakteristikë e feve politeiste është se përenditë kanë lidhje të drejtpërdrejtë me besimtarët e tyre. Monoteizmi është besimi në një zot të vetëm, si suprem, qenie unike i cili ka një emër dhe komunikon me besimtarët e anë të një ndërmjetësi, i cili mund të jetë prifti, peshkopi, etj. Ajo mund të shihet në dy forma: 1- enoteizmi, përvec Zotit suprem ka edhe fuqi të tjera por jo të barazvlefshme me të njëjtën fuqi. 2- monoteizmi strikt, ato kanë vetëm një fuqi dhe besimi u drejtohet vetëm atyre, ndër to është krishtërimi, islamizmi, judaizmi.

Për fetë ka folur edhe Frojdi, kryesisht për atë monoteiste. Në veprën e tij “ Moisiu dhe feja monoteiste “ e shtjellon më së gjeri këtë temë. Për Frojdin Shoqëria, konformizmi, besimi janë mjaft domethënëse për lindjen e neurozave tek individët. Ata vuajnë nga mungesa e vetkënaqjes , qendronin gjithmonë nën presionin nëse ishin në rregull me mjedisin rrethues, me komunitetin social, nëse ishin të devollshëm për besimin që I përkisnin dhe Zotit që u luteshin. Arsyet e lindjes së këtyre neurozave , plus faktorit aktual të jetesës, vinin edhe nga përvojat fëmijore. Përshtypjet e para vijnë nga koha kur fëmija nis të flasë, këto periudha i lë në harresë vet procesi jetësor ndaj që aty nevoitet puna analitike⁶. Duket sikur gjithë psikologjia e Frojdit shkon ku shkon, sillet vërdallë proceseve psikike që shkakton cdo fenomen mbi njerëzit. Në kompleksitetin e ndërtimit të psikikës së njeriut ka procese të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme. Ndryshimi i cilësive mes tyre përkon me dallimin mes Unit dhe shtypjes. Cdo element i shtypur është i pavetëdijshëm por jo cdo element i vetëdijshëm i përket Unit. Ajo që e dallon një dukuri të vetëdijshme nga një e pavetëdijshme, ishte ndryshimi i energjisë psikike.⁷

Frikë nga e panjohura apo nga e njohura?

Ndjësinë e frikës na ndodh ta gjejmë shpesh dhe në rrethana të caktuara. Ajo mund të ndjehet në cdo moshë e në intervale të gjata dhe të shkurtra kohe. Arsytet se nga shkaktohet frika janë nga më të ndryshmet, por vendi se ku shfaqet ajo është Uni njerëzor. Ajo riprodhohet si një gjendje afektive nga energjia e lëvizjes shpirtërore të shtypur. Frika karakterizohet nga një shenjë e qartë e dickaje të pakëndëshme, ndjenja fizike të caktuara që lidhen me organe të caktuara. Frika lind si reagim ndaj një gjendje që përbën rrezik. Zhvillimi i frikës i jep impuls simptomfprimimit. Neuroza, si duket, bëhet streha e arratisë nga objekti i frikës⁸. Neurotiku dallohet nga një njeri normal për faktin se i egzagjëron jashtë mase reagimet ndaj këtyre rreziqeve. Format i lindjes së frikës është dy llojë, ajo e pavullnetshme e cila lind në një situatë rreziku dhe forma tjetër është e riprodhueshme që i shmanget shfaqjes së objektit frikësues. (Të gjithë elementët e frikës Frojdi I ka shpjeguar në librin e tij me të njëjtën titull “Frika”.⁹ Në jetën tonë njihen tri lloj termash që ngjallin thujse të njëjtën ndjesi, ato janë “ankth”, “frikë” dhe “tmerr”. Ankthi nuk shpreh vëmendje ndaj objektit, nuk e di se kur mund të vij, madje nuk e njeh fare atë. Ai shkaktohet nga një ndjesi shpirtërore e mbërritjes së një rreziku të caktuar. Frika, si u shqyrtua edhe më sipër, e ka një objekt që në mënyrë figurative mund t’i ruhesh e ta shmangësh. Tmerri është gjendje afektive e cila ka ardhur në mënyrë të papritur, pa e përjetuar fillimisht ankthin. Ndaj thuhet se njeriu mbrohet nga tmerrri me anë të ankthit. Por a ka ndjenja instiktive të pavetëdijshme, apo nuk mund tu japim një kuptim? Kësaj pyetje Frojdi i dha një përgjigje. Kundërshtia mes të vetëdijshmes dhe së pavetëdijshmes nuk zbatohet te instikti, sepse një instikt nuk mund të bëhet kurrë objekt i vetëdijes. Duke qënë kështu, atëherë si e njohim ne instiktin si të tillë? Instikti bëhet i njohur te ne me anë të veprimtarisë dhe veprave që vijnë prej tij, ai na paraqitet vetëm me anë të përfytyrimit. Pra si përfundim te kesaj eshte se kontrolli shoqëror (qoftë kjo edhe në formatin fetarë), dëshirat

e pafundme njerëzore të cilat qëndronin të ndrydhura brenda tyre, frika nëse do të jenë të përjashtuar nga shoqëria, bëri që njeriu të gjej prehje te neuroza. Neuroza ishte një formë e crregullimit psikik të njeriu kur ai ndodhej mes zjarreve të brendshme dhe akujve të jashtëm. Ajo jep shenjat e saj të para me anë të simptomës obsesionale, derisa krijohet neurozë, e cila e mbyll njeriun brenda vetes dhe e drejton në cdo veprimtari, që kryesisht është negative.¹⁰

Konkluzioni

Si perfundim te temes ajo që duhet thënë është se normalisht nuk është zotësi të bësh krahasime nga periudha e primitivitetit me atë të shekullit XXI. Nuk është askush që nuk e di ose nuk e dallon ndryshimin nga jetesa në bashkësi primitive, jetesa me gjueti, frika e pamasë që mund të ngjallte një mace, një qen ose të tjerë njeriut. Synimi i kësaj teme nuk ishte ky. Por se si koncepti mbi të shenjtën, funksionet e besimit kanë kontribuar në mënyrën e ndërtimit dhe besimit shoqëror. Nga fillimi deri më tani, ku edhe ne e ndjejmë ndryshimin, ka sjellë shoqëri që mendonin se Zoti i lëvizte si gurë shahu, ndaj dhe duhej të qëndronin konfort sipas mendimit të asaj kohe si të drejtë. I besonin një statuje ose një kafshe që mendonin se ishte e dërguara e Zotit ose si pasqyrim i figurës së tij. Shoqëritë primitive ishin ato të cilat mendonin se Zoti gjendej mes tyre, edhe në ato moment kur ata nuk ishin vigjilent ndaj saj. Mendonin se molla bie bga pema pasi e rrëzoi Zoti, të tilla mendime dhe shumë të tjera karakterizonin ato kohë. E cila nga studimi ynë i mëvonshëm, vinte nga mungesa e informacionit dhe njohurive që ata kishin për jetën në përgjithsi dhe jetën e tyre në vecanti.

Shoqëritë nën efektin e evolucionit, i ndryshuan këto koncepte. Tani më njeriu nuk mendonte më se Zoti ishte mes tyre, po i vëzhgonte ose ndëshkonte. Tashmë çështja e fesë dhe beimit është individual. Mund të besosh edhe në fe të ndryshme nga ajo e familjes apo asaj që ke lindur, mjafton që besimi fetarë të mbushi atë boshllëk që vetë njeriu ia rezervon besimit.

Bibliografia

1. Anthony Giddens “ Sociologjia “ “ Cabej “,
2. Leksione “ Filozofi e fesë “ Prof. Gjergj Sinani
3. Zigmund Frojd “ Totem dhe tabu” “ Fan Noli “, 2005
4. Zigmund Frojd “ Moisiu dhe feja monoteiste “ “ Fan Noli “, 2005
5. Zigmund Frojd “ Obsesionet, fobitë dhe paranojat “ “Fan Noli”, 2001
6. Zigmund Frojd “ Ese mbi psikoanalizën “ “ Fan Noli “, 2004
7. Zigmund Frojd “ Hyrje në psikoanalizë “ “ Fan Noli “, 2004
8. Zigmund Frojd “ Frika “ “ Fan Noli “,2001
9. Stefan Cvajg “ Frojdi “ “ Fan Noli “, botimi original 1940

Referenca

- ¹ Anthony Giddens:” Sociologjia”, Sht. Bot “Cabej” , 2004, fq. 430
- ² Zigmund Frojd “Ese mbi psikoanalizwn” 1940, “Fan Noli”, fq. 41
- ³ Stefan Cvajg “Frojdi”, Fan Noli, fq 26
- ⁴ Zigmund Frojd “Totem dhe tabu” 2005 “Fan Noli”. Fq. 13-16
- ⁵ Leksione, Filozofi Feje.VIII. Dr. Gjergj Sinani
- ⁶ Zigmund Frojd “ Hyrje në psikoanalizë “ “ Fan Noli “, 2004, fq 15
- ⁷ Zigmund Frojd “Moisiu dhe feja monoteiste” 2005 “Fan Noli” fq. 164-170
- ⁸ Zigmund Frojd “Frika” 2006 “Fan Noli” ,fq 23
- ⁹ Zigmund Frojd “Frika” 2006 “Fan Noli” ,fq 26
- ¹⁰ Zigmund Frojd “ Obsesionet, fobitë dh paranojat “ “Fan Noli”, 2001

The impact of the Holy in the psychology thought

Jetmira FEKOLLI
ShLUJ "Wisdom University"
Fakulteti i Shkencave Sociale Universiteti i Tiranës

Abstract

To speak about, at least to study the Holy is something difficult based on the fact that this argument is linked with the irrational and it is difficult to find it materialized in the reality.

To study the Holy we must at first go back in time and discover the mystery that the mystical religious activity hides and must probably the psychology of human thought to discover that valuable piece of religious that human needs. Not to forget the recent relative terms of the activity.

To enter the core of the problem the most essential problems arise: What is the Holy? How did this concept come from and why do we need it? What is the reason why it should be part of the human life? How does Freud treat this problem? This issue that expresses great importance is that the belief in the Holy comes as an interior or exterior necessity. How can religious have such a great impact on the lives of individuals so that they are ready to sacrifice their lives for the ideals of her. To analyze all these issues we need a breakthrough in various human cultures.

Keywords

The concept of the sacred, faith, fear of punishment, religion, anxiety of the unknown



MSc. Flutur SHABANI
ShLUJ "Wisdom University"

Referimi dhe rireferimi, kuptimi dhe zbatimi i tyre në të drejtën ndërkombëtare private

8

 **Abstrakt**

Bashkëkzistenca e një numri të konsiderueshëm shtetesh sovraane, intensifikimi i qarkullimit civil ndërkombëtar që shprehet në lindjen e marrëdhënieve juridiko-civile me elemente të huaj të shumëllojshme, justifikojnë ekzistencën e të drejtës ndërkombëtare private. Kjo e drejtë është tërësi normash juridike që shërbejnë për të rregulluar juridiksionin, procedurën, ligjin e aplikueshëm dhe elementet e tjera lidhur me të, në një marrëdhënie juridiko-civile me elemente të huaj. Tërësi e normave nuk janë tjetër veçse ato i quajmë norma të konfliktit, të cilat zgjidhin përplasjet në marrëdhëniet juridiko-civile me elemente të huaj. Një normë konflikti bën zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm duke zgjidhur konfliktin ligjor në marrëdhënien juridiko-civile me elemente të huaj ose mund të të dërgojë në një rend të caktuar juridik. Në të dyja rastet norma e konfliktit kryen funksionin e saj referues, por në këtë të fundit flitet për referim në një rend të huaj juridik. Referimi shprehet në rastet kur norma e kolizionit që ta rregullojë një marrëdhënie juridiko- private me element të huaj shkon te aplikimi i të drejtës së shtetit të huaj, si asaj materiale ashtu edhe të drejtës kolizive.

Kur referimi bëhet mbi vetë ligjin e zbatueshëm, duke e përcaktuar këtë të fundit si ligji që do të aplikohet për zgjidhjen e konfliktit, kemi të bëjmë me referim në ligj të aplikueshëm, cka nënkupton se rregullat e së drejtës ndërkombëtare private të shtetit të huaj nuk do të merren parasysh, por do të merret direkt ligji i huaj për zgjidhjen e konfliktit.

Kur referimi bëhet mbi vetë ligjin e zbatueshëm, duke e përcaktuar këtë të fundit si ligji që do të aplikohet për zgjidhjen e konfliktit, kemi të bëjmë me referim në ligj të aplikueshëm, cka nënkupton se rregullat e së drejtës ndërkombëtare private të shtetit të huaj nuk do të merren parasysh, por do të merret direkt ligji i huaj për zgjidhjen e konfliktit.

 **Fjalët kyçe:**

E drejtë ndërkombëtare private, referim, gjykatë, kolizion , rregulla, shtete.



Hyrje

Instituti i referimit paraqitet vetëm te mënyra kolizive (indirekte , e tërthortë) e rregullimit të marrëdhënieve juridiko-private me element të huaj dhe është specifik vetëm për të drejtën ndërkombëtare private. Referimi shprehet në rastet kur norma e kolizionit që ta rregullojë një marrëdhënie juridiko-private me elementë të huaj referon zbatimin i të drejtës së shtetit të huaj si të asaj materiale ashtu edhe të drejtën kolizive. Në qoftë se edhe norma e kolizionit e shtetit të huaj tek e cila referon norma e kolizionit të shtetit të vendit përcakton se ajo e drejtë duhet të zbatohet për rregullimin e marrëdhënies juridiko-private me elementë të huaj , atëherë nuk ka problem. Do të zbatohet e drejta materiale e shtetit të huaj siç e përcakton edhe norma e kolizionit të shtetit para organit të të cilit shtrohet çështja. Kjo do të vinte në shprehje në ato raste kur normat e kolizionit të shteteve me të cilat është e lidhur marrëdhënia juridiko-private me element të huaj i zbatojnë të njëjtat fakte vendimtare si psh : shtetësinë te zotësia e veprimit të palëve ose te marrëdhëniet statusore dhe trashëgimore.

Instituti i referimit në të drejtën ndërkombëtare private paraqitet në shekullin XVII. Niboyet ka theksuar se ku përveç rregullave të kolizionit që janë zbatuar në Normandi , janë marrë parasysh edhe rregullat kolizive të cilat janë zbatuar në Paris , e ku në fakt është arritur i njëjti efekt. Te referimi nuk kemi të bëjmë me shëtitjen e lëndëve nga një gjykatë në gjykatën tjetër por kemi të bëjmë me një operacion

mendimesh që zhvillohen në kokën e gjykatësit të gjykatës së shtetit para të cilit shtrohet çështja që kërkon përgjigje në pyetjen e cila është e drejtë kompetente, pra në bazë të cilës të drejtë substanciale do të rregullohet marrëdhënia juridiko-private me element të huaj.

Që të zbatohet instituti i referimit duhet të plotësohen disa kushte si teorike dhe praktike. Kushti primar juridik ,konsiston në pranimin e konceptit sipas të cilit normat e kolizionit dërgojnë tek zbatimi i të drejtës konkrete në tërësi e jo vetëm në zbatimin e të drejtës materiale. Kushti tjetër që të vijë deri te referimi është ekzistimi i normave të ndryshme të kolizionit midis të drejtës së vendit dhe të drejtës së huaj për të njëjtën kategori të marrëdhënieve juridiko-private me element të huaj të ndryshojnë faktet vendimtare (pikat e lidhjes). Kushti i tretë i cili duhet të plotësohet që të vijë te referimi ka të bëjë me radhitjen e atillë të fakteve që mundësojnë që kriteret e ndryshme të pranuar në dy ose më tepër norma të kolizionit të jenë të lidhura në rastin konkret për shtetet e ndryshme. Pikërisht, për këtë problem, të kërkimit të aplikimit të rendit të huaj juridik nga norma të konfliktit do të flitet në këtë punim.

1. Kuptimi i referimit dhe rireferimit

Referimi është dërgimi që bën norma e konfliktit në një rend të caktuar juridik. Kërkimi i aplikimit të këtij rendi, nënkupton respektimin dhe zbatimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare private të rendit juridik në fjalë. Referimi është një operacion teknik ligjor i cili konsiston në një dërgim që bën norma e konfliktit në një rend të caktuar juridik.¹ Për të qenë më i qartë, kur për një marrëdhënie juridiko-civile ku përfshihet një shqiptar, por që ndodhet jashtë shqipërisë, ligji i vendit ku ndodhet referon në ligjin tonë në bazë të shtetësisë së personit në fjalë, atëherë do të shihet se çfarë rregullimi do të bëjë norma jonë e konfliktit për marrëdhënien në fjalë, pra do të zbatohen rregullat e së drejtës sonë ndërkombëtare private.

Për një shtetas shqiptar që jeton e punon dhe ndërkohë ka dhe prona të patundshme në Itali dhe vdes aksidentalisht në Shqipëri, është i pashmangshëm zbatimi i ligjit ndërkombëtar pasi kemi të bëjmë me rast me element të huaj. Në këtë rast ligji i zbatueshëm është ai shqiptar i cili vijon me celjen e trashëgimisë. Mirëpo rendi juridik, më saktë gjykatat shqiptare referon rendit juridik italian, me arsyetimin se *“trashëgimia mbi sendet e paluajtshme rregullohet nga ligji i shtetit, në territorin e të cilit ndodhet sendi i paluajtshëm”*.²

Në këtë rast norma jonë e konfliktit ka referuar në rendin juridik të shtetit Italian. Në qoftë se e drejta ndërkombëtare private e Italisë ka dispozitë si tonën mbi trashëgiminë, mbetemi në kushtet e referimit, por mund të ndodhë që e drejta ndërkombëtare italiane për atë çështje ka një normë konflikti që thotë se për pronat e personit me shtetësi shqiptare trashëgimia do të rregullohet në bazë të shtetësisë së personit. Kjo do të thotë se ata e kthejnë mbrapa referimin tonë, duke rireferuar. Pra kemi të bëjmë me rireferim kur rregullat e shtetit ku norma jonë e konfliktit referon, referojnë në ligjin tonë. Në këtë situatë kemi shtetin A që referon te B dhe më pas B referon tek A).

Pranimi nga gjykata e kasacionit në Francë i referimit ndodhi me rastin e çështjes *Forgo*, më e njohura në të drejtën ndërkombëtare franceze. Sipas këtij rasti një bavarez me banim në Francë kishte vdekur duke lënë në këtë vend një pasuri të paluajtshme. E drejta ndërkombëtare franceze pranonte kompetencën e ligjit bavarez, por kuy i fundit e konsideronte vendbanimin si një faktor lidhje, që do të thotë e njihnte kompetencën e ligjit francez dhe gjykata e pranoi këtë gjë. Që nga ky rast parimi i pranimit të referimit nuk është vënë më në dyshim. Por në një numër të caktuar shtetesh në tërësi refuzohet zbatimi i referimit. Gjykata e vendit është e detyruar që ta zbatojtë drejtën materiale në të cilën referon norma e kolizionit e shtetit të vendit. Zgjidhja e tillë është e paraparë në legjislacionin e Greqisë, Italisë Brazilit

Danimarkës , Holandës , Norvegjisë , Islandës etj. Grupi tjetër i shteteve e zbaton referimin në legjislacionet e tyre, por me kufizime e specifikime. Kështu psh : në Shqipëri, Spanjë dhe Hungari pranohet vetëm kthimi në të drejtën e vendit. Ligji polak për të drejtën ndërkombëtare private i vitit 1966 i kushton rëndësi më të madhe referimit, pasi lejon kthimin në të drejtën e vendit ashtu edhe referim në të drejtën e shtetit të tretë. Në SHBA nocioni për rireferimin është i pa përcaktuar mirëpo ka raste në disa shtete federative në SHBA që pranohet rireferimi.

Ligji jonë referimin dhe rireferimin e rregullon në nenin 3/I “*referimi në ligjin e një shteti tjetër*”: *kur ky ligj referon në ligjin e një shteti tjetër, zbatohen edhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare private të atij shteti (referimi). Kur rreëgullat e atij shteti referojnë në ligjin shqiptar, zbatohen rregullat e këtij të fundit, përveçese ligji parashikon ndryshe (rireferimi)...*

“...përveçese ligji parashikon ndryshe” është plotësuar në pikën 2 të këtij neni, sipas të cilës rregullat e së drejtës ndërkombëtare private të një shteti tjetër nuk zbatohen në lidhje me:

a. *Statusin e personave juridikë*- në nenin 15 parashikohet se personat juridikë rregullohen nga ligji i shtetit, në të cilin janë regjistruar.

b. *Zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm*-ajo që bën zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm është vetë norma e konfliktit, pra normat e së drejtës ndërkombëtare private të rendit tonë juridik, dhe përderisa janë ligj këto norma, i përkasin rendit publik. Rregullat e së drejtës private ndërkombëtare të një shteti tjetër nuk mund të zbatohen për aq sa janë në kundërshtim me rendin publik, dhe kur janë ndesh me normat tona të konfliktit prevalojnë normat tona të konfliktit.

c. *Formën e veprimit juridik*- mbi formën e veprimit juridik flet vetë norma jonë e konfliktit në nenin 18 të saj.

d. *Detyrim ushqimor* –në prapavijë të të cilit qëndron rendi publik pra bën pjesë në rendin publik (neni 26).

e. *Detyrimet kontraktore*- palët mund të zgjedhin vetë ligjin e zbatueshëm për rregullimin e kontratës ku sipas nenit 47 përfshihet përmbushja e detyrimeve, ose në mungesë të zgjedhjes ai caktohet nga ligji jonë (neni 46) dhe jo rregullat e ligjit të huaj të së drejtës ndërkombëtare private.

f. *Detyrimet jashtëkontraktore* – vlen rregulli i mësipërm, e veçantë se ligji i zbatueshëm mund të zgjidhet me marrëveshje pas ngjarjes që ka shkaktuar dëmin.³

Disa rregulla konflikti i referohen thelbit të përmbajtjes së ligjit të huaj dhe jo të drejtës ndërkombëtare të huaj private. Pra referimi nuk pranohet kur palët kanë mundësi të zgjedhin me vullnetin e tyre ligjin që do të zbatohet. Në këto raste prezumohet se palët kanë zgjedhur vetëm të drejtën themelore të huaj me përjashtim të rregullave të konfliktit të ligjit. Gjykata e kasacionit francez e ka përdorur këtë argument për të mos pranuar referimet në fushën e regjimit martesor, ku ligji francez i lejon bashkëshortët të zgjedhin ligjin e zbatueshëm. Në vija të përgjithshme, ajo ka pranuar se “zbatimi i ligjit të autonomisë së vullnetit përjashton çdo referim”, pra ajo që vlen për regjimin martesor vlen edhe për kontratat në mënyrë të përgjithshme. Përjashtimi i referimit konfirmohet nga konventa e hagës në lidhje me ligjin që zbatohet për regjimet martesore dhe nga Rregullorja “Romë I” në lidhje me ligjin që zbatohet për detyrimet kontraktore.⁴

Duhet gjithashtu të nënvizojmë se referimi përjashtohet edhe në rastet kur palët nuk kanë përcaktuar ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien e tyre. Kjo zgjidhje shpjegohet, nga fakti se në raste të tilla vendodhja e kontratës përcaktohet në bazë të kriterit të afërsisë materiale mes situatës dhe sistemit juridik që përcaktohet nga rregulla e konfliktit. Nga kjo rrjedh që nuk do të ishte koherente të autorizohet ligji, i cili paraqet *in concreto* lidhjet më të ngushta me situatën, të refuzojë kompetencën e vet. Duke u nisur nga ky vëzhgim mund të shpjegojmë se përse rregullorja “Romë II” mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jo

kontraktore e përjashton shprehimisht referimin⁵. Referimi është gjithashtu i përjashtuar në zbatimin e rregullave të konfliktit me lidhje alternative.

2. Referimi në një shtet të tretë

Ky referim mund të paraqiten ndryshe si referimi në shkallë të dyte, dhe nënkupton se ligji i përcaktuar nga rregulla e konfliktit të vendit të ngjarjeës i referohet një ligji të tretë, i cili konsiderohet kompetent për këtë rast. Psh; sipas të drejtës ndërkombëtare private franceze statusi personal i një anglezi me banim në danimarkë varet nga ligji kombëtar i këtij personi. Në shkallë të parë është kompetent ligji anglez, por ky ligj parashikon se statusi personal lidhet me vendbanimin që do të thotë ky ligj i referohet, në shkallë të dytë, ligjit danez. Ky i fundit e pranon kompetencën si ligj i vendit të banimit. Cfarë do të ndodhë nëse ligji danez do ti referohej ndonjë ligji tjetër? Kjo gjë mund të shkonte kështu pafundësisht, nga shkalla në shkallë, megjithëse rreziku që kjo të ndodhë është më shumë teorik sesa real, sepse numri i sistemeve që rregullojnë një situatë ligjore është gjithmonë i kufizuar.⁶

Duke trajtuar mendimin sipas të cilit duhet të procedohet nga referimi në referim derisa të arrihet një sistem i cili pranon referimin (zbatimi kur përdor një kriter lidhjeje i cili në këtë rast citon atë sistem. Për shembull të mendohet rasti në të cilin duhen disiplinuar raportet personale të një çifti bashkeshortësh të cilët i përkasin shtetit X, të së drejtës ndërkombëtare private në cilësinë e ligji kombëtar të përbashkët bashkeshortëve citon ligjin e shtetit X, i cili nga ana e tij tërret ligjin e shtetit Y ku është celebruar martesja. Nëse ligji i shtetit Y nuk e pranon referimin dhe thërret ligjin e vendit në të cilin është përqëndruar pjesa më e madhe psh në shtetin D apo Z, në të cilin normat e konfliktit konsiderojnë kompetent ligjin e shtetit në të cilin është përqëndruar pjesa më e madhe e jetës bashkëshotore. Në këtë rast duhet të gjejnë zbatim: e drejta materiale e shtetit

D; e drejta materiale e shtetit Z? Mungesa absolute e lidhjes në raport me traditën tonë legislative dhe juridprudenciale si dhe favori i pamjaftueshëm që i rezervohet nga doktrina bën të mundur që interpretuesi ti përmbahet plotësisht kuptimit leksikor, kuptimit të dispozitave në fjalë. Ndërsa është menjëherë e kuptueshme se një shtet të vendosë rregulla për të përcaktuar se cilën të drejtë duhet të aplikojë gjykatësi i tij, arsyet për të cilat një shtet vendos rregulla për të përcaktuar cili sistem i huaj duhet të diktojë të drejtën që duhet të zbatojë gjykatësi i tij nuk kuptohen në mënyrë të menjëherëshme. Duhet të reflektohet mbi faktin se, nëse te referimi dallohet një instrument i përshtatshëm për të futur fleksibilitet në sistemet e së drejtës ndërkombëtare private, legjislatorët modernë kanë instrumente mjaft efikase në krahasim me kohën kur u hap diskutimi në lidhje me referimin. Vlen të theksohet se mes normave të konfliktit për përcaktimin e zbatimit të referimit, përdorin si kriter mbylljeje atë të përqendrimit më të madh të jetës bashkëshortore, ndërkohë që e njëjta doktrinë (në funksion të kundërshtimit tradicional ndërmjet kriterit të lidhjes së shtetësisë dhe të vendbanimit) që e favorizon atë vë në dukje se si referimi i përshtatet kriterëve të llojit të ri, në vecanti pikërisht të atyre që konsistojnë në lidhjen më të ngushtë që ka raporti që duhet rregulluar me një sistem të caktuar. Me fjalë të tjera, institucioni i referimit mund të gjente justifikim vetëm në fushën e një sistemi të së drejtës ndërkombëtare private të ngurtë, pra i karakterizuar nga kriteret lidhjeje jo fleksibël. Por shtyrja i përshtatet edhe karakterit aktual të kriterit të shtetësisë. Në fakt ky kriter duket i destinuar të funksionojë me një frekuencë në rritje në raport me personat të cilët kanë shumë shtetësi, duke futur një element fleksibiliteti- thirrja e bërë nga normat e konfliktit kuptohet si rebelim ndaj ligjit të shtetit me të cilën personi ka lidhjen më të ngushtë.⁷

E drejta jonë ndërkombëtare private e lejon referimin në një shtet të tretë dhe e rregullon në mënyrë të tillë... “ Kur

ligji i një shteti të huaj referon në ligjin e një shteti të tretë, zbatohet ligji i këtij të fundit”⁸. Në dallim nga e drejta jonë ndërkombëtare private, ka shtete që nuk e pranojnë referimin në një shtet të tretë.

3. Referimi në një rend juridik të një shteti me sistem “common law”

Në qoftë se për referimet në rendet juridik të shtetëve me sistemin “civil lloë” e njohim ligjin që do zbatohet për problemin që referohet, ndryshe ndodh më sistemin ‘common loë’. Në këto vende një çështje e caktuar në gjykatë nuk zgjidhet si tek ne, kjo pasi në këto sisteme pranohet precedenti gjyqësor. Kjo nënkupton që për çështje të ngjashme gjykata, jep vendim bazuar në vendimet e mëparshme për çështje të tilla, që do të thotë në këto vende lejohet që vendimi të jepet në formë të tillë ku për bazë të merret një vendim i mëparshëm që fiton fuqinë e ligjit. Prandaj kur ne referojmë në rendin juridik të një shteti të “common lloë”, kjo nuk do të thotë se do të zbatohet ligji, madje një gjyqtar në SHBA mund ta quaj antikushtetues një ligj e mos ta zbatojë atë. Kjo gjë vlen për tu thënë më tepër për kontratat ku palët mund të zgjedhin se cila gjykatë të zgjidhë mosmarrëveshjen në lidhje me kontratën.

4. Referimi në ligjin e shtetit që ka dia sisteme ligjore.

Problematika e të ashtuquajturave konflikte të ligjeve të brendshme, paraqitet në lidhje me shtetet plurilegjislativë, ose më saktë atyre shteteve në të cilat janë në fuqi më shumë legjislacione civilistike, si mbi bazën territoriale (konflikte ndërllokale) ashtu edhe mbi bazën personale (konflikte ndërpersonale).

Konfliktet ndërllokale ekzistojnë kur në zona të ndryshme (rajone, shtete, provinca, kantone) që është ndarë shteti janë në fuqi normative të ndryshme. Rastet janë ato të shteteve federale (si SHBA dhe Kanada) ku anëtarë të ndryshëm të federatës gëzojnë autonomi legjislativë, të shteteve të

bashkuara politikisht por të ndara legjislativisht. Konfliktet ndërpersonale krijohen kur në territorin e shtetit janë në fuqi disa legjislacione në të njëjtën kohë, por që secila prej tyre është e zbatueshme vetëm ndaj një kategorie të caktuar personash.

Në shtetin ku është në fuqi një sistem juridik i unifikuar, problem i konflikteve të ligjeve të brendshme shtrohet vetëm në mënyrë indirekte, pra vetëm kur një nga normat e së drejtës ndërkombëtare private përcakton si të zbatueshme të drejtën e një shteti plurilegjislativ. Normat e konfliktit janë formuluar në mënyrë që të thërrasin në kompleksitetin e tyre sistemet e entiteteve të tjera të llojit shtetërorë të cila kanë subjektivitet juridik ndërkombëtar.

Pra ligji i zbatueshëm është vetë ligji që do të zbatohet për zgjidhjen e problemit, që do të thotë referimi si normë konflikti nuk referon në një rend juridik të huaj, ku përfshihet edhe respektimi i të drejtës ndërkombëtare private të vendit në fjalë, por referon edhe direkt mbi ligjin e zbatueshëm.

Referimi mbi ligjin e zbatueshëm me referim në ligjin (rendin juridik) e një vendi ndryshojnë. Kur nga e drejta ndërkombëtare private referohet në rendin juridik të një vendi, apo kur vetë palët në një marrëveshje zgjedhin ligjin e një vendi të huaj duke e përcaktuar, atëherë në lojë futet edhe e drejta ndërkombëtare e shtetit të huaj. Kjo nënkupton se do të shihet edhe se si e rregullon e drejta ndërkombëtare privatë e atij shteti çështjen në fjalë. Ky është referimi në kuptimin primar të tij, si referim në rendin juridik të huaj. Kur referimi bëhet mbi vetë ligjin e zbatueshëm, duke e përcaktuar këtë të fundit si ligji që do të aplikohet për zgjidhjen e konfliktit, kemi të bëjmë me referim në ligj të aplikueshëm, çka nënkupton se rregullat e së drejtës ndërkombëtare private të shtetit të huaj nuk do të merren parasysh, por do të merret direkt ligji i huaj për zgjidhjen e konfliktit. Kjo nuk do të thotë se ai do të merret si tekst dhe do të interpretohet se si e kuptojmë ne, por do të merret siç është

dhe do të interpretohet dhe zbatohet në pajtim me kriteret e interpretimit dhe zbatimin e tij në shtetin e origjinës.⁹

5. Kritikat në lidhje me referimin

Çështja e pranimit apo refuzimit nuk është thjesht një çështje që lidhet me teknikën. Ajo lidhet me të drejtën ndërkombëtare në tërësinë e saj. Kjo është arsyeja e kritikave të forta në këtë fuushë. Më poshtë do të analizojmë tezat e autorëve që janë kundër referimit.

Pasuesit e francezit bartin kanë pasur prirjen ta shohin referimin si diçka të lidhur me konfliktin e sovranitetit. Kundështia ndaj referimit mbështetet në idenë se shteti francez nuk mund të heqë dorë nga sovraniteti i tij dhe të lejojë zbatimin e rregullave të konfliktit të një shteti të huaj. Por ideja e Bartenit ishte akoma më e sofistikuar, sepse sipas tij çështja e referimit as që nuk duhet të shtrohet : pasi të jetë përcaktuar ligji i huaj, konflikti i ligjev duhet konsideruar përfundimisht si një rregull, pra nuk ka arsye të rihapet debate mbi këtë çështje.¹⁰

Por ky argument nuk ishte bindës, pasi ideja e respektimit të sovranitetit mund të ketë një rezultat krejt të ndryshëm me atë që pritet: nëse respektimi i sovranitetit është arsyeja që shpjegon karakterin definitive të rregullës së konfliktit, domosdoshmëria e respektimit të sovranitetit të huaj, në krahun e kundërt, mund të justifikojë referimin. Këtu kemi të bëjmë me një justifikim të referimit me tipare unilaterale, sipas të cilit referimi justifikohet nga ideja se nuk duhet zbatuar një ligj i huaj kur vetë ky ligj deklarohet jokompetent.

Debati është mbyllur pa lindur mirë nga gjykatat e kasacionit në Francë. Ajo ka parashikuar se: “ligji francez i të drejtës ndërkombëtare private nuk shkelet në asnjë mënyrë nga referimi që një ligj i të drejtës ndërkombëtare të huaj i bën ligjit francez”. Kjo do të thotë se gjykata sipas optikës bilateraliste, i dha të drejtë atyre që ishin pro referimit.

6. Teza në mbështetje të referimit

Referimi ka një aspekt praktik shumë të rëndësishëm, sepse kur një ligji huaj referohet ligjit të gjyqtarit që trajton çështjen, ky i fundit është shumë i lumtur të zbatojë ligjin e tij dhe jo një ligj të një vendi tjetër. Përtej kësaj lehtësie për gjyqatrin, referimi është në interes të palëve, sepse ato janë të garantuara se gjyqtari i vendit të ngjarjes do të marrë një vendim sipas të njëjtave rregulla që do ishin zbatuar në vendin nga ku bëhet referimi, gjë që mund të lehtësojë qarkullimin ndërkombëtar të vendimeve. Përfitimin e fundit e ka siguria juridike, sepse zbatimi i të drejtës franceze nga gjyqtarët kontrollohet nga gjykata e kasacionit. Por të gjitha këto përfitime të mundshme nuk janë të mjaftueshme që pranimi i referimit të mbështetet në një teori të veten. Për këtë arsye janë zhvilluar dy koncepte të referimit, 1. *Referim rregull-alternative*; 2. *Referim bashkërendim*.¹¹

6.1 Referim rregull-alternative

Analizimi i referimit si një mekanizëm rregullator alternative të konfliktit të ligjeve është bërë nga Lerebours-Pigeonniere dhe pranohet akoma në ditët e sotme nga disa autorë.¹² Ai mbështetet në idenë se refuzimi i një ligji të huaj që është përcaktuar si ligj kompetent tregon se ekziston një mangësi në rregullën e konfliktit të vendit të ngjarjes, në vazhdim ky refuzim kompetence e detyron vendin e ngjarjes të hartojë një rregull të re konfliktit, e cila mund të konsiderohet si rregull alternative për arsye se zbatohet vtëm kur legjislacini i përcaktuar nga rregulla e zakonshme e konfliktit e refuzon kompetencën e saj. Teza e referimit rregullore alternative është interesante, sepse thekson nevojën për fleksibilitet në lidhjen e çështjes ligjore. Në këtë kontekst, lidhja që parashikon rregulla e zakonshme e konfliktit konsiderohet si një preferencë e thjeshtë e vendit të ngjarjes, e cila mund të përjashtohet nëse është e nevojshme. Sipas këtyre autorëve lidhja e re përcaktohet rast pas rasti, me qëllimin e vetëm për të respektuar lidhjen

që parashikohet në ligjin e huaj. Sipas Niboyet kthimi në kompetencë të ligjit të vendit ka të bëjë me rendin publik, sepse sipas tij kjo kompetencë nuk lejon që një situatë ligjore e cila ka lidhje me francën, të mbetet e pazgjidhur. Në këtë rast zgjidhja është e drejtëpërdrejtë, sepse i jep përparësi, në parim, ligjit francez në rast refuzimi të kompetencës nga një ligj i huaj. Megjithatë edhe pse zgjidhja frymëzohet nga karakteri politik i të drejtës ndërkombëtare private franceze janë për tu parë disa sqarime duke parë që nuk flitet realisht dhe vetëm për “referim”¹³ por trajton rastet e refuzimit të kompetencës nga ligji i huaj, pa u shqetësuar për respektimin e mëtejshëm të rregullave të konfliktit të tij.

6.2 Referim bashkërendim

Teza e dyte e referim-bashkerendimit është zhvilluar nga Bartifol dhe mbështetet në idenë se referimi rrjedh nga vete rregulla e konfliktit të një shteti të dhënë si dhe parashikon mundësinë e koordinimit të saj me rregullat e konfliktit të rendit juridik të huaj të përcaktuar. Kështu që nuk çenohet sovraniteti i vendit ku ka ndodhur ngjarja. Në përgjithësi, teza e referim-bashkërendimit është e vetmja që merr realisht parasysh jurisprudencën. Ajo është e vetmja që shpjegon saktësisht referimin në shkallë të dytë ose rireferimin si dicka që lidh rregullën e konfliktit të shtetit me rregullën e huaj të konfliktit. Ajo është gjithashtu më e aftë të shpjegojë mekanizmin e referimit që ndodh kur rregulla jonë e konfliktit përcakton një ligj të huaj të paunifikuar: ideja e bashkerendimit bën të mundur të shpjegohet se i përket rregullës së huaj të konfliktit të zgjidhë konfliktin e ligjeve të brendshme.

Përfundime

Konfliktet në marrëdhëniet juridiko-civile me element të huaj janë të shumta, dhe ndërhyrja që bën referimi në rrendin juridik apo në ligjin drejtpërdrejt të zbatueshëm nga ana e normës së konfliktit është me të vertetë një zgjidhje e madhe

juridike. Në këtë mënyrë i jepet drejtim problemit, duke i ndarë gjërat në mënyrën e duhur. Ekzistenca e arsyeve të shumta që mund të justifikojnë referimin është tregues mëse i qartë i mënyrave të ndryshmetë perceptimit të vetë rregullës së konfliktit. Pra është e natyrshme që zhvillimi bashkëkohor i metodave të së drejtës ndërkombëtare private të ndikojë edhe të referimi. Një grup juristësh mbështesin idenë e një referimi “selektiv”, i cili nuk e sheh të nevojshme të zgjedhë mes pranimit automatik dhe refuzimit “kategorik”. Kjo ide konsiston në pranimin e referimit vetëm në disa fusha, duke pasur gjithmonë parasysh qëllimin që ka rregulla e konfliktit.

Ky sistem ekziston pjesërisht, tashmë, në të drejtën positive, sepse siç e kemi parë më sipër, referimi përjashtohet kur prezumohet me të drejtë se palët kanë dashur të përcaktojnë të drejtën e brendshme, apo kur ngjarja ka lidhje dhe afërsi gjeografike me një sistem të caktuar ligjor. Duhet që paralelisht me zhvillimin e mëtejshëm të rregullave të konfliktit me tipare materiale, të zgjerojmë arsyetimin dhe të kemi parasysh edhe rrethanat që lidhen me të drejtën substanciale, të cilës i referohet. Nëse marrim një shembull, referimi që aplikon ligji i zbatueshëm për formën e një akti juridik mund të përdoret vetëm nëse ai do të kishte realisht të bënte me vlefshmërinë e aktit në fjalë. Rregulla e konfliktit për formën e akteve, e cila përcakton se do të zbatohet ligji i vendit ku janë lidhur këto akte, justifikohet gjithashtu nga dëshira për komoditet dhe siguri ligjore mbi palët. Pra, në kuadrin e frymës së rregullës së konfliktit, nuk do të ishte koherente të autorizojë referimi drejt një ligji tjetër të panjohur zakonisht nga palët, dhe që do të shfuqizonte pasojat e aktit në fjalë.

Nga ana tjetër, referimi mund të pranohet nëse ai do t'i njihet pasojat e këtij akti. Sipas të njëjtës logjikë, referimi në fushën e përcaktimit ligjor të atësisë ose amësisë mund të pranohet vetëm në rast se përcaktohet një ligj, i cili mundëson përcaktimin e atësisë ose amësisë.

Ligji jonë për të drejtën ndërkombëtare është ai që zgjidh konfliktet duke referuar në përputhje me legjislacionet e BE dhe me konventat e ratifikuara. Ai referon në një mënyrë që nuk prek rendin publik, e që mbron shtresën më në nevojë, si në rastin e birësimit apo të marrëdhënieve prind-fëmijë.

Referenca

1. Daniel Gutman, E drejta nderkombëtare Private, botimet papyrus 2009. Fq 106.
2. Neni 6 . ligji 10 428, dt 02.06. 2011 “Për të Drejtën Ndërkombëtare Private”
3. Maks Qoku “ E Drejta Ndwrkombwtare Private”, Botimet Morava, Tirane 2015. Fq. 127
4. Neni 3/1, ligji 10428, datw 02.06. 2011
5. Observations sur la question du renvoi JDI 1924, 877
6. Neni 24 i Rregullorja “Romë II”
7. Daniel Gutman; E drejta Nderkombëtare Private. 2009.
8. Neni 57/a ligji 10 428, datë 02. 06. 2011
9. Neni 3/1 ligji 10 428, datë 02. 06. 2011
10. Neni 20 i Rregullorja “Romë I”
11. Neni 33/2, ligji 10428, datë 02. 06. 2011.
12. A. Kalia, “E Drejta Ndërkombëtare Private”, SEJKO, Tiranë 2010.

Literaturë

1. Ligjinr. 10428 dt. 02.06. 2011 “Për të Drejtën Ndërkombëtare Private”
2. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, 1996.
3. Ardian Kalia, “E Drejta Ndërkombëtare Private”, Sejko, Tiranë 2010
4. Maks Qoku “ E Drejta Ndërkombëtare Private”, Botimet Morava, Tiranë 2015
5. Daniel Gutman; E drejta Nderkombetare Private. Papyrus, 2009
6. Endri Papajorgji, E Drejta Ndërkombëtare Private; ILAR, 2013
7. Hajredin Kuçi, Asllan Bilalli, Kolizioni i ligjeve, Prishtinë, 2006;
8. The Doctrine of Rencoi in Internacional Torts: Mercantile Mutual Insurance v Neilson (2005) 13 Torts Low Journal I.
9. H. BATIFFOL dhe P. LANGARDE, traite de droit international prive, vëllimi I, LGDJ, botimi 8 1998.
10. http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.text&cid=2
11. <http://civil.udg.edu/iecl/>
12. <http://en.wikipedia.com>
13. <http://www.eui.eu/DepartamentsAndCentres/Law/ResearchAndTeach-ing/ResearchThemes/EPL/EPLForum.aspx>
14. [http //www.oas.org/dil/PrivateIntLaw-studytop-ics_applicablelaw.htm](http://www.oas.org/dil/PrivateIntLaw-studytop-ics_applicablelaw.htm).

Referenca

- ¹ A. Kalia, "E Drejta Ndwrkombwtare Private", SEJKO, Tiranw 2010.
- ² Neni 33/2, ligji 10428, datw 02. 06. 2011.
- ³ Neni 57/a ligji 10 428, datw 02. 06. 2011
Neni 3/1 ligji 10 428, datw 02. 06. 2011
- ⁴ Neni 20 i Rregullorja "Romw I"
- ⁵ Neni 24 i Rregullorja "Romw II".
- ⁶ Daniel Gutman; E drejta Nderkombetare Private. 2009. Fq 102 .
- ⁷ Maks Qoku " E Drejta Ndwrkombwtare Private", Botimet Morava, Tirane 2015, fq, 127-129
- ⁸ Neni 3/1, ligji 10428, datw 02.06. 2011
- ⁹ Neni 6 . ligji 10 428, dt 02.06. 2011
- ¹⁰ Daniel gutman, E drejta nderkombwtare Private, botimet papyrus 2009. Fq 103.
- ¹¹ Po aty fq 105.
- ¹² Observations sur la question du renvoi JDI 1924, 877,(Vëzhgimet mbi çështjen).
- ¹³ Daniel gutman, E drejta nderkombwtare Private, botimet papyrus 2009. Fq 106.

Resending reference and understanding and implementation of international law in private

MSc. Flutur SHABANI
ShLUJ “Wisdom University”

Abstract

The coexistence of a significant number of sovereign states, the intensification of international civil movement expressed in the emergence of civil and legal relations with foreign elements diversified justify the existence of private international law. This right is fully legal norms that serve to regulate the jurisdiction, procedure, applicable law and other elements associated with it, in a civil and legal relations with foreign elements. Overall rates are no more than those we call the conflict rate, which resolve conflicts in civil legal relations with foreign elements.

A conflict rate makes the choice of applicable law by solving legal conflicts in civil law relations with foreign elements is or can send in a given legal order. In both cases the rate of conflict referring perform its functions, but have recently spoken in reference to a foreign legal order.

Reference is expressed when the collision rate to regulate private and legal relationship with a foreign element goes to the application of the law of a foreign state, as well as the material that kolizive law.

When reference is made on self applicable law, defining the latter as the law to be applied to conflict resolution, dealing with reference to the applicable law, which means that the rules of private international law of that country does not will be considered, but will be taken directly to foreign law to resolve the conflict.

Keywords:

Private international low, court, collision, rules, states



Msc. Flavia KENAJ
ShLUIJ "Wisdom University"

Sfidat e bashkimit familjar në procesin e integritimit evropian

Abstrakt

Migracioni është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet Bashkimi Europian. Legjislacioni i tij përkrah një nivel të unifikuar të të drejtave dhe obligimeve të imigranteve legal në krahasim me qytetarët europian. Në këtë kuadër programi i Stokholmit propozon një përafrim global mbi migracionin si një alternativë për të harmonizuar politikat e ndryshme brënda unionit. Ajo do të fokusohet në identifikimin e interesave të përbashkët me vendet e treta të migrimit duke u munduar të gjejnë një mënyrë efikente për të kontribuar në zhvillimin e vendeve të përfshira në këtë proces. Në këtë kontekst bashkimi i familjeve emigrante është shndërruar në një çështje kontraversale mbi humanitarizmin dhe të drejtat e njeriut ashtu sikurse edhe politikat shumë të debatuar të imigracionit. Duke parë këto premisa qëllimi i këtij punimi është të analizojë evoluimin e legjislacionit të BE-së si dhe jurisprudencës së lidhur me çështjet e bashkimit familjar. Në nivel ndërkombëtar janë disa instrumenta në të cilat e drejta e bashkimit familjar vjen e nënkuptuar. Në fakt rregullat komunitare për një menaxhim sa më të mirë të ligjit mbi familjen janë esenciale për maksimalizimin e benefiteve të migrimit legal. Në veçanti ky punim do të fokusohet në bashkimin familjar brënda BE-së si dhe të fëmijëve të pashoqëruar që mbërrijnë në kufijtë e këtyre vendeve. Duke njohur rolin e rëndësishëm që bashkimi i familjeve luan në procesin e integritit të emigrantëve, europianët kanë marë disa masa ndaj kësaj sfide duke u munduar të gjejnë dhe të ndërtojnë një partneritet të frytshëm me vendet jashtë Bashkimit Europian si vendet e origjinës apo ato tranzit si dhe duke e futur çështjen e imigrimit në rendin e ditës në politikat globale.

Fjalët kyçe:

migrim, bashkim familjar, fëmijë të pashoqëruar, Bashkimi Europian.



Hyrje

Traktati i Lisbonës imponoi ndryshime të rëndësishme në lidhje me politikat e emigracionit të ligjshëm të tilla si vendosja e bazave ligjore për integrimin e shtetasve të vëndeve të treta, jo anëtare, kontrrollin mbi numrin e pranimeve të këtyre shtetasve si dhe të marrjes së vendimeve të përbashkëta për zbatimin e marrëveshjeve të miratuara në unanimitet. Duke parë se në lidhje me këtë çështje ka qëndrime të ndryshme dhe pika të ndryshme këndvështrimi, punimi do të fokusohet në dy problematika të rëndësishme ligjore mbi familjen të lidhura me emigracionin në BE që kanë të bëjnë pikërisht me bashkimin familjar dhe të miturit që vijnë në europë të pashoqëruar. Të dyja këto problematika janë konsideruar si prioritare për hartimin e legjislacionit për migracionin në BE për të cilat ndërhyrja duhet të jetë sa më efiçente. Programet e mirëstrukturuara për politikat integruese për vendet migratore të destinacionit janë një tregues shumë i mirë edhe i faktit se ajo që merr rëndësi nuk është vetëm tradita dhe eksperiencia e mëparshme lidhur me këto çështje por edhe dëshira dhe vullneti politik. Rëndësia e politikave të bashkimit familjar në BE është evidente pasi kjo gjë lidhet me vlerën e madhe dhe kontributin që japin emigrantët për vendet europiane në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin që gjenerojnë. Kjo vlerë do të mund të maksimalizohet vetëm nëse këto persona do të mund të integroheshin plotësisht në shoqërinë e vendeve pritëse. Në këtë këndvështrim vendet po mundohen që të barazojnë të

drejtat e familjeve rezidente me qëndrim të përhershëm dhe familjeve emigrante në mënyrë që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në ato vende të cilat mbështesin integrimin e tyre.

1. E drejta për të bërë një jetë familjare duke u bazuar në instrumentat europiane dhe ndërkombëtarë duke respektuar edhe diskrecionin e vendeve në veçanti.

Sipas Konventës Europiane të të drejtave të njeriut neni I i saj i rekomandon shteteve anëtare që ti garantojë të gjithë personave brënda juridiksionit të tyre respektimin e lirive dhe të drejtave. Fjala “të gjithëve” do të përfshijë jo vetëm qytetarët europian por edhe emigrantët që kanë hyrë në territoret e Bashkimit Europian qofshin emigrant të ligjshëm ose jo. Në mënyrë specifike Konventa nuk përmend të drejtën për bashkim familjar por artikulli 8 i saj përcakton të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare. Mbrojtja që i jep familjes shteti dhe shoqëria, si grupi shoqëror fundamental dhe natyral i një shoqërie, garantohet prej shumë instrumentave ndërkombëtarë dhe europianë gjithashtu, të tilla si neni 23 i Konventës Ndërkombëtare Për Të Drejtat Civile dhe Politike, neni 16 i cili përcakton të drejtat e mbrojtjes juridike, ekonomike, sociale të familjes, neni 19 i Kartës Sociale Europiane e cila i siguron të drejtën punëtoreve që janë emigrantë dhe familjeve të tyre mbrojtje dhe asistencë.

Problemi i migrimit rregullohet prej nenit 79 të Traktatit të Funkcionimit të BE i cili përcakton se unioni duhet të zhvillojë dhe të ndjekë një politikë të përbashkët mbi emigracionin e cila ka për qëllim të sigurojë në të gjitha këndvështrimet eficienten e manaxhimit të të gjitha fushave të migracionit në mënyrë që emigrantët që vijnë në mënyrë të rregullt në BE të gëzojnë një trajtim të drejtë. Pa dyshim , anëtarët e BE duhet të zbatojnë rregullat që imponojnë direktivat dhe traktatet në mënyrë rigorozë dhe konstante duke dalë në mbrojtje të të drejtave fundamentale të njeriut.

Konventa Europiane Për Të Drejtat E Njeriut në mënyrë të përsëritur i ka mëshuar rëndësisë së proporcionalitetit midis masës dhe ndjekjes së qëllimit duke i penguar shtetet e veçanta të ndërrmarrin veprime të cilat bien në kundërshtim me të drejtën për të pasur një jetë familjare (si për shembull në adoptimin e urdhrave të dëbimit) si dhe duke u bërë thirrje atyre që të marrin masa për të dhënë efekt këtyre të drejtave . Sipas statistikave të 2010 praktikat më të mira në BE për politikat e bashkimit familjar janë ndjekur prej Portugalisë, Spanjës dhe Suedisë, ndërkohë që politikat disfavrizuese janë implementuar prej Irlandës, Danimarkës apo edhe Qipros.¹ Instrumentet ndërkombëtare të tilla si ato që përmëndëm më lart nuk i garantojnë një anëtar të familjes një të drejtë individuale që të hyjë në territorin e një shteti duke rezervuar një hapësirë të mëvonshme për vlerësimin e aplikimit për bashkimin familjar. Në fakt në lidhje më këto problematika Gjykata Europiane e Drejtësisë përcakton se sipas ligjeve komunitare “ nuk duhet të tejkalohen limitet e imponuara nga të drejtat themelore në lejimin e shteteve anëtare të cilat kanë apo shpresojnë të adoptojnë, legjisllacione specifike për të rregulluar aspekte specifike mbi të drejtat e bashkimit familjar.²

2. Direktivat europiane mbi bashkimin familjar, çështja e definimit të familjes.

Bashkimi familjar në BE rregullohet prej dy direktivave kyçe të cilat mund të konsiderohen si hapat fillestar drejt harmonizimit të politikave të unionit. Direktiva 2003/86 e Komisionit Europian e njohur si direktiva e Bashkimit familjar e cila përcakton se cilat do të jenë kushtet e pranimit për anëtarët e familjes për ato persona që vijnë prej vendeve të treta jo anëtare.³ Ndërkohë Direktiva 2004 neni 38 i Parlamentit Europian dhe e Këshillit⁴ rregullon çështjen e bashkimit familjar për anëtarët e familjeve që vijnë nga vendet e treta të cilët kanë mbërritur në BE duke ushtruar të drejtën e lëvizjes së lirë brënda unionit. Lëvizja e lirë e personave

dhe dizpozitat që lidhen me bashkimin familjar mund të konsiderohen edhe si të drejtat dhe privilegjet më të rëndësishme që gëzojnë qytetarët europianë. Sipas Direktivës për bashkimin familjar vërtëm bashkëshortët dhe fëmijët e pamartuar mund të aplikojnë dhe të përfitojnë prej marrëveshjeve favorizuese dhe vetëm personat të cilët gëzojnë statusin e plotë të refugjatit mund të paraqiten si sponsor për të pritur pjesëtarët e tjerë të familjes. Disa prej këtyre parashikimeve janë modifikuar në direktivën e 2009 neni 50 i Këshillit Europian ku u përfshijnë edhe lehtësira në lidhje me punonjësit mbi kualifikuar.⁵ Direktiva e njohur si “Direktiva e të Drejtave të Shtetasve” e vitit 2004 në nenin 50 përcaktoi të drejtën e lëvizjes së lirë për qytetarët e unionit, pra kur ata lëvizin nga shteti i origjinës në një shtet tjetër po ashtu anëtarë të BE-së, si një e drejtë që u njihet edhe familjeve të tyre që dëshirojnë të bashkohen me ta. Në disa shtete vështirësitë për të përmbushur kërkesat mjaft strikte ndaj aplikantëve për tu futur në vendet e pritëse bëhen shpesh herë vendimtare për ndarjen e famijes dhe si pasojë e kësaj vjen pashmangërisht shkelja e të drejtës themelore që përcaktohen nga konventat për respektimin e jetës familjare.⁶

Për sa i përket kushteve sipas së cilave fitohet e drejta për bashkim familjar, kjo e drejtë do të ketë edhe kufizimet e saj të cilat përcaktohen prej rendit dhe sigurisë publike. Për më tepër, shtetet europiane mund edhe t’ju kërkojnë të huajve që të përmbushin të gjitha kriteret e paracaktuara për të gëzuar këtë të drejtë e po ashtu kanë liri të plotë për të vendosur edhe kushtet shtesë, të tilla si mundësi adeguate akomodimi, burime të mjaftueshme material apo edhe pasja e sigurimeve shëndetësore. Një përjashtim bëhet prej atyre që quhen Kartat Blu të BE-së⁷ qëllimi i të cilave është që të facilitohet pranimi i punëtarorëve të mbikualifikuar dhe familjeve të tyre duke elaboruar një sistem pranimi të përshpejtuar duke i siguruar kësaj kategorie personash të drejta socio-ekonomike të barabarta me shtetasit e shteteve

anëtare. Blu karta në këtë mënyrë do të shërbejë për bashkimin e menjëhershëm të pjesëtarëve të familjes (bashkëshortëve apo fëmijët e mitur) pavarësisht perspektivës për të respektuar rregullat për afatet e lejeqëndrimeve apo të qëndrimit të përkohëshëm si një kërkesë për tu integruar plotësisht në këto vende. Kjo mund të konsiderohet si një lehtësirë e konsiderueshme po të marrim parasysh kushtet e përgjithshme që zbatohen në bazë të direktivës për bashkimin familjar për shtetasit e vendeve të treta. Konsolidimi i jurisprudencës europiane mbi parimet e njohjes së statusit familjar të shtetasve europianë, prekin po ashtu edhe njohjen e martesave civile.⁸ Sistemet juridike europiane shfaqin herë pas here edhe tendenca për ti dhënë një rëndësi ligjore edhe formave të ndryshme të bashkëjetesave. Kjo nënkupton përballjen me çështje edhe të ligjit për të drejtën dërkombëtare private të tilla si njohja e ligjeve të brëndëshme mbi disa martesat apo edhe disa partneriteteve të tjera si dhe efektet e lidhura me to⁹ (si për shembull përftimet material, kontributet kompesuese ndaj bashkëshortëve etj), apo edhe për martesat midis personave për të cilat vendet e origjinës zbatojnë dhe shtrijnë efektet e tyre, siç mund të jenë martesat simultane, të tilla si ato që njihen në vendet e besimit Islamik të cilat të drejtën e tyre positive e kanë ndërthurur edhe me elemente të Sheriatit. Disa prej këtyre çështjeve janë zgjidhur duke iu referuar rendit publik, ligjit të brëndëshëm si dhe ligjeve ndërkombëtare.

Megjithtë, koncepti i politikave publike duhet të interpretohet në kontekstin e vlerave bashkëkohore të qytetërimit europian. Po ti referohemi preambulës së artikullit 86 neni 10 i Komisionit Europian përcakton se : E drejta e bashkimit familjar duhet të ushtrohet në përputhje me vlerat dhe parimet e njohura prej shteteve anëtare, në veçanti në mbrojtje të të drejtave të grave dhe të fëmijëve, kjo përputhshmëri do të justifikojë edhe mundësinë e marrjes së masave ndaj aplikimeve për bashkim familjar të familjeve poligame. Megjithatë ajo që do të meret në konsideratë edhe

në këto raste është interesi më i lartë i fëmijëve të lindur brënda këtyre martesave. Në fund nuk duhet të lëmë pa përmëndur se të gjitha masat e marra në lidhje me bashkimin familjar janë në përputhje me dialogun ndërkulturorë. Kjo konsiderohet prej autorëve të ndryshëm edhe si çështja më delikate me të cilën duhet të përballemi sidomos për sa i përket kategorisë së emigrantëve dhe të miturve.

3. Problemi i të miturve të cilët vijnë të pashoqëruar në bashkimin europian

Ka të paktën një ndryshim të rëndësishëm, në mes të fëmijëve të pashoqëruar dhe emigrantëve të rritur. Emigrantët e mitur janë më të prekshme dhe të pambrojtur në dallim me emigrantët të cilët janë maturë pasi fëmijët kanë më pak gjasa për t'u vënë re, së paku në terma afatgjatë, si anëtarë potencialisht produktive të shoqërisë në vendet pritëse. Statusi i tyre si të mitur ka shtruar çështjen e bërjes së një përjashtimi të veçantë prej ligjit apo procedurave normale të imigracionit pasi duhet të krijohen për ta' parashikime të reja në ligj. Edhe Bashkimi Europian është munduar në këtë kuadër që të hartojë politika afargjata për të siguruar statusin e fëmijëve të mitur emigrant të pashoqëruar nga prindërit apo kujdestarët e tyre. Kjo politikë do të vijë e përshtatur me statusin e tyre si të mitur të cilët kanë nevojë për përkudësje dhe të shmangët trajtimi i tyre si emigrant të zakonshëm që kalojnë kufijtë qoftë mënyrë të ligjshme apo të jashtëligjshme.

Po së pari është mirë që të japim një definicion me atë se çfarë do të kuptojmë me termat, të *mitur të pashoqëruar*, *fëmijë migrant*, *fëmijë emigrant të pashoqëruar*. Shpesh këto terma përdoren duke iu referuar emigrantëve të cilët janë nën moshën 18 vjeçare dhe që nuk janë të shoqëruar dhe nën kujdesin e prindërve apo të kujdestarit ligjor të tyre.¹⁰ Kjo përfshin fëmijët që largohen nga dhuna dhe trazirat, që kërkojnë punë, apo që janë viktimat e trafikimit.

4. Fëmijët e pashoqëruar në Bashkimin Evropian.

Edhe pse numrat dhe vendet e origjinës ndryshojnë në varësi të shtetit anëtar, është e mundur për të bërë disa përgjithësime në lidhje me karakteristikat e fëmijëve të pashoqëruar në Bashkimin Evropian. Dy burimet kryesore të të dhënave nuk vijnë nga pikat kufitare, por nga kërkesat për azil dhe objektet ku të miturit e pashoqëruar janë vendosur, pasi ata janë diktuar dhe kapur prej autoriteteve. Sipas Eurostat, zyra e statistikave të Bashkimit Evropian, 12,200 miturit regjistruar për statusin e azilit në Evropë në vitin 2009.¹¹ Vlen të përmendet se jo çdo vend i BE-së mban statistika të sakta që ti përgjigjen këtij fenomeni pasi metodat e mbledhjes së të dhënave nuk janë të harmonizuara midis vetë shteteve anëtare.

Në shumicën e shteteve anëtare, shumica e fëmijëve të pashoqëruar aplikojnë për azil. Përveç kësaj për të përfituar prej politikave favorizuese të disa shteteve anëtare të BE-së ndaj azilkërkuesve, ky mund të jetë rasti më i mirë për të kërkuar azil pasi ai është një nga mënyrat më të mira përmes të cilës një i mitur i pashoqëruar mund të gëzojë një status të caktuar ligjor në vendin ku ka mundur të emigrojë. Shumica e të miturit e pashoqëruar që paraqesin kërkesat për azil në Bashkimin Evropian janë djem të moshave ndërmjet 16 dhe 18 vjeç dhe vijnë përgjithësisht nga vende të goditura prej varfërisë si për shembull vendet Afrikane apo vende si Iraku, Afganistani apo së fundmi Siria, ku fëmijët më së shumti zhvendosen prej vendit të tyre për shkak të luftrave. Në vitin 2008, Afganistani kryesonte listën e vendeve dërguese me rreth 3,400 kërkesave (shih tabelën I).

Tabela I.4. Vëndet e origjinës me kërkesat më të larta për azil prej fëmijëve të pashoqëruar për vitin 2008.

Vëndi i origjinës	Numri i aplikimeve të rregjistruara.
Afganistani	3399
Iraku	1639
Somalia	1299
Rusia	502
Eritrea	494
Irani	407
Kina	260
Pakistani	199
Nigeria	194
Republika Demokratike e Kongos	173

Burimi: European Migration Network, Raporti përmbledhës: Të miturit e pashoqëruar (Maj 2010)

Kërkesat për azil janë rritur në mënyrë dramatike në Suedi dhe Finlandë gjatë këtyre viteve të fundit dhe gjithashtu në nivele të larta vazhdon të jetë edhe në Mbretërinë e Bashkuar . Në vitin 2008, Mbretëria e Bashkuar ka marrë më shumë kërkesa për azil nga të miturit e pashoqëruar se çdo vend tjetër të BE-së, e ndjekur nga Suedia, Gjermania dhe Holanda.(shih tabelën II)

Tabela II.4. Vëndet që kanë numrin më të lartë të kërkesave për azil prej fëmijëve të pashoqëruar, 2004-2009

	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Mbretëria e Bashkuar	2990	2965	3450	3645	4285	2977
Suedi	388	398	820	1264	1510	2248
Gjermania	636	331	186	180	763	268
Hollanda	594	515	410	433	726	1033
Finlanda	140	220	112	90	706	544
Austria	914	790	414	516	697	1042
Italia	N/A	N/A	N/A	N/A	573	424
Belgjika	675	654	491	555	470	736
Franca	1221	735	571	459	410	4286
Polonia	230	278	282	356	376	360

Burimi: EMN Raporti përmbledhës: Të miturit e pashoqëruar (Maj 2010), EUROSTAT (për shifrat e 2009)

5. Qëndrimi i Bashkimit European

Në Evropë, direktivat dhe legjislacioni, duke përfshirë dispozitat që trajtojnë çështjen e fëmijëve të pashoqëruar, janë frymëzuar gjithmonë nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Shtetet anëtare të BE-së në këtë kuadër kanë ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila përcakton interesin më të mirë të fëmijës, si udhërrëfyes i të gjitha politikave që zhvillohen në lidhje me trajtimin e të miturve.

Legjislacione të tjera relevante në zbatim përfshijnë Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European dhe Direktivën e Riatdhesimit. (shih Tabelën III).

Tabel III. 5. Legjislacioni i BE lidhur me fëmijët e mitur të pashoqëruar.

Ligji Komunitar Lidhur me UAC (User Account Control) Karta e të Drejtave Themelore të BE Neni 24: Përcakton interesin më të lartë të fëmijës. Neni 14: Mandaton të drejtën për edukim. Neni 32: Ndalon punën për të miturit. Rezoluta e Këshillit e 26 Korrikut 1997 për fëmijët e pashoqëruar që janë shtetas të vendeve të treta. Përcakton udhëzimet për trajtimin e të miturve të pashoqëruar, duke përfshirë pranimin, pritjen, qëndrimin dhe kthimin. Marrëveshja Shengen Aneksi VII, neni 6: Ka për qëllim të zbulojë trafikimin e të miturve nëpërmjet verifikimit të hyrjeve dhe daljeve. Direktiva mbi kushtet e pritjes. Kërkon përfaqësimin ligjor të të miturve, këta të fundit të vendosen pranë të afërmeve, familjeve pritëse apo qëndrave të specializuara. Gjetjen sa më parë të familjeve të të miturve dhe ata që punojnë me të miturit e pashoqëruar të trajtohen në mënyrë speciale.

Rregullorja e Dublinit. Përcakton kriteret për përcaktimin se cila prej Shteteve Anëtare është përgjegjëse për përpunimin e kërkesave për azil të të miturve të pashoqëruar. Direktiva e bashkimit familjar Përcakton rregullat për bashkimin familjar të të miturve të pashoqëruar. Nëse kërkuesi për azil është refugjat, Shtetet Anëtare duhet të lejojë

hyrjen dhe qëndrimin e një kujdestari ligjor apo familjari të tij. Direktiva e KthimitKërkon prej Shteteve Anëtare të ofrojnë ndihmë për të miturit e pashoqëruar nga organet përkatëse, përveç atyre autoriteteve ekzistuese të cilat meren me kthimin e tyre. Vendosin që të miturit e pashoqëruar do të kthehen tek një anëtar i familjes, kujdestar ligjor, ose pranë objekteve adekuate të pritjes. www.europa.eu

Përveç këtyre ligjeve dhe direktivave, Komisioni Evropian, miratojë në maj të vitit 2010 një plan veprimi për të krijuar një qasje të përbashkët dhe të plotë evropiane për të rritur dhe forcuar mbrojtjen e të miturve të pashoqëruar brenda kufijve të saj.¹² Plani i veprimit i bën thirrje Shteteve Anëtare për të mbledhur të dhëna të plota dhe të krahasueshme për migrimin e fëmijëve, të marrë masa për të parandaluar trafikimin dhe migrimin e rrezikshëm të tyre, vendosjen e standardeve të përbashkëta për kujdestarinë dhe përfaqësimin ligjor, dhe për të gjetur “zgjidhje të qëndrueshme në interesin më të mirë të fëmijës.”¹³

Po të bëjmë një analizë praktike të legjislacionit të mësipërm dhe hapave të ndërrmarë prej BE-së vëmë re se ato janë hartuar për të mbrojtur pozitat e fëmijëve të pashoqëruar që vijnë prej shteteve të treta në vendet e anëtare të unionit. Së pari vlen të përmendet se marrja e masave për strehim dhe ndalimin e të miturve bëhet vetëm në interes të të miturit ku ndalimi i tyre apo arrestimi siç mund ta themi ndryshe është një nga masat më ekstreme dhe të miturit shumë rradhë mund të ndodhen në rrethana të tilla. Ndërsa për sa i përket strehimit në shumë vende evropiane përcaktimi se ku do të qëndrojë i mituri është i bazuar në veçanti në nevojat specifike të individit dhe jo në disponueshmërinë materiale të shtetit pritës (si për shëmbull kapacitetit të shtretërve).

Për sa i përket aksesit në përfitim të drejtës për përfaqësim ligjor me përjashtim të Britanisë së Madhe , të gjitha shtetet e tjera anëtare vendosin një kujdestar për të

miturin në qoftë se ai nuk ka asnjë person pritës në vendin europian. Në rastin e fëmijëve të cilët kanë bërë kërkesë për azil ky kujdestar do të përcaktohet prej një organizate jo qeveritare apo një agjensie qeveritare dhe ai do të shërbëje edhe si përfaqësues ligjor për të miturin.

Për sa i përket riatdhesimit pra kthimit në vendet e origjinës po të bëjmë një krahasim me Shtetet e Bashkuara, shumica e fëmijëve që kanë ardhur aty janë kthyer në vendet e tyre, ndërsa fëmijët emigrant të ardhur në shtetet anëtare të BE-së janë kthyer në vendin e tyre vetëm si një masë e fundit dhe vetëm nëse është në interesin e tyre më të mirë.¹⁴ Si rrjedhojë kjo do të thotë se numri i të miturve të pashoqëruar të cilët janë kthyer në vendet e tyre është mjaft i ulët. Dëbimet në përgjithësi në këto raste bëhen nëpërmjet zbatimit programeve që ofrojnë një kthim të veçantë për të miturin dhe përfshin po ashtu dhënien e ndihmës për riintegrim. Po ashtu shtetet anëtare tentojnë para së gjithash, pra para se ata të fillojnë procedurat për bashkim familjar apo për asistencë ndaj të miturit, të mirëpërcaktojnë moshën e të miturit duke përdorur teknika të caktuara si dhe verifikime shëndetsore si për të përcaktuar moshën ashtu edhe për të certifikuar statusin mental të të miturit duke tentuar në këtë mënyrë që të shuajnë cdo pikpyetje në lidhje me këto çështje.

6. Sfidat e këtyre politikave të ndjekura nga BE

Qasja që Bashkimi Europian ka mbajtur ndaj kësaj kategorie të miturish nuk ka kaluar pa u vënë në pikpyetje prej skeptikëve të rendit komunitar. Nga njëra anë, shumë kritikë mendojnë se politikat e BE-së janë shumë të butë dhe në këtë mënyrë ato bëhen shkak për të inkurajuar migrimin e paautorizuar të të miturve. Nga ana tjetër, mendohet sidomos prej përfaqësuesve ligjorë të imigrantëve se zbatimi i politikave favorizuese për disa në disa vende nuk janë të harmonizuara me një pjesë të politikave që zbatohen në disa vende të tjera anëtare gjë e cila mund edhe të dëmtojë edhe mirëqënien e fëmijës.¹⁵

Mungesa e koordinimit në teknikat e mbledhjes së të dhënave si dhe mbi procedurat e marrjes së azilit është i dukshëm në një masë të madhe si rezultat i përvojave të veçanta që kanë vendet në lidhje me çështjet që lidhen me të miturit që vijnë të pashoqëruar . Përveç kësaj, dallimet në aplikimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës janë të qarta në pothuajse çdo aspekt të politikës së ndjekur për sa i përket imigracionit, si për shëmbull rastet e mësipërme që përmëdëm në lidhje me akomodimin, me edukimin, me politikat e bazuara tek mosha e të miturit, me të drejtën për bashkim familjar, në kriteret për të përfituar azilin ku shumica e të miturve nuk i plotësojnë pasi kanë nevojë për një përfaqësues ligjor etj.

Është e qartë se fëmijët që mbërrijnë në BE shtyhen prej një sërë motivesh që miksohen me njëra tjetrën. Për këtë arsye gjëja që ka më shumë rëndësi dhe kemi tentuar të theksojmë është pikërisht matja e të gjithë rrethanave dhe marrja e tyre në konsideratë në mënyrë që kjo ti vijë në ndihmë interesit më të lartë të fëmijës. Për këtë arsye kërkesat e të miturve për tu ribashkuar me prindërit në shtetin anëtar priten duhet patjetër që të shqyrtohet me humanizëm dhe me përparësi.¹⁶ Kjo jo domosdoshmërisht do të thotë se fëmijët e pashoqëruar duhet të qëndrojnë më të drejtë si emigrant në shtetin ku kanë mbërritur. Ka disa rrethana të cilat e bëjnë thuajse të domosdoshme kthimin e të miturit në vendin e origjinës pasi kjo është në interesin e tij më të mirë dhe shihet si zgjidhja më e mirë për tu bërë. Pavarësisht vendimeve që mund të meren në emër të interesit më të lartë të fëmijës vlen të vihet në dukje se po ashtu duhet të respektohet e drejta e fëmijës për të ruajtur marrëdhëniet me prindërit dhe se asnjë veprim nuk mund të ndërmerret pa u marë paraprakisht mendimi i fëmijës si një nga parimet kryesore për të mbrojtur jetën familjare.

Të gjithë ata të mitur të cilët shprehin vullnetin për të përfituar azil janë të autorizuar të qëndrojnë në territorin e shtetit anëtar ku ata kanë mbërritur gjatë gjithë periudhës

që zgjat procedura e aplikimit dhe e marrjes së vendimit për dhënien e azilit. Por siç edhe e përmëndim nuk mungojnë rastet e kthimit edhe jashtë vullnetit të shprehur nga i mituri si në rastin e Greqisë e cila nuk e njeh statusin e të miturit pasi i trajton ata me statusin e të rriturit.¹⁷

Përfundime

Ruajtja e kohezionit të familjes dhe e parimit të bashkimit familjar në Bashkimin Europian në kontekstin legal, ekonomik apo social respektivisht në termat e trajtimit të njëllojtë bëhet për të rritur zhvillimin socio-ekonomik. Jo gjithmonë ligji europian është një reflektim i qartë i standarteve internacionale apo edhe e standarteve të përcaktuara të Këshillit të Europës për të drejtat e njeriut. Në fakt kjo vihet re në rastet kur parimi i bashkimit të familjeve si një e drejtë themelore bie ndesh me politikat shtrënguese të emigracionit që zbatohen nga vendet anëtare. Direktiva mbi bashkimin familjar për vëndet e treta jo anëtare shpesh është kritikuar si një formë indirekte e diskriminimit duke konsideruar se shtetasit jo europian gëzojnë shumë më pak të drejta për të hyrë në BE sesa qytetarët europian të cilët përfitojnë prej të drejtës për lëvizjen e lirë brenda unionit¹⁸. Përkufizimi i familjes në ligjin komunitar për bashkimin familjar është i lidhur ngushtë me atë që gjejmë në ligjin për të drejtat e njeriut. Është rekomanduar se koncepti për ato që do quajmë anëtar të familjes duhet të përfshijë brenda tij edhe partnerët e rregjistruar nëse legjislacioni i vëndit pritës i trajton marrëdhëniet e regjistruara si të barazvlefshme me martesat. Për sa i përket të miturve të pashoqëruar të cilët kërkojnë bashkim familjar statistikat dhe studimet kanë treguar se fëmijët që nuk aplikojnë për azil mund të bëhen objekt i riadhesimit në vendet e originës. Për më tepër është rekomanduar që ti jepet residencia në territorin e shtetit anëtar këtyre të miturve derisa ata të arrijnë moshën madhore,¹⁹ e po ashtu duhet të lejohet hyrja në territorin europian për pjesëtarët e familjes së të miturit nëse bashkimi në vëndin pritës është në interes të të miturit.

Bibliografia

Legjislacioni:

-Direktiva 2004/38 e Parlamentit Europian dhe Këshillit, 24 prill 2004 mbi të drejtën e qytetarëve europin për të lëvizur lirë në BE.

-Direktiva 2009/50 e KE e 25 majit 2009 mbi kushtet e hyrjes dhe të rezidencës për qytetarët e vendeve të treta me qëllim punësimin në punë të kualifikuara.

Çështje gjyqësore:

-GJED-C-1/05, Jia v Migrationsverket, 09 January 2009, e publikuar me 26 gusht 2011.

-GJED-C-127/08, Metock et al. v Minister for Justice, equality and laë reforme, 25 gusht 2008 e publikuar në 30 gusht 2011.

-GJED-C-109/01, Secretary of State for The Home Department v Hacene Akrich, 23 shtator, publikuar në 30 gusht 2011.

Burime online

-Haddleston T, "Migrant Integration policy index", 2011, fq.14-15

in www.eur-lex.eu, Hammarberg T, Human Right challenges of migration in Europe Council of Europe. Seminar i mbajtur gjatë Turkish chairmanship Istanbul, 17-18 Shkurt 2011, fq.4-5, www.coe.it, Labayle H., & Pascouau Y., "Family reunion, in study on the Conformity checking of the transportation by member states of 10 EC directives in the sector of asylum and immigration", 2007, fq. 180.

-www.politiqessociales.net/IMG/pdf/migrant_integration_policy_index_2011.pdf.

-www.infoportal.fra.europa.eu

-<http://www.migrationpolicy.org/article/unaçompanied-immigrant-children-growing-phenomenon-few-easy-solutions>.

Literaturë

-Tonolo S., "Le unioni civili nel diritto internazionale private", Giuffrè, Milano, 2007.

-Sesta M., "Le conveniezie tra persone dello steso sesso", Cedam, Padova, 2007.

-Raporti I Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit Europian mbi aplikimin e Direktivës për bashkimin familjar.

-European Migration Network, Raporti përmbledhës: Të miturit e pashoqëruar (Maj 2010)

-EMN Raporti përmbledhës: Të miturit e pashoqëruar (Maj 2010), EUROSTAT (për shifrat e 2009)

-Peers S., "Free movement emigration Control and Constutional Conflict in the European Constitutional law review", No.5, 2009.

-Haddal, Chad. "Unaçompanied Alien Children: Policies and Issues." CRS Report for Congress, January 15, 2009

-Peers S., "Eu Law and family reunion: a human rights critique, in ECLN – European Civil Liberties Network Essays no.16, 2005.

-COM(2000) 757 final, Communication from the Commission to the Council and the European Parliament, (Brussels, 22.11.2000), 20.

Referencat

¹ për një një studim më të thelluar mbi bashkimin familjar në BE, shih: Haddleston T, "Migrant Integration policy index", 2011, fq.14-15

² www.politiqessociales.net/IMG/pdf/migrant_integration_policy_index_2011.pdf.

³ Direktiva e aplikuar në të gjitha Shtetet Anëtare, përveç Danimarkës, Irlandës dhe BM

⁴ Direktiva 2004/38 e Parlamentit Europian dhe Këshillit, 24 prill 2004 mbi të drejtën e qytetarëve europian për të lëvizur lirë në BE, Peers S., "EU Justice and home affairs laë", botimi III, Oxford EU Law Library, 2011, fq. 398-404.

⁵ Direktiva 2009/50 e KE e 25 majit 2009 mbi kushtet e hyrjes dhe të rezidencës për qytetarët e vendeve të treta me qëllim punësimin në punë të kualifikuara.

⁶ Komunikimi midis Komisionit, parlamentit dhe Këshillit Europian për zbatimin sa më të efektiv të Direktivës 2004/38/KE për lirinë e lëvizjes së qytetarëve europian dhe familjeve të tyre brënda unionit, in www.eur-lex.eu, Hammarberg T., Human Right challenges of migration in Europe Council of Europe. Seminar i mbajtur gjatw Turkish chairmanship Instanbul, 17-18 Shkurt 2011, fq.4-5, www.coe.it, Labayle H., & Pascouau Y., "Family reunion, in study on the Conformity checking of the transportation by member states of 10 EC directives in the sector of asylum and immigration", 2007, fq. 180.

⁷ Pje. 7 e Këshillit Europian Direktiva 2009/50/ KE e Majit 2009 mbi kriteret e e hyrjes dhe residencës se qytetarëve të shteteve të treta me qëllim punësimin në BE.

⁸ Tonolo S., "Le unioni civili nel diritto internazionale private", Giuffre, Milano, 2007, 66-71.

⁹ Sesta M., "Le convenienze tra persone dello stesso sesso", Cedam, Padova, 2007, fq. 191

¹⁰ www.infoportal.fra.europa.eu

¹¹ Raporti I Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit Europian mbi aplikimin e Direktivës për bashkimin familjar.

Marrëveshjet e Stabilizim dhe të Asocimit³ synonin të sillnin një dimension të ri në marrëdhëniet e BE me rajonin, duke kapërcyer marrëdhëniet e bashkëpunimit me ato vende që nuk e kishin arritur këtë nivel dhe duke zhvilluar marrëdhënie më të avancuara me të tjerat që kishin tashmë këto marrëveshje bashkëpunimi. Në të njëjtën kohe, kur përpunohej ky koncept, kishin lindur ide dhe po trajtoheshin projekte për hartimin e një plani strategjik për rindërtimin e Ballkanit. Madje mjaft e përhapur ideja e një plani të dytë “Marshall” e kësaj here për Ballkanin.⁴ Ne qendër të kësaj nisme u vendos Gjermania e cila propozoi një Pakt Stabiliteti për Evropën Juglindore. E mbështetur që në fillim edhe nga Franca, Gjermania, që kishte dhe presidencën e radhës, e nxiti procesin dhe siguroi një miratim të shpejtë nga partenerët evropianë. Ky pakt stabiliteti përfshiu një numër të madh vendesh dhe organizatash ndërkombëtare dhe katër nisma rajonale. Ish Jugosllavia nuk u pranua në konferencën e Këlnit në të cilën u miratua pakti i stabilitetit. Pjesëmarrja e saj u kushtëzua me zgjidhjen e krizës së Kosovës dhe me demokratizimi e saj. Ndërsa Mali i Zi u pranua për shkak të zhvillimeve demokratike dhe si një nxitje për ndryshimet në Beograd. Objektivi i Paktit të Stabilitetit⁵ ishte të mbështeste vendet e Evropës Juglindore në përpjekjet e tyre për të nxitur paqen, demokracinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe prosperitetin ekonomik. Për këtë qëllim vendet e paktit do të bashkëpunonin për parandalimin e tensioneve dhe krizave si një parakusht për një proces afat gjatë. Gjithashtu këto vende do të mbështetnin proceset politike demokratike, do të zhvillonin marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në rajon, do të ruanin diversitetin multietnik të vendeve të rajonit dhe do të mbronin minoritetet. ⁶ Pakti i stabilitetit ishte me të vërtetë një nisëm Evropiane dhe për

një rajon Evropian. BE nëpërmjet këtij pakti stabiliteti synonte të afronte më tej vendet e Ballkanit në perspektivën e integritit të plotë në strukturat e saj. Në tekstin e paktit theksohej se për ato vende që nuk kishin nënshkruar ende marrëveshjet e Asocimit, integrimi do të bëhej përmes një tipi të ri marrëdhëniesh kontraktuale. Bashkimi Evropian merrte përsipër, gjithashtu, që të përgatiste një strategji të përbashkët për Ballkanin Perëndimor.

1. Zgjerimi i Bashkimit Evropian drejt Ballkanit Perëndimor

Motivet për zgjerim kanë patur karakter politik, ekonomik, social e kulturor. Edhe Evropa e Bashkuar edhe aspirantët e rinj bashkohen në këtë pikë, sepse në këtë mënyrë ata mund të realizojnë synime të caktuara politike dhe të sigurisë, synime ekonomike e prosperiteti, synime sociale e afrim kulturor.

Kriteret e Kopenhagenit vijnë njëherazi në mëndje nëse flasim për zgjerimin e Bashkimit Evropian. Ato kanë të bëjnë me disa kushte politike, ekonomike si dhe juridike/administrative të cilat duhen përmbushur para se vendi kandidat të marrë dritën jeshile për t'u integruar në BE.⁷

Kriteret e Kopenhagenit janë:

1-Kriteret **politike** kanë të bëjnë me stabilitetin e institucioneve. Ato lidhen me demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut si dhe respektin për minoritetet;

2-Kriteret **ekonomike**: ato lidhen me aftësinë për të ndërtuar një ekonomi tregu funksionuese si dhe aftësinë për të absorbuar presionin kompetitiv si dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian;

3-Kriteri i **“acquis”**: adoptimi i *“acquis communautaire”*, aftësia për të marrë përsipër detyrimet që burojnë nga qenia anëtar në BE, përfshirë adezionin në qëllimet e bashkimit politik, ekonomik si dhe monetar.

Pakti i stabilitetit për Evropën Juglindore ishte një deklaratë politike dhe një marrëveshje e miratuar në

qershor të 1999, për të inkurajuar dhe për të përfocuar bashkëpunimin ndërmjet shteteve nga Evropa Juglindore dhe për të kordinuar dhe përqëndruar stabilitetin dhe rritjen ekonomike në rajon. Ideja e paktit të stabilitetit u propozua nga Gjermania në vitin 1998. ⁸Parandalimi i konfliktit dhe vendosja e paqes mund të jenë të suksesshëm vetëm nëse ata fillojnë paralelisht në tre sektore: paqja, promovimin e sistemeve demokratike dhe promovimin ekonomik dhe të mirëqenies sociale.

Ndër instrumentet më të rëndësishëm të përdorur për zgjerimin e BE-së kanë qenë Marrëveshjet e Asociimit. Marrëveshjet e asociimit nënshkruhen nga tre palë të cilat janë: Komuniteti, shtetet anëtare të BE-së dhe shteti që do të asociohet.

Procesi i Stabilizim Asociimit është kuadri politik i integritimit në BE me tre objektiva kryesorë:

- 1) *Stabilizimin dhe tranzicionin e shpejtë drejt një ekonomie të tregut;*
- 2) *Promovimin e një bashkëpunimi rajonal;*
- 3) *Orientimin drejt integritit në BE;*

Ky proces i ndihmon shtetet e Ballkanit që të zhvillojnë kapacitete dhe ju mundëson këtyre shteteve të adoptojnë, të aplikojnë norma dhe kritere të cilat egzistojnë në BE-se. Ky proces ofron partenariat progresiv brenda të cilit BE-ja ofron, një asistencë financiare IPA (Instrumenti i Para Aderimit) dhe marrëdhënie kontraktuese ku cdo shtet angazhohet se do të realizojë kriteret.

Zgjerimi është një forcë e madhe dhe stimulon shtetet për aderim me ndryshime demokratike dhe liberalizimin ekonomik. Një përfitim për të gjithë evropianët është stabiliteti dhe paqja. Zgjerimi sjell përfitime si për anëtarët e rinj por edhe për të gjithë vendet e Bashkimit Evropian. Traktati Shengen ka sjellë një facilitet në qarkullimin e qytetarëve. Tregtia me Ballkanin Përendimor dhe shteteve të vjetra anëtare do të çojë në hapjen e vendeve të reja të

punës ndërsa zgjerimi do të stimulojë, do të zhvillojë, do të modernizojë ekonominë e vendeve të reja anëtare dhe do të zhduket emigrimi i paligjshëm.⁹

Zgjerimi mund të jetë një proces shumë pozitiv në sigurinë e brendshme, sepse do të rrisë bashkëpunimi ndërmjet forcave të rendit dhe të drejtësisë në të gjithë kontinentin evropian. BE inkurajon lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe personave, për të mirën e të gjithë qytetarëve të saj.

2. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë

Një moment kyç është pozicioni i Shqipërisë në rrugën e gjatë drejt Bashkimit Evropian, pra sa larg apo sa afër është me fillimin apo me fundin e këtij “udhëtimi”. Shqipëria me Bashkimin Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Tregtisë dhe Bashkëpunimit, e cila ka hyrë në fuqi, më 1 dhjetor 1992. Në vitin 1996, Shqipëria ishte pranë nënshkrimit të një marrëveshjeje të re kontraktuale me BE-në por ngjarjet e vitit 1997 e penguan këtë proces¹⁰.

Fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit e bëri Presidenti i Komisionit Evropian, z. Prodi, i cili përmes vizites në datën 31 janar 2003 në Tiranë synoi dhënien e sinjalit të ruajtjes së vëmendjes së BE-së ndaj vendit tonë dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor.¹¹

Nënshkrimin e MSA-së në 2006 shënoi hapin më vital të marrëdhënieve BE- Shqipëri.

U deshën rreth gjashtë vite që këto kërkesa të përmbusheshin, dhe mbi të gjitha të arriheshin këto standarte. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit hyri në fuqi në 1 Prill 2009, ndërsa më 28 prill 2009, Shqipëria dorëzoi aplikimin për anëtarësim në BE.¹²

Shqipëria i ka zbatuar mirë detyrimet e saj në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA). Është rënë dakord ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë për një Protokoll të MSA-së për të marrë parasysh pranimin e Kroacisë në

BE. Protokollin është aktualisht nën ratifikim dhe janë marrë masat për zbatimin e tij të përkohshëm derisa procesi i ratifikimit të përfundojë në të dyja anët. Shqipëria ka marrë pjesë në dialogun periodik politik dhe ekonomik me BE-në përmes strukturave të MSA-së. Liberalizimi i vizave për qytetarët e Shqipërisë që udhëtojnë në zonën Shengen ka qenë në fuqi që nga dhjetori 2010. Në kuadrin e krijimit të mekanizmit të monitorimit pas liberalizimit të vizave, Komisioni rregullisht vlerëson progresin e bërë nga vendi në zbatimin e reformave të ndërmarra sipas udhërrëfyesit të vizave. Në këtë kuadër, Komisioni Evropian ka dorëzuar rregullisht raportet e tij të monitorimit tek Parlamenti dhe Këshilli Evropian. Komisioni rekomandoi që Shqipërisë t'i jepej statusi i vendit kandidat në BE në tetor 2013. Komisioni e rikonfirmoi rekomandimin e tij në raportin e tij të qershorit 2014 për Këshillin. Njohja si vend kandidat në BE ka një numër implikimesh për Shqipërinë. Është një sinjal i rëndësishëm politik për Shqipërinë dhe qytetarët e saj, që tregon se vendi po ecën drejt fazës tjetër të procesit të integrimit evropian. Nga perspektiva ekonomike, statusi i vendit kandidat do të nxisë investimet e huaja dhe rrjedhimisht, do të çojë në krijimin e vendeve të punës. Statusi i vendit kandidat e ngre marrëdhënien mes Shqipërisë dhe BE-së në një nivel më të lartë: tashmë Shqipëria do të marrë ftesa në takimet e Këshillit të hapura për vendet candidate. Si vend kandidat Shqipëria do të vazhdojë të përfitojë nga fondet e BE-së në kuadrin e Instrumentit për Asistencë para Anëtarësimit (IPA) me qëllim që të kryejë reforma gjithëpërfshirëse dhe investime strategjike, si dhe do të përfitojë nga pjesëmarrja në programet e BE-së.¹³

Pozita Gjeografike është një tjetër faktor shumë i rëndësishëm në pozicionin dhe influencën që duhet të ketë ç'do shtet në raport me rajonin ku gjendet dhe më gjërë. Në rastin e Shqipërisë, kjo pozitë apo kjo shtrirje hapsinore gjeografike, ka një rëndësi mjaft të madhe strategjike.

Bashkimi Evropian, ndoshta që në hapat e para të themelimit, kishte për synim krijimin e një hapësire harmonike me një zgjerim të vazhdueshëm. Kjo hapësire e përbashkët, do të ishte e bazuar mbi një sistem të tërë vlerash që kalonin përtej qëllimeve ekonomike që në fakt ishte parësoret në krijimin e këtij unioni. Por shumë shpejt filloj të kuptohej se ky union, do të merrte kuptimin e tij më të plotë dhe do të ishte më i qëndrueshëm vetëm si një organizëm i madh politik-ekonomik, i ndërtuar nga sisteme të unifikuara vlerash dhe standarteve të demokracisë.

Zgjerimet e BE-së përbëjnë një proces të natyrshëm të përputhur me filozofinë fillestare të bashkimit të më se gjysmë shekulli më parë. Njëherësh ato kanë qenë një proces jodrejtëvizor dhe si të tilla ato janë shoqëruar me problematika që kanë kërkuar gjithmonë reflektim e instrumente përkatëse.

Zgjerimi i vitit 2004 është zgjerimi më i madh i BE-së në territore, popullsi, shtete, kultura. Ky zgjerim e kapërceu kufirin e ndarjes së blloqeve dhe mundësoi aspiratën për demokraci të vendeve të dala nga komunizmi. Ai u frymëzua nga nevoja reciproke e shteteve anëtare të BE-së dhe e atyre kandidatë për prosperitet ekonomik, për më shumë siguri dhe për një mjedis më të favorshëm. Ai kërkoi përpunimin e instrumenteve përkatëse të përgatitjes së anëtarëve të rinj për të përmbushur detyrimet e tij, ashtu siç kërkoi edhe përgatitjen e shteteve anëtare për të pritur të porsaardhurit. Frikërat që shoqëruan fillimin e procesit të asocimit për një përmbytje migratore, për rritjen e kriminalitetit, etj, duket se mundësuan adoptimin e disa mekanizmave shumë efikase.¹⁴ Treguesit e sotëm të këtij zgjerimi duket se janë pozitive: përfitimet nga zgjerimi duket se janë të mëdha si për vendet anëtarësuese ashtu edhe për ato që anëtarësohen.

Me zgjerimin e saj te vitit 2004 BE krijoi një treg të madh, një zonë të gjerë sigurie dhe mundësoi kthimin e saj në një faktor më shumë potencial në arenën

ndërkombëtare. Mbi themelet e Evropës së përçarë dhe të lodhur prej dy luftërash botërore, të armiqësive dhe të vigjilencës po ngrihet ngadalë, por me siguri një bashkim i madh kulturash të paqes e të afrimit.

BE ka planifikuar dhe është në proces të kryerjes së zgjerimeve pasuese. Ky është tregues i asaj se BE e sheh me guxim projektin që vetë ajo ka ndërmarrë për zgjerim/integrimin e vet.

Një ndër synimet dhe njëkohësisht edhe sfidat kryesore të këtij unioni është gjithashtu, zgjerimi drejt vendeve të Evropës Lindore apo ndryshe vendeve ish-komuniste. Sigurisht ky angazhim nuk ka qenë i lehtë sepse, përveç ristrukturimit në ekonomitë dhe tregjet e këtyre vendeve, një sfidë të veçantë paraqet implementimi i këtyre vlerave në sistemet politike të sapo transformuara apo në transformim. E njëjta sfidë për mos më tepër, është për vendet që ishin dhe janë në prespektivë të këtij zgjerimi.

Për Shqipërinë, kjo ndoshta ka qenë edhe më e vështirë pasi ajo doli jo vetëm nga një sistem totalitar por edhe nga një vetëizolim total i cili e kishte çuar vendin në prag kolapsi ekonomik e social. Këtë e vërteton edhe vetë tranzicioni i gjatë që duket se akoma nuk ka përfunduar me gjithë angazhimin dhe vullnetin politik i cili ka qenë konsistent prej fillimit të viteve '90-të.¹⁵Nga ana tjetër Shqipëria, duket se i ka mbërritur ato standarte në demokratizimin e vendit si në aspektin ekonomik e politik të parashtruara nga vetë BE-ja, e këtë e tregon edhe antarësimi në strukturën ushtarake më të madhe në botë, NATO, e cila në vetvete mbart të njëjtin sistem vlerash demokratike që ka edhe BE-ja.

3. Kriza ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi, që nga fillimi i periudhës së tranzicionit dhe më pas, treguan

interesin e tyre për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian. Procesi i anëtarësimit sot është një prioritet i lartë i qeverive të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ekonomitë e Ballkanit janë kryesisht të vogla dhe të hapura për ekonominë globale. Aktivitetet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të ndryshme duke filluar nga shkëmbimi i mallrave, i shërbimeve dhe i luhatjes së investimeve të huaja direkte dhe tregjeve financiare.¹⁶ Bashkëpunimi Ekonomik midis vendeve anëtare të BE dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor ishin intensive dhe eshte normale që nga kriza evropiane mund të kenë një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve. Kjo u reflektua kryesisht në aktivitete si : ngadalësimi i tregut të kreditit, çmimet e produkteve dhe shërbimeve, falimentimin e biznesit në rritje, rritja e papunësisë, ulja e vlerës së aseteve, kreditë e këqija. Disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova dhe Shqipëria ishin më pak të prekura fillimisht, ata ishin më pak të integruara në ekonominë globale.¹⁷

Kriza financiare globale që filloi në gjysmën e dytë të vitit 2007, fillimisht si një krizë e tregut të banesave në SHBA, u përhap përtej sektorit financiar dhe preku rëndë ekonominë globale. Deri në shtator të vitit 2008, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk e ndjenë ndikimin e krizës financiare pasi kishin një përqindje të ulët kredish të këqija. Megjithatë, tregjet e kapitalit të vendeve të Ballkanit Perëndimor u tronditën kur në vjeshtë të vitit 2008 institucionet investitore të huaja filluan tërheqjen e fondeve si dhe në fund të po atij viti pati tërheqje të kursimeve në valutë të huaj.

Fundi i vitit 2008 dhe fillimi i 2009 bëri të qartë se kriza nuk do ta kursente Ballkanin Perëndimor. Vendet e rajonit u prekën nga kriza në tremujorin e fundit të vitit 2008 (Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia) dhe në tremujorin e parë të vitit 2009 (Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria

dhe Kosova). Megjithatë, duhet thënë se edhe pse Shqipëria dhe Kosova regjistruan ngadalësim të rritjes në vitin 2009, rritja e tyre e PBB-së mbeti pozitive për vitin 2009. Maqedonia pati rënie të moderuar të PBB-së në vitin 2009 (1%), e ndjekur nga Bosnje Hercegovina (2,8%) dhe Serbia (3,5%), ndërsa Mali i Zi regjistroi rënien më të mprehtë të rajonit (5,7%). Konsolidimi i rimëkëmbjes ekonomike që filloi në vitin 2010 dhe rezultoi në rritje të moderuar pozitive të PBB-së në të gjitha vendet e rajonit. Norma më e lartë e rritjes u regjistrua në Kosovë (3,9%) dhe në Shqipëri (3,3%), e ndjekur nga Mali i Zi (2,5%) dhe Maqedonia (1,9%), ndërsa Serbia dhe Bosnje Hercegovina regjistruan norma minimale të rritjes. Ndërkohë që pati njëfarë rimëkëmbje të dukshme në gjysmën e parë të vitit 2011, aktiviteti ekonomik u dobësua në gjysmën e dytë të vitit dhe në gjysmën e parë të vitit 2012. Pavarësisht rënies së shënuar në aktivitetin ekonomik në pjesën e dytë të vitit 2011, të gjitha vendet e rajonit regjistruan rritje ekonomike pozitive në vitin 2011, që varioi nga 1,6% në Serbi në 5,0% në Kosovë. Parashikimet ekonomike afatshkurtra për rajonin e Ballkanit Perëndimor mbeten të dobëta si rezultat i krizës së eurozonës. Dobësitë në sektorin financiar përbënin një shqetësim të veçantë, duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e sistemit bankar është në pronësi të huaj dhe se shumica e vendeve mbështeten të financimi nga jashtë.¹⁸

Në vitin 2013 kriza financiare dhe ekonomike në Bashkimin Evropian dëmtoi edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Ballkani perëndimor ndjeu të gjithë peshën e krizës ekonomike dhe financiare të BE. Shkak për këtë është gërshetimi i ngushtë ekonomik me BE. Dy të tretat e tregtisë së vendeve të Ballkanit perëndimor kryhet me shtetet e BE. Rënia e eksporteve, e investimeve të huaja dhe remitancave të emigrantëve, aq të rëndësishme, cuan në një zhvillim negativ.

Ballkani Perëndimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me

rritje më të dobët ekonomike duke u krahasuar me vitin 2013. Performanca e dobët e aktivitetit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 ka ndikuar që vlerësimi për rritjen ekonomike të jetë vetëm 1.8 përqind (2.5 përqind në vitin 2013). Shkalla e ulët e inflacionit në nivel global si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe kërkesa përgjithësisht më e ulët në rajon ka rezultuar në norma më të ulëta të inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Karakteristikë e përbashkët e vendeve të Ballkanit Perëndimor mbetet deficit i llogarisë rrjedhëse, që gjatë vitit 2014 shënoi rritje të mëtejme. Sektori fiskal në vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar me përmirësim të bilancit buxhetor, ndërkohë që borxhi publik ka vazhduar të mbetet i lartë. Sektori bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me zhvillime të ndryshme, ku kreditimi në disa prej vendeve shënoi rritje e në disa të tjera u zvogëlua. Sa i përket depozitave, trendi i rritjes së tyre është përshpejtuar në shumicën e vendeve të rajonit.¹⁹

Konkluzione

Njohja e ecurisë së procesit të zgjerim të BE-së përbën një domosdoshmëri për ato vende që aspirojnë bashkimin me kontinentin e vjetër. I tillë është edhe rasti i Shqipërisë. Aspirata shqiptare për t'u bashkuar me BE do të kërkojë njohjen e rrugës që kanë ndjekur shtetet tashmë anëtarë të këtij bashkimi.

Aurtorët mendojnë se BE duhet ta vazhdojë më tej procesin e zgjerimit, sepse ky fakt do të jetë shumë i dobishëm për vendet candidate dhe ky proces do të çojë në zhvillimin e këtyre vendeve. Edhe se përfitimet e aderimit në BE nuk do të jenë të dukshme në fillim ato do të vërehen në të ardhmen kur do të përmbushen të gjitha reformat ekonomike, politike, kulturore dhe sociale.

BE edhe Ballkani Perëndimor duhet të jenë më

ambicioze rreth procesit të transformimit dhe afateve kohore për anëtarësim, të cilat do të mund të ishin stimulues të mirë për qeveritë e rajonit që të arrijnë rezultate në reformat e tyre.

BIBLIOGRAFIA

1. Ailish M. Johnson, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, Volume 3, Issue 2 November 2001
2. Edvana Tiri, *Integrarea Economica. Efectele economice ale extinderii UE spre tarile Vest Balcanice. Cazul Albanie*, Teza de doctorat, Universitatea de Vest din Timisoara, 2010
3. Mocanu Oana, Voicu Alina, "Analiză comparativă a stadiului negocierilor în vederea aderării la Uniunea Europeană a statelor candidate din Europa Centrală și de Est", București, 2001
4. Silasi, Grigore *Uniunea Europeană sau noua comedie divină* Editura Orizonturi. Universitatea Timisoara 2005
5. Silasi, G, Rollet, P. Trandafir, N. Vadasan , *Economia Uniunii Europene. O poveste te success?* Editura Universitatii de Vest p.38
6. Yannis A., "The Creation and Politics of International Protectorates in the Balkans: Bridges over Troubled Waters," *Journal of International Relations and Development* 2002

Referenca

¹ H. Kramer, The European Union in the Balkans: Another Step Towards European Integration, *Journal of International Affairs*, Volume 5, No 3, November 2000

² Regional cooperation in the western Balkans - A policy priority for the European Union', <http://ec.europa.eu/enlargement> klikuar në datën 15.02.2016

³ Commission's Communication to the Council and European Parliament of 26 May 1999

⁴ Yannis A., "The Creation and Politics of International Protectorates in the Balkans: Bridges over Troubled Waters," *Journal of International Relations and Development* (2002) fq.264.

⁵ <http://www.stabilitypact.org/trade/CEFTAMAINTEXT2006.pdf> klikuar në datën 15.02.2016

⁶ Silasi, G, Rollet, P. Trandafir, N. Vadasan , I.Economia Uniunii Europene.O poveste te success? Editura Universitatii de Vest fq.38

⁷ Mocanu Oana, Voicu Alina, "Analiză comparativă a stadiului negocierilor în vederea aderării la Uniunea Europeană a statelor candidate din Europa Centrală și de Est", București, 2001, fq. 11.

⁸ Në një samit në korrik të vitit 1999 në Sarajevë, Pakti i Stabilitetit u zyrtarizua nën kujdesin e OSBE-së dhe në praninë e përfaqësuesve të komunitetit rajonal dhe ndërkombëtar. Pakti i Stabilitetit u bazua në përvojat dhe mësimet e nxjerra në menaxhimin e krizave ndërkombëtare në mbarë botën.

⁹ Enlargement of Western Balkans ,[www. ec.europa.eu/enlargement](http://www.ec.europa.eu/enlargement), klikuar në datën 16.02.2016

¹⁰ Edvana Tiri, Integrarea Economica. Efectele economice ale extinderii UE spre tarile Vest Balcanice. Cazul Albanie, Teza de doctorat, Universitatea de Vest din Timisoara, 2010, fq.154

¹¹ European Commission Annual Report, 2005.

¹² Idem, fq.156

¹³ http://eeas.europa.eu/delegations/albania/press_corner/all_news/news/2014/20140624_01_sq.htm klikuar në datën 18.02.2016

¹⁴ Ailish M. Johnson, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, Volume 3, Issue 2 November 2001 fq.71

¹⁵ European Commission, C(2007)2245 of 31/05/2007 on a Multi-annual Indicative Planning Document (MIPD) 2007-2009 for Albania.

¹⁶ Western Balkans in Transition, European Commission 2005

¹⁷ Erjola Xhuvani, The enlargemet of the European Union and the impact of its crises on the Western Balkan countries. fq.134, <http://www.revueeuropenne-droitsocial.ro/reviste/nr22/nr22.pdf> klikuar në datën 18.02.2016

¹⁸ <http://www.npcbalkan.net/admin/doc/3901>

Perspektivat ekonomike dhe Evropiane per vendet e Ballkanit_Perendimor.pdf klikuar në datën 20.02.2016

¹⁹ <http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK-Makro%202.pdf>, klikuar në datën 20.02.2016

Different Perspectives of Western Balkans

Dr. Edvana TIRI
ShLUJ “Wisdom University”

Msc. Dorjana XHAFERAJ
ShLUJ “Wisdom University”

Abstract

In this paper the authors present the process of EU enlargement , the Copenhagen criteria , Albania’s relations with the EU and economic situation of the countries of the Western Balkans .

EU enlargement in the Western Balkans is a complex process by which these countries will achieve peace, stability applying EU rules . EU accession prospects and the advantages present a guarantee for stability and reforms in the Western Balkans .

The process of accession of these countries must be based on the correct application of the principle of conditionality on the basis of which each country is assessed in view of capacity and fulfillment of the Copenhagen criteria .

The promise given by the EU accession of Western Balkan states , has acted at all times as a catalyst for reforms in these countries that want to join this group .

Keywords:

extension , criteria , crisis , deal , process



Dr. Lediana BESHAI
ShLUIJ "Wisdom University"

Gjuha angleze në universitetet private, një ndihmesë në integrimin evropian dhe jo vetëm

12



Abstrakt

Tashmë jemi të gjithë të ndërgjegjshëm për rolin kyç që gjuha angleze ka në shoqërinë shqiptare, sidomos këto dy dhjetëvjeçarët e fundit. Gjuha angleze shihet si 'lingua franca' dhe si e tillë na bën të mundur një komunikim efektiv dhe të frytshëm në marrëdhëniet me vendet e tjera të botës dhe për më tepër njohja e mirë e kësaj gjuhe nuk le vënd për keqkuptime dhe interpretime të gabuara. Duke marrë parasysh që një nga temat më të debatuar në ditët e sotme është: 'Shqipëria drejt integritit evropian dhe të hyrjes së saj në familjen e madhe evropiane', mund të themi se bashkëpunimi me të huajt është një mënyrë për ta arritur këto nisme, duke synuar arritjen e standardeve, të cilat nuk janë aq të lehta, por jo të përealizueshme.

Për të pasur një bashkëpunim, shkëmbim idesh, eksperiencash etj., gjuha është ura lidhëse. Kjo gjuhë është gjuha angleze, sepse edhe pse 24 gjuhët janë gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian dhe pranohen si të tilla, në praktikë vetëm dy gjejnë një përdorim të gjërë, ajo frënge dhe gjuha angleze, ku e dyta përdoret gjerësisht dhe ka më shumë përparësi ndaj gjuhës frënge.

Si rrjedhojë lind nevoja e njohjes së gjuhës angleze. Pikërisht për këtë arsye qeveria shqiptare e ka bërë atë pjesë të kurrikulës që në klasën e tretë të shkollës fillore. Mësimi i kësaj gjuhe vijon edhe në shkollën e mesme e përfundon në studimet universitare. Pra, përparësia që i është dhënë gjuhës angleze është e dukshme.

Qëllimi i këtij punimi është të shihet se si gjuha angleze është domosdoshmëri dhe pjesë e kurrikulës në universitetet private që studentët e këtyre universiteteve të jenë të përditësuar dhe në koherencë me kërkimet e fundit shkencore në degën që ato studiojnë, sepse çdo informacion është në gjuhën angleze. Duke njohur gjuhën angleze njohuritë dhe zgjerimi i dijeve mbi fusha të ndryshme studimi dhe të standardeve evropiane, çon në një integrim më të shpejtë të shqipërisë në BE.

Fjalët kyçe:

universitet, gjuhë e huaj, kurrikula, mësim



Gjuha si mjet komunikimi, anglishtja si mjet komunikimi me nderkombëtarët

Benjamin Worf thotë se “Gjuha përcakton të gjithë mënyrën e jetesës së një personi, duke përfshirë edhe mendimet dhe të gjitha format e tjera të aktivitetit mendor.”¹

Mësimi i gjuhëve të huaja duhet të përmirësojë njohuritë kulturore të nxënësve, të realizojë objektiva që nxënësit të jenë në gjendje të komunikojnë në atë gjuhë dhe të jenë sa më afër gjuhës së synuar dhe kulturës së tyre. Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencës për Gjuhët² nga Këshilli i Evropës, me nivelet përkatëse të saj, merret gjithashtu si bazë në kurrikulën e shkollave shqiptare. Ideja që bota perceptohet nëpërmjet mjedisit të një gjuhe, që përcakton pikëpamjen e folësit mbi botën (propozuar nga Humboldt e më vonë riformluar nga Sapir dhe Whorf si teori e relativitetit gjuhësor³) mund të gjendet në shumë kërkime gjuhësore. Ky koncept zakonisht shoqërohet nga postulate, që analiza e lingistikës, lejon dhe na mundëson që të kemi një këndvështrim në gjuhë, në mentalitet, në kulturën e komunitetit, madje edhe në karakterin kombëtar të saj.

Mësimi i një gjuhe të huaj në përgjithësi transmeton tradita, besime, elementë specifik të një gjuhe, qëndrimet sociale dhe normat. Mësimi i një gjuhe të huaj duke filluar që në nivelet fillestare e duke vijuar me pas deri tek ato të avancuarat e aftësojnë nxënësin që të hyjë në mënyrën që një folës i gjuhës

së synuar përdor për të shprehur mendime të brendëshme, pikëpamje, ide dhe emocione. Prandaj, mësimi i një gjuhe të huaj i siguron nxënësit një mundësi të mirë për të përvetësuar informacion rreth kulturës së një gjuhe (Agar, 1991; Glucksberg, 2001)⁴. Shumë gjuhëtar, besojnë se leksiku nuk është një repertor me fjalë të vetme, por është një sistem dinamik, i cili përfshin gjithashtu njësi leksikore më të mëdha.

Siç edhe e përmendëm më lart, në Shqipëri i është dhënë një përparësi e veçantë mësimi të gjuhës angleze dhe mund të themi se kudo njohja e saj është një avantazh për këdo. Kohët e fundit, termi “lingua franca”, i referohet gjuhës angleze si e tillë, është shfaqur si një term për t’iu referuar komunikimit në gjuhën angleze ndërmjet folësve që flasin gjuhë të ndryshme. Meqënëse, vetëm njëri nga katër përorues të anglishtes në botë është folës vendas (Crystal 2003)⁵, shumica e ndërveprimeve në gjuhën angleze ndodh ndërmjet folësve jo vendas të gjuhës angleze. Gjithësesi, kjo nuk përjashton faktin që në bashkëveprim të kemi folës vendas të gjuhës angleze. Ajo që e bën të veçantë anglishten si lingua franca “gjuhë lidhëse” është fakti që në shumicën e rasteve është ‘gjuhë kontakti midis personave që nuk ndajnë një gjuhë të përbashkët, por as kulturë të përbashkët dhe anglishtja për to është gjuha e huaj e zgjedhur për komunikim’. (Firth 1996: 240)⁶.

Sigurisht, anglishtja po merr një zgjerim global dhe kjo është e pranishme dhe më se e qartë në çdo cep të botës ku përdoret interneti, por mund të themi që anglishtja është gjithashtu gjuha e përdorur nga ndërkombëtarët që shkojnë dhe janë me mision të ndryshme në vende ku nuk flitet anglisht dhe në shqipëri kemi ‘Peace Corps, Crown Agents, USAID, UNICEF’ etj. Dhe lista do të ishte e gjatë po të listonim të gjitha organizatat e huaja në shqipëri.

Anglishtja është bërë gjuha më e përdorur në konferenca dhe seminare ndërkombëtare, që organizon çdo vend i botës,

samiteve politike, shkëmbime dhe aktivitetet ekonomike, kulturore etj.

David Crystal thekson se anglishtja është zgjeruar e përhapur aq shumë, sa që është bërë e pavarur nga kontrolli shoqëror. Ky përkufizim ka pasur shumë debat, por të paktën në shqipëri ndikimi i gjuhës angleze shihet në të gjitha fushat e jetës.

Qeveria shqiptare, ministria e arsimit e ka parë si përparësi futjen e gjuhës angleze. Në sistemin arsimor shqiptar gjuha angleze është e detyruar duke filluar që nga klasa e 3 e shkollës fillore.

“Ne si shtet kemi detyrimin që të bëjmë më mirë detyrën tonë. Duke vendosur qartazi anglishten si prioritet besoj që i bëjmë shërbimin më të mirë të sotmes dhe të nesërmes së shoqërisë shqiptare” - thotë Genc Pollo, ministër i arsimit në qeverinë shqiptare e asaj kohe.⁷

Gjuha angleze në universitetet publike dhe private shqiptare

Mësimi i gjuhës angleze ka një shtrirje kohore të gjatë në sistemin arsimor. Kjo gjuhë mësohet në shkollë të mesme dhe në universitetet publike e private.

Shteti dhe politika shqiptare me kohë e kanë vlerësuar këtë gjë, me synimin se, *vlerësimi i anglishtes si një lëndë e preferuar për të gjitha fakultetet publike e private të vendit është një mekanizëm i mrekullueshëm që efektet e veta i jep medoemos.*

Nga kontaktet e vazhdueshme që kam me nxënës e studentë që mësojnë e përvetësojnë anglishten mund të pohoj se këto efekte janë ndier, duke patur parasysh se pjesa dërrmuese, sidomos e qytetarëve të Tiranës, por edhe të rretheve të tjera, nga mosha 35 e poshtë zotërojnë një anglishte të mirë, fale edhe presionit që ushtrohet dita-ditës për mësimin e kësaj gjuhe.

Deri para disa viteve, metoda për të mësuar gjuhën angleze në Shqipëri ishte një metodë e zakonshme. Sot disa

universitete po i japin një rëndësi metodave “English for Specific Reasons” (gjuha angleze për nevoja specifike), që njihen me akronimin ESP. Këtu përmendim Universitetin Politeknik, ku metoda që përdoret është “Engineering” si dhe Universitetin e Shkencave Sociale, të cilët përdorin metodën “Legal English”, ndërkohë ka edhe disa universitete dhe fakultete që përdorin akoma metoda ku mësohet gjuha e përgjithshme.

Nga përvoja ime profesionale mendoj që për t’i ardhur në ndihmë studentëve do të ishte më me vlerë mësimi me metodat ESP, ku të katra aftësitë bazë shqyrtohen me një fokus të përcaktuar nga fusha në të cilin studenti do të diplomohet. Ne themel të kësaj mësimdhënieje dhe mësimnxënieje sw pari, është përgatitja e studentëve për t’u përballur së pari me sfidat në fushën e tyre, ku hulumtimet për studimet pasardhëse do të jenë në gjuhën angleze, e cila është dhe gjuha e punimeve shkencore, së dyti në karrierën e tyre si individ, ku padyshim përditësimi, shkëmbimi i ideve si dhe zgjerimi i njohurive përkon me kontaktet dhe trainimet ndërkombëtare të vazhdueshme që kërkon tregu i punës, për të qenë të suksesshëm dhe të kompletuar.

Gjuha angleze përfshihet edhe në kurrikulat e universiteteve private. Në disa prej tyre, programet *Master* ofrohen edhe në gjuhën angleze. Kjo natyrisht bën të mundur ngritjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të arsimit shqiptar në përgjithësi e sidomos të arsimit të lartë. Kjo sepse të rinjtë tanë, njohës të disa gjuhëve, janë të aftë të përballen krejt lehtësisht me sfidat e integritimit. Për këtë më së shumti u vjen në ndihmë gjuha angleze, e cila tashmë gëzon pozicionin kryesor të gjuhëve që përdoren sot në botë.

Edhe politikat e tanishme vëmendje të veçantë i kushtojnë mësimin të gjuhës angleze, duke e konsideruar atë në tërësi si një kriter.⁸

Nga ana tjetër në Shqipëri kemi edhe një sërë mekanizmesh që mundësojnë përhapjen e gjuhës angleze. Kështu, një sërë

projektesh vijnë nga Korpusi i Paqes, të cilat do të zbatohen për fuqizimin dhe përhapjen e gjuhës angleze në Shqipëri.⁹ Sipas drejtuesit të kësaj organizate, ky është programi më i madh i të mësuarit të anglishtes si gjuhë e huaj. Ndërkohë, në vitet në vijim është planifikuar që mesatarisht rreth 60 vullnetarë të japin kontribut për mësimdhënien në shkolla dhe po ashtu të atashohen edhe në nivelin universitar. Po ashtu, sëbashku me Kombet e Bashkuara organizohet një konferencë e përvitshme, e cila po e rrit ndikimin e saj për përhapjen e anglishtes.

Zgjerimi i anglishtes në universitetet private shqiptare, do të rrisë cilësinë e universitetit si dhe do t'i bëjë të mundur studentit përvetësimin e shkencave dhe njohurive të reja që e afrojnë rininë shqiptare me botën e zhvilluar.

Kjo nismë e qeverisë shqiptare është e vlerësuar dhe thuhet që përvëç rritjes së numrit të anglisht-folësve, do të përmirësohet edhe përgatitja e brezave pasardhës në të gjitha rrugët e jetës që ato mund të zgjedhin si për shkollim, punësim, integrim , shkëmbim etj.

Përfundime

Gjuha angleze tanimë personifikon integrim, globalizim, unifikim dhe një ndihmesë për arritje dhe përshtatje me të gjitha standardet të kërkuara nga Bashkimi European. Është gjuha angleze, që bën të mundur komunikimin me të gjithë botën, na shërben në të gjitha fushat e jetës dhëe si rrjedhojë një zgjerim dijesh dhe njohurish. Qeveria shqiptare duke futur gjuhën angleze në kurrikulën e studimeve universitare si private ashtu edhe shtetërore i ka dhënë asaj një rëndësi kryesore në zgjerimin e dijeve të brezave të ardhshëm, një integrim të suksesshëm në komunitetin european ku dhe aspirojmë të bëjmë pjesë në një të ardhme të afërme.

Bibliografi

- Agar, M. (1991). The biculture in bilingual. *Language-in-Society*, 20, 167-181
- Crystal, D. (2003) *English as a Global Language*, Cambridge University Press
- Firth, A. (1996). 'The discursive accomplishment of normality. On "lingua franca" English and conversation analysis'. *Journal of Pragmatics* 26: 237–59.
- Sapir, E. (1958). *Culture, language, and personality* . Berkeley, CA: University of California Press
- The Common European Framework of Reference for Languages, Cambridge University Press
- Whorf, B. L. (1956). *Language, thought, and reality: selected writings of Benjamin Lee Whorf*.
- <http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2007-04-01-voaI-85739527/442252.html>
- <http://shqiptarja.com/kulture/2730/rendesia-e-anglishtes-peleshi-eshte-kriter-rol-te-madh-ne-tregun-e-punes-211022.html> , 15.05.2015

Referenca

¹ Whorf, B. L. (1956). Language, thought, and reality: selected writings of Benjamin Lee Whorf.

² The Common European Framework of Reference for Languages, Cambridge University Press

³ Sapir, E. (1958). Culture, language, and personality . Berkeley, CA: University of California Press

⁴ Agar, M. (1991). The biculture in bilingual. *Language-in-Society*, 20, 167-181

⁵ Crystal, D. (2003) English as a Global Language, Cambridge University Press

⁶ Firth, A. (1996). 'The discursive accomplishment of normality. On "lingua franca" English and conversation analysis'. *Journal of Pragmatics* 26: 237–59.

⁷ <http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2007-04-01-voa1-85739527/442252.html>

⁸ Shih për këtë: <http://shqiptarja.com/kulture/2730/rendesia-e-anglishtes-peleshi-eshte-kriter-rol-te-madh-ne-tregun-e-punes-211022.html> , 15.05.2015

⁹ Po aty

English learning, at private universities, a contribution to European Integration and more

Dr. Lediana BESHAI
ShLUJ “Wisdom University”

Abstract

We are all aware of the key role that the English language plays in the Albanian society, especially these last two decades. English is seen as the “lingua franca” and as such it enables us to build up an effective and productive communication in consolidating successful relationships with other countries of the world. Furthermore, proficiency in this language leaves no room for misunderstandings and erroneous interpretations. Given that one of the most controversial issues today is: ‘Albania towards the European integration and its entry into the great European family’, it must be emphasized that cooperation with foreigners is a way to success and reach this initiative, aiming at achieving standards which are not so easy, but not impossible. Hence, establishing a collaboration or exchanging ideas, experiences, etc., the language is a bridge and this language is the English language, due to the fact that, although 24 languages are the official languages of the European Union and recognized as such, in practice only two find a wide use officially, it is French and English, the latter is widely used and has many advantages over the French language. Consequently, the need for English language proficiency is noticed. Precisely for this reason the Albanian government has made it part of the curriculum starting from the third grade of primary school. Extending it up to the university level. So, the priority given to the English language is evident.

The purpose of this paper is to observe the use of the English language, which is a necessity and part of the curriculum even at private universities so that the students of these universities will be updated and consistent with the latest research in the branch that they study, because most of the information that it is helpful to enhance and enlarge their knowledge is in English. Acquiring the English language leads to expansion of knowledge on various fields of study aiming to meet European standards, leading to a more rapid integration of Albania in the EU

Keywords:

university, foreign language, curricula, teaching



Jonela CANAJ

Strategjitë e sigurisë evropiane dhe Koncepti Strategjik i NATO-s

13




Abstrakt

NATO dhe CEE (Kmniteti Ekonomik Evropian) kanë lindur nga një projekt i paqes, por kanë ndjekur rrugë të ndryshme. E para ka të bëjë me mbrojtjen kolektive të anëtarëve të saj, dhe e dyta është një organizatë me funksione të ndryshme. Në këtë punim paraqitet një pasqyrë e historisë së integritit evropian në fushën e politikës së jashtme dhe të mbrojtjes. Prandaj, fokusi është historik, por ka konsiderata të një analize politike. Një pjesë e këtij punimi i është përkushtuar krejtësisht të kuptuarit të marrëdhënieve mes BE-së dhe NATO-s. Një pasqyrim i zhvillimit dhe evolimit që NATO ka adoptuar në konceptin e sigurisë në marrëdhëniet ndërkombëtare na lejon të kuptojmë se si BE-ja është e vetmja organizatë e vërtetë që promovon sigurinë bashkëpunuese. Gjë që ka qënë shumë e vështirë për tu arritur. Gjithashtu ky punim synon të ofrojë një analizë krahasuese të Strategjisë së Sigurisë Evropiane dhe Konceptit Strategjik të NATO-s dhe të Strategjisë së re të Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Duke marrë shkasë nga konflikti në Ukrainë mund të kuptojmë shumë nga Bashkimi Evropian dhe nga NATO, se si këto ndërvepruan në këtë rast dhe se si kanë ndërvepruar gjithashtu në raste të ngjashme. Shkelja e sovranitetit të një vendi është e pa tolerueshme nga ana e këtyre dy organizatave jo vetëm për të qëndruar “besnik” rendit të ri botëror pas Luftës së Ftohtë por edhe për një paqe të gjatë dhe mbi të gjitha të qëndrueshme, që është mëse e domosdoshme për çdo vend dhe për çdo marrëdhënie ndërkombëtare. Edhe pse Bashkimi Evropian mbrohet në tërësi vendet që bëjnë pjesë por jo vetëm, NATO është mishërimi i forcës së saj ushtarake. Çdo ndërhyrje ushtarake bëhet nëpërmjet ushtrisë dhe forcave të armatosura të saj.


Fjalët kyçe:

BE, politika e jashtme, integritim, siguria ndërkombëtare, NATO.



Hyrje

Marrdhëniet e jashtme kanë qënë nga aspektet më delikate të bashkimit europian për shkak të rezistences së shteteve që bëjnë pjesë në të. Progresi në këtë sektor ka qënë le të themi në një farë mënyre i kufizuar nga frika e zbehjes së marrdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikes, dhe këtu hyn në lojë NATO, që është një organizatë ndërkombëtare së cilës Europa i është drejtuar dhe vazhdon edhe sot e kesaj dite ti drejtohet përsa i përket mbrojtjes së saj. Kjo për rrjedhojër dhe pasojë të faktit se Europa nuk ka një ushtri të saj të përbërë nga ushtarë të vendeve anëtare për mbrojtjen e teritoreve apo për një mbrojtje efikase në rast sulmi. Kjo mënyrë e të mbrojturit sic është quajtur ndryshe edhe “mbrojtja jo perfekte”, e vendosur nga Aleanca Atlantike me konsensusin e shumë qeverive Europiane ka bërë që integrimi në fushen ushtarake të ishte për një kohë të gjatë një “tabu”. Me frikën përshembull se ndërhyrja në Korenë e Veriut do të ishte një provë e përgjithshme e një lufte të tretë botërore, Keshilli i Europes ka aprovuar më 1950 projektin e një ushtrie europiane të prezantuar nga Winston Churchill. Ky propozim u prit me një entuziazëm të madh nga liderat e mëdhenj europian siç ishin francezët¹. Në vitin 1954 ka patur një ngërç të madh në integrimin e Bashkimit Europian për shkak të mos ratifikimit të traktatit themelor të Komunitetit Europian të Mbrojtjes nga ana e parlamentit francez me frikën e humbjes së forcës së tyre ushtarake. Edhe vdekja e Stalinit në fund të luftës në Kore e ka bërë çështjen e mbrojtjes

shumë urgjente dhe të domosdoshme. Komuniteti European i Mbrojtjes u zëvendësua me Bashkimin European Perëndimor që i bashkangjitet NATO-s dhe e plotëson atë por jo në shkallë kontinentale. Pa buxhet dhe pa një aktivitet ushtarak të ngritur Komuniteti European Perëndimor nuk mundi të bënte shumë por gjithsesi rriti besimin e bashkëpunimit European. Me falimentimin e Komunitetit European të Mbrojtjes, integrimi european ka kaluar nga një rrugë ushtarake në një rrugë ekonomike. Kështu që integrimi european atë që nuk arriti ta bënte mbi bazen ushtarake duhet ta ndërtonte mbi një bazë dhe një rrugë të integritimit ekonomik.

1. Politika e jashtme e mbrojtjes

Integrimi në sektorin e politikës së jashtme është zhvilluar me një hap të lehtë deri nga fillimet e viteve tetëdhjetë. I vetmi zhvillim konkret i kësaj periudhe ishte raporti i Luksenburgut në 1970 me të cilin, Franca, Belgjika, Vendet e Ulta, Luksenburgu, Republika Federale Gjermane dhe Italia kanë krijuar Kooperimin Politik European. Qëllimi i këtij koopoerimi ishte zhvillimi dhe vënija në një pikë dhe bazë kryesore zhvillimin e marrdhënieve me jashtë të Bashkimit European. Kooperimi Politik European vazhdoi punimet e tij deri në fillimet e viteve nëntëdhjetë si një rregullator dhe koordinator i përfaqësive diplomatike dhe ministrive të jashtme. Rruga e gjate që Bashkimi European ka përshkuar, vërtetoi më së miri se do të ishte e pamundur që ky bashkim të ndihej i plotësuar pa një politikë të jashtme të mbrojtjes. Kjo gjë u ndie edhe në disnivelin që filloi të krijohej midis rritjes së madhe të peshës ekonomike të Bashkimit European dhe ndikimit të tij të limituar në arenën ndërkombëtare. Më 1986 me firmosjen e Aktit të Përbashkët European, vendet që bënin pjesë në të impenjoreshin të bënin një politikë të jashtme të përbashkët edhe në vizionin e një identiteti european. Europa ka filluar të ndryshojë dhe ta vërë në dukje ndryshimin e saj me hyrjen

në fuqi të traktatit të Maastricht më 1993. Këto ndryshime kishin të bënin me politikën e jashtme duke filluar dhe projektet për një Politikë të Mbrojtjes të Bashkimit Europian. Kështu që shtyllat e Bashkimit Europian ishin tre: Bashkimi Europian (CECA, Euratom, CE), PESC (Politika e Jashtme dhe e Mbrojtjes së Përbashkët) dhe Kooperimi i Marrdhënieve të Brëndshme dhe Juridike. Shtylla e dytë e Bashkimit Europian karakterizohet nga një bashkëpunim ndërqeveritar që është një metodë tipike e organizatave ndërkombëtare. Kjo metodë jep më shumë liri veprimi qeverive që vendosnin me një unanimitet. Shtylla e tretë e Bashkimit Europian ka në dispozicion disa instrumenta juridik si psh pozitat e përbashkëta, në bazë të së cilave vendet që bëjnë pjesë në Bashkimin Europian duhet të kenë një politikë të jashtme të përbashkët; veprimet e përbashkëta, nëpërmjet të cilave shtetet që bëjnë pjesë mobilizojnë rezerva të ndryshme për të përmbushur objektivat e Komisionit². PESC mbron së jashmi vlerat më të rëndësishme të Bashkimit Europian ku respektohet e drejta e shteteve si dhe e drejta dhe liritë e njeriut dhe garantohet gjithashtu mbrojtja e vendeve që bëjnë pjesë në të, gjithmonë duke respektuar të drejtën ndërkombëtare. Që në fillimet e viteve nëntedhjetë Bashkimi Europian sillet si një aktor ndërkombëtar i mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Me traktatin e Amsterdimit që hyri në fuqi më 1999, PESC ju shtuan dy mjete të reja të funksionimit si: strategjitë e përbashkëta, të vendosura nga Komisioni që vendosin objektivat, kohëzgjatjen dhe mënyrat që Bashkimi Europian dhe vendet pjesëmarrës në të duhet të vënë në dispozicion; marrveshjet ndërkombëtare të firmosura nga Bashkimi Europian me anë të së cilave merr fuqi PESC. Traktati i Amsterdimit i ka dhënë të drejtën PESC për trajtimin e dialogut politik me vendet e treat. Politika Evropiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë është projektimi i jashtëm i interesave të Bashkimit Europian në promovimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Ai jep kontribut në afirmimin e një pranie aktive

ndërkombëtare në botë dhe krijimin e vazhdueshëm të një identiteti të vetëm të mbrojtjes evropiane. Kufijtë e legjislacionit aktual në këtë fushë janë parë nën dritën e rolit të ri që Evropa dëshiron në botë, si një aktor në sigurinë dhe propozimet për reformën institucionale të Traktateve ndërkombëtare që kanë qënë për disa vite në qendër të debatit politik për integrimin evropian. Traktati Kushtetues dhe Traktati i Lisbonës duke qënë çelësi për zhvillimin e ardhshëm të Politikës Europiane të Mbrojtjes dhe të Sigurisë në një mjedis rregullator që kërkohet sot për manaxhimin e operacioneve në zonat e krizës, ka një fleksibilitet më të madh racionaliteti dhe funksionaliteti. Efektiviteti i operacioneve është i kufizuar nga shumë faktorë duke filluar nga vështirësia e arritjes së një marrëveshje mes shteteve anëtare për çështjet e Politikës Europiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë me nevojën e të forcuarit dhe për të modernizuar kornizën institucionale dhe procedurat për fillimin e transaksionit. Për këtë qëllim, Traktati i Lisbonës dhe Traktati Kushtetues veprojnë duke ofruar zgjidhje efektive institucionale. Ata veprojnë duke modifikuar dhe zgjeruar kuadrin dhe hapesirën e Politikës Europiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë e cila nxjerrë në pah fuqinë edhe pse jo të përdorur në shume raste në manexhimin e krizës dhe rrisin aftësi civile dhe ushtarake që mund të bëhet shtylla mbajtëse e saj³.

2. Roli i politikës europiane të sigurisë dhe mbrojtjes

Roli i Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes analizohet në lidhje me organizatat e tjera ndërkombëtare të sigurisë, jo e vetme, si NATO dhe OKB. Duke rritur bashkëpunimin me NATO në nivel institucional ka çuar në përfundim të disa marrëveshjeve të cilat rregullojnë bashkëjetesën midis institucioneve. Me OKB, lidhjet funksionale ekzistuese në kuader të nenit II të Traktatit të Bashkimit Europian bëjnë që Politika Europiane e Mbrojtjes dhe Sigurisë të jetë një mjet në duart e Këshillit të Sigurimit për manexhimin e krizës, por përfaqësimi i Bashkimit

European është i detyruar të veprojë në kuadër të Kombeve të Bashkuara dhe kjo pengon bashkëpunimin konstruktiv në interes të sigurisë ndërkombëtare. Përdorimi i mirë i bërë në nenin 19 të Traktatit të Bashkimit European dhe personaliteti ligjor të Bashkimit mishëruar në Traktatin e ri të Lisbonës duket se është zgjidhur së bashku me çështjen e përfaqësimit të jashtëm, çështjet e përputhshmërisë të strukturave dhe mekanizmave të ndryshëm të Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Një nga pikat që dolën me qartësi më të madhe përgjatë debatit të gjatë politik dhe në punën përgatitore të Konventës që çoi në lindjen e Traktatit për një kushtetutë evropiane të nënshkruar në Romë më 29 tetor 2004 ishte si rrjedhojë e nevojës për të patur gjithmonë e më shumë “Evropë” në marrëdhëniet ndërkombëtare. Deri më tani për politikë të jashtme të Bashkimit Evropian ishte emëruesi i përbashkët i politikave individuale të jashtme kombëtare, veprimi i jashtëm i Bashkimit Evropian është i copëzuar dhe vetëm në raste të veçanta ka arritur të jetë koherent dhe unitar.

Ambicia dhe efikasiteti i Politikës të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë gjithashtu ishte parashikuar nga Traktati i ri kushtetues. Por kjo nuk mund të përcaktohet vetëm me formula institucionale por varet edhe nga vullneti politik për ta zbatuar atë plotësisht⁴. Zhdukja automatike e Politikës së Jashtme dhe Mbrojtjes Kombëtare nuk është qëllimi i Bashkimit European, cdo politikë e brendshme e shteteve që bëjnë pjesë në Bashkimin European është e mirëpritur por duhet gjithsesi të favorizojë politikën e përbashkët të Bashkimit European. Një politikë e Përbashkët e Jashtme ka për qëllim tu japë mundësinë shteteve anëtare të organizojnë një konsultim më të shpejtë në çështje specifike të natyrës ndërkombëtare, flet me një zë, duke vepruar drejtëpërdrejtë në bashkëpunim. Presioni i situatës ndërkombëtare që ka ndikuar historikisht në gatishmërinë e vendeve evropiane për tu bashkuar në një integrim pak a shumë të ngushtë është i njëjtë me atë në kontekstin e paqëndrueshmërisë që të çon

në Evropë në mënyrë të pavarur bazuar në vlerat e të cilave do të nxisë dhe të ndajnë se çfarë duhet të jetë roli i saj në jetën ndërkombëtare.

Bashkimi European ka tërhequr një Politikë të Sigurisë të profilit më të lartë dhe efikasitet më të madh operacional ashtu sic shihet dhe në nenin 41 të Traktatit të Ri të Romës (29 tetor 2004) ku specifikohen mundësi për të përdorur burimet civile dhe ushtarake në misionet e jashtëme të Bashkimit European, për të ruajtur paqen, për të parandaluar konfliktet dhe mbrojtjen e sigurisë ndërkombëtare në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Përveç kësaj, në fushën delikate të Politikës Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Traktati i Romës parashikon krijimin e vazhdueshëm të një politike të përbashkët të mbrojtjes duke filluar nga një agjensi e vetëme për armët që kanë filluar të marrin formë që nga viti 2003, një ndërqeverisje e Francës dhe Britanisë së Madhe. Pavarësisht nga rezultati i ratifikimit, duhet pranuar se pjesë të konsiderueshme të këtyre masave tashmë janë prezantuar në mënyrë të pavarur nga Traktati nëpërmjet vendimeve parandaluese të Këshillit Evropian (KE) ⁵.

Konkluzione

Politika e Jashtme e Përbashkët dhe Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes vjen si nevojë për të zgjidhur në mënyrë sa më efektive problemet në vende të ndryshme të botës. Bashkimi European ndjen një detyrim politik dhe moral të imponohet si mjeti më i mirë i sigurisë. Nuk është vetëm për rrjedhojë të pozitës të saj gjeopolitike që siguria e Bashkimit European ngelet edhe sot e kësaj dite një pikë kyçe në kontekstin e politikës ndërkombëtare. Europa pas një mundimi të gjatë dhe një kohe të gjatë të jostabilitetit të saj dhe si një faktor pasiv në arenën ndërkombëtare, sot e kësaj dite ajo ka ndryshuar. Ka krijuar një karakter të fortë politik dhe jo vetëm. Ka krijuar stabilitat edhe pse probleme të ndryshme mund të ekzistojnë. Por ajo çka spikat më shumë

është se si ajo kërkon të përhapë vlerat e saj dhe kërkon të jetë një faktor tashmë aktiv në arenën ndërkombëtare. Dhe ka qënë pikërisht ky fakt që e ka shtyrë atë të krijojë një Politikë të Jashtme të Përbashkët por jo vetem. E shtyrë nga dëshira për të qënë siç përmendëm më lartë, aktive në arenën ndërkombëtare, ajo kërkon dhe një Politikë të Sigurisë dhe të Mbrojtjes që tashmë është e domosdoshme edhe për të treguar karakterin e fortë të saj⁶.

Vendet e Bashkimit European kanë krijuar forca ushtarake të përbashkëta që nuk mund të shihen thjeshtë si një mbështetje e shtyllave mbi të cilat NATO mbështetet por shumë më shumë se kaq.

Edhe pse një ushtri e vetme e Bashkimit European nuk ekziston, forca e saj ushtarake mishërohet nepermjet NATOS. Prandaj dhe ekziston një ndërveprim i këtyre dy organizatave; ku përberja mund të jetë e ndryshme. NATO përbehet nga shtetet e Bashkimit Eurpian por jo vetem. Ka shtete që nuk bëjnë pjesë në Bashkimin European por janë pjesë e NATO-s. Japin kontributin e tyre ushtarak dhe përpiqen për arritjen e një Politike të Sigurisë dhe Mbrojtjes të përbashkët. Duke dashur të kaloj pragun e asaj Europa që deri tani është quajtur “Europa civile” dhe duke u shtyrë akoma më tutje për një “Europe ushtarake”, atëherë është e domosdoshme jo vetem Politika e Jashtme e Përbashkët që ajo përdor, por dhe Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes⁷. Është e vërtetë që sfidat e politikës ndërkombëtare kanë ndryshuar, nuk është vetëm kanosja sovjetike që dominon ashtu si në Luftën e Ftohtë por ka një sërë problematikash të tjera. Duke qënë se Europa ka ardhur duke u zgjeruar edhe perfaqesimi i saj në arenën ndërkombëtare ka ardhur duke u forcuar. Megjithëse hija e Bashkimit Sovjetik vazhdon të ekzistojë. Në Moskë Presidenti Vladimir V. Putin nënshkroi një dekret ku një zyrtarisht Krimenë si një “shtet sovran dhe te pavarur”, hedhjen e bazave për aneksimin dhe për të sfiduar Shtetet e Bashkuara

dhe Evropën vetëm pak orë pasi ata vendosën sanksione financiare kundër tyre. Zoti Putin nënshkroi dekretin e tij natën vonë, pasi rajoni shpalli pavarësinë më parë gjatë ditës dhe i kërkoi Rusisë ta aneksojë atë në përputhje me rezultatet e referendumit kryer nën mbikqyrjen e trupave ruse. Moska ka mbetur e patrembur nga presioni përëndimor që ka krijuar të çarën më të thellë në marrëdhëniet Lindje-Perëndim që nga fundi i Luftës së Ftohtë dhe që kërcënoi rishikimin e kufijve të përcaktuara nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik në 1991.

Parlamenti ukrainas në Kiev miratoi një dekret presidencial që autorizon thirrjen e 20.000 rezervistëve. Qeveria e përkohshme ka rritur buxhetin ushtarak me ndarjen emergjente prej rreth 680 milion dollarë. Moska u zhvendos për të mirëpritur mbrapa Krimenë, e cila ishte pjesë e Rusisë shekuj kaluar. Konsensusi në Moskë ishte aq i madh sa që edhe udhëheqësi i fundit sovjetik Mikhail S. Gorbachev roli i të cilit në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik është fyer thellësisht në Rusi, miratoi masën për Krimenë duke i thënë agjensisë së lajmeve Interfax se pavarësia e saj “duhet të jete e mirëpritur dhe nuk ishte dakort me shpalljen e sanksioneve.”

Ai shtoi se “Nëse deri më tani ishin bashkuar në Ukrainë për shkak të ligjeve sovjetike që janë marrë pa pyetur popullin, atëherë tani njerëzit kanë vendosur për të ndrequr këtë gabim”⁸.

BIBLIOGRAFI

- Natalino Ronzzeti, *Forcat e Paqes të Bashkimit Europian*, Shtëpia Botuse Rubbettino, Romë, Itali 2005.
- Gianni Bonvicini, *Bashkimi Europian aktor i sigurisë rajonale dhe globale*, FrancoAngeli srl, Milano, Itali 2010, f. 21.
- Antonio Converti, *Institucionet e Bashkimit Europian*, Shtëpia Botuse Halley, f. 104, 106, 108.
- *Politika e jashtme e Bashkimit Europian*, shtëpia Botuse Morlacchi, 2007, f. 43.
- Steven Lee Myers and Peter Baker, *The New York Time*, 17 Mars 2014.

Referencat

- ¹ Natalino Ronzzeti, *Forcat e Paqes të Bashkimit Europian*, Shtëpia Botuse Rubbettino, Romë, Itali 2005.
- ² Gianni Bonvicini, *Bashkimi Europian aktor i sigurisë rajonale dhe globale*, FrancoAngeli srl, Milano, Itali 2010, f. 21.
- ³ Po aty, f. 28
- ⁴ Antonio Converti, *Institucionet e Bashkimit Europian*, Shtëpia Botuse Halley, f. 104.
- ⁵ Po aty, f. 106.
- ⁶ Po aty, f. 108.
- ⁷ *Politika e jashtme e Bashkimit Europian*, shtëpia Botuse Morlacchi, 2007, f. 43.
- ⁸ Steven Lee Myers and Peter Baker, *The New York Time*, 17 Mars 2014.

European security strategy and the Strategic Concept of NATO

Jonele CANAJ

Abstract

NATO and the EEC were born from a project of peace, but have followed different paths. The first has to do with the collective defense of its members, and the second is an organization with different functions. In this paper presented an overview of the history of European integration in the field of foreign policy and defense. The focus is historical, but political consideration are under analysis. A part of this paper is entirely devoted to understanding the relationship between the EU and NATO. An overview of the development and evolution that NATO has adopted the concept of security in international relations allows us to understand how the EU is the only organization that really promotes cooperative security, which has been very difficult to achieve. Also, this paper aims to provide a comparative analysis of the European Security Strategy and the Strategic Concept of NATO's new strategy and National Security of the United States. Spurred by the current conflict in Ukraine we can understand many of the European Union and NATO, how these interacted in this case and how they interacted also in other similar cases. The violation of the sovereignty's country is intolerable by those two organizations not only to stay "loyal" to the new world order after the Cold War but also for lasting peace and above all sustainable, that is more than necessary for each country and for each international interaction. Although the European Union as a whole protects countries that comprise but not limited to, NATO is the incarnation of its military force. Any military intervention made by the army and its armed forces.

Keywords

E U, Foreign Policy, Integration, International Security, NATO.



Jonida Drogu
ShLUIJ "Wisdom University"

Liria e medias, shtrirja dhe ndikimi i saj në politikë

14

Abstrakt

Cili është roli i medias dhe gazetarit në përgjithësi në jetën kulturore e krahasur me format tjera tradicionale siç është libri, në kohën e sotme ku produktet mediale zënë hapsirën më të madhe të konsumimeve kulturore? “Media shërben për të transformuar kulturën nacionale, për të respektuar standartet dhe vlerat e besimit dhe të përkushtimit dhe kjo e tëra do të ngrejë dilemen e ringritjes së stereotipeve dhe paragjytimeve. Bota sot është e dominuar nga stereotipet dhe paragjykimet e krijuara nga ndikimi i madh i përmbajtjeve mediale”. Media profesionale në raste të tilla, duhet të ketë parasysh anët psikologjike e sociologjike të një shoqërie, në mos realizimin ose kopjimin e përmbajtjeve mediale që i përkasin formatit kulturor medial të krijuar për/ose në shoqëri të tjera. Por, epoka e globalizimit me krijimin e korporatave të mëdha multinacionale mediale, e bënë që efekti i paragjytimeve dhe stereotipeve të këtë zhvillim me të gjerë. Në këtë punim do trajtohet një analizë mbi motorin medial dhe ndikimet e tij nga këndvështrimi i Amarta Sen bazuar edhe në analizat e saj, specifikisht “Zhvillimi si Liri” për tu inkuadruar më pas edhe në realitetin shqiptar.

Fjalët kyçe:

Media, liria, kultura mediatike, zhvillimi si liri, globalizmi, sociologjia mediatike



Hyrje

Zhvillimi si liri, është një kontribut në debatin bashkëkohor të zhvillimit. Kjo analizë është trajtuar duke u bazuar në veprën “Zhvillimi si Liri, e Amartya Sen” (1999).

Shtjellimi i konceptit liri ka qenë sfidues për shumë autorë kur kanë krahasuar dhe analizuar kuptimin e vetë termit nga antika deri në ditët e sotme. Politika si koncept, veprimtari dhe profesion përfaqëson një shtrirje të gjerë duke ndeshur mendime të ndryshme rreth specifikave dhe rolit që ka luajtur në jetën politike gjatë gjithë historisë. Ndërkaq, media si veprimtari që e njohim sot është relativisht e re, në kuptimin e transmetimit të lajmit, lidhjes dhe komunikimit që ka realizuar mes njerëzve dhe vendeve.

Duke marrë lirinë si ‘kapacitet’, Sen, ofron një vend filozofiko-konceptual të zhvillimit per-se. Vërtetë që titulli i veprës, nuk lë hapësirë për argumentim për çka saktësisht do të thotë Amartya Sen me zhvillim, por në këtë botim përballemi me 2 pyetje esenciale të cilat do ti paraqesim edhe në punim; çdo të thotë liria? Çfarë lidhje ka midis lirisë dhe zhvillimit.

Në këtë trajtesë përpjekja është për të vlerësuar nocionet e Sen (Amarta Sen) për zhvillimin, si dhe lirinë, dhe në disa pika krahasuar apo vendosur ato në realitetin shqipëtar duke i kontekstualizuar ato edhe me interpretimin e konceptit të zhvillimit, që është një konceptualizimin holistik i këtij termi të gjerë, deri në atë masë që ajo mbulon në masë të konsiderueshme aspektet politike, sociale dhe ekonomike,

siç shkruan ai për të hetuar procesin e zhvillimit në aspektin përfshirës, që të integrojë konsideratat ekonomike sociale dhe politike '(Sen, 1999: 8). Me një kuptim të tillë të gjerë, detyra për të vlerësuar zhvillimin në praktikë është një nga sfidat kryesore.

Sen e konsideron 'lirinë', si makinë e procesit të zhvillimit dhe gjithashtu si 'skajet kryesore të zhvillimit' (ibid: 6), prandaj, 'making' lirinë, në fund të fundit do të thotë që përpjekjet e zhvillimit të jenë realizuar. Interpretimi i tij për lirinë mund të kuptohet si 'liri pozitive', që do të ndihmojë për të njohur lirinë në gjithë dimensionet. Në përpjekjen për të bërë lidhjen mes zhvillimit dhe lirisë, Sen argumenton se liria është thelbësore për procesin e zhvillimit **për dy arsye**, a) **arsyeja vlerësuese**, që është "vlerësimi i procesit e duhet të bëhet kryesisht në aspektin, nëse liritë që njerëzit kanë janë të zgjeruara; 'dhe b) **arsyeja e efektivitetit**", dhe se arritja e zhvillimit është tërësisht e varur në agjencinë e lirë të njerëzve' (ibid: 4).

Sen jo më kot vendos në konceptin e lirisë-me një ndërlidhje me atë ekonomik, pra kufizimi ekonomik mund të sjellë edhe kufizimin e lirisë sociale (ibid: 8). Kjo mund të konsiderohet si lidhja midis dy koncepteve të zhvillimit dhe lirisë. Liria paraqitet si një ide abstrakte, dhe Sen është përpjekur për të instrumentalizuar lirinë duke futur pesë lloje të dallueshme të lirive të njeriut,

- a) liritë politike
- b) objektet ekonomike,
- c) mundësitë shoqërore,
- d) garantimi transparencës
- e) garantimi i sigurisë mbrojtëse,

dhe pastaj argumenton se secila prej këtyre të "drejtave dhe mundësive të ndihmon për të çuar përpara kapacitetin e pergjithshemte një personi '(shtuar, Sen, 1999:10).

Zhvillimi nuk ndodh në një vakum, ajo kërkon rruge dhe drejtim, cka do të thotë, se individi nuk mund perfitojë jashtë shoqërisë, dhe shoqëria nuk do ta mbështesë atë pa një

procedurë të caktuar socio-ekonomiko-politik të rendit, në përputhje me rrethanat, si kunder Sena argumenton se “duke pasur parasysh karakteristikat personale, social prapa vijues, rrethanat ekonomike dhe kështu me radhë, pra kur një person ka aftësinë për të bërë disa gjëra për arsye vlerëike (ibid: 293). Kjo paraqet faktor me të cilin nenkuptohet se individi është i vendosur të jetë i lirë dhe në një sistem në të cilin ai mund të ushtrojë liritë e tij / saj.

Duke vepruar kështu, ai shkon për tej lirisë individuale të gjendjes, por duhet theksuar se ai nuk duhet të veprojë vetëm përmes shtetit “por duhet të përfshijë edhe institucionet e tjera, organizatat politike dhe sociale, të bazuara në komunitet marrëveshjet, jo-qeveritare, agjencive të llojeve të ndryshme, media dhe mjete të tjera të mirëkuptimit dhe komunikimit publik... tregut dhe marrëdhëniet kontraktuale (ibid: 289).

Lidhur me sa me sipër, shtrojme pyetjen; a ka ndikuar media dhe sa është real ndikimi i saj, sa është shtrirja e medias si koncept, si kompani me prodhimet e saj mediale, që e lidhin median dhe ndikimin e saj mbi proceset dhe ngjarjet e përgjithshme shoqërore e politike?

Arsyet e zgjedhjes së kësaj teme do të fokusohen me se shumti sipas trajteses të përmendur edhe më sipër të Amartya Sen: Zhvillimi si Liri;

· Duke qene se **media** sot, gjithënjë e më shumë po luan rol themelor në mënyrën e jetës sonë brenda shoqërisë, duke marrë pjesë intensivisht si faktor në edukimin, zhvillimin dhe orientimin e shoqërisë përmes produkteve të ndryshme mediale/mediatike.

· Duke qene se media sot, gjithënjë e më shumë po arrin të përcaktojë orientimin dhe bindjen e publikut ndaj fenomeneve shoqërore dhe në veçanti shtrirjen dhe ndikimin në procese politike përmes ndikimit në krijimin e opinionit publik.

· Duke qene se, sot, media gjithënjë e më shumë po dëshmohe si faktori kyç në proceset dhe zhvillimet e shekullit XXI si: **terrorizmi, globalizimi, çështjet globale, forcimi i demokracisë , dhe fuqizmi i gruas në jetën politike...etj.**

Këto arsye janë të mjaftueshme për të nxitur rreflektim të mundshëm për të përcaktuar konceptualisht ndikimin e lirisë në media si faktor në proceset shoqërore, dhe arrijen në analizim dhe krahasimin e etapave historike, faktorëve të ndryshëm politik e social që ngrihen.

Vendi ose hapsira ku vepron një media është e ngjashme me një kompani ose korporatë e cila merret me prodhimin e produkteve të ndryshme. Në këtë rast televizioni, shtypi, agjensitë e ndryshme informative shtrijnë veprimtarinë e vet me një objekt të caktuar, me burokraci, administratë etj. Se cili është produkti i tyre, me çka jetojnë ato, është tejet e rëndësishme, në këtë kontekst se çfarë bëjnë mediat është pyetja esenciale. “ Korporatat e mëdha mediale nuk mund të jetojnë pa ngjarje të mëdha. Dhe kur ato ngjarje të mëdha nuk ekzistojnë, duhet të krijohen”¹.

Media kryesisht paraqet lidhjen në mes masës ose publikut të gjerë mbi ngjarjet që ndodhin, qofshin ato të shpikura nga ana e medias për ta ushqyer me diçka publikun, sepse në fakt ky është zanati i një punonjësi në media. Kur mendojmë këtë lidhje media-masë atëher “togfjalëshi ‘Mas-Media’, mjete të komunikimit masiv, paraqet tërësinë e rrugëve dhe të mënyrave për informimin e shoqërisë dhe bashkëbisedimin me publikun përmes fjalës së shtypur, si dhe zërit, fotografisë statike e dinamike, përkatësisht në radio, në televizion, etj”². Pra, lidhjen apo komunikimin në këtë mes e bënë media.

Sesa është reale dhe objektive pasqyrimi i ngjarjeve dhe lajmeve, i mbetet gjykimit dhe pranimi të shikuesit. Sepse “media konstrukton realitetin, gazetari fotografon realitetin e mjegullt. Në epiqendër të medias është gazetari, gazetari është sinonim i informimit”³. Kjo le të kuptohet bindjen se

gazetari pasqyron realitetin e një situate të caktuar për ta bartuar atë përmes transmetuesve medial në jetën kulturore të një publiku gjithnjë e më të gjerë.

Cili është roli i medias dhe gazetarit në përgjithësi në jetën kulturore e krahasur me format tjera tradicionale siç është libri, në kohën e sotme ku produktet medial zënë hapsirën më të madhe të konsumimeve kulturore? “Media shërben për të transformuar kulturën nacionale, për të respektuar standartet dhe vlerat e besimit dhe të përkushtimit, dhe kjo e tëra do të ngritë dilemen e ringritjes së stereotipeve dhe paragjykimeve. Bota e sotme është e dominuar nga stereotipet dhe paragjykimet e krijuara nga ndikimi i madh i përmbajtjeve mediale”⁴. Media profesionale në raste të tilla, duhet të ketë parasysh anët psikologjike e sociologjike të një shoqërie, në mos realizimin ose kopjimin e përmbajtjeve mediale që i përkasin formatit kulturor medial të krijuar për një shoqëri tjetër. Por, epoka e globalizimit me krijimin e korporatave të mëdha multinacionale mediale, e bënë që efekti i paragjykimeve dhe stereotipeve të këtë zhvillim të gjerë.

Këtë ndikim kulturor e shfrytëzojnë më së shumti në krijimin e përmbajtjeve mediale për qëllime politike, me që rast Max Weber te Politika si Profesion citon thënien “se punonjësi i shtypit sa vjen e më shumë e humb ndikimin politik, kurse gazetari i shtypit sa vjen e më shumë fiton ndikim politik”⁵. Pushteti politik këtë fakt nuk e duron dot, rritjen e ndikimit të medias në çështjet publike duke shfaqur pozicionin e tyre që “politikanët do të dëshironin gazetarët të vepronin si një zonë transportuese neutrale për paraqitjet e tyre dhe shtypin e lirë”⁶.

Në këtë rrafsh të definimit të konceptit të medias dhe rolit të saj në shoqërinë e sotme, dallojmë median si organizatë ose kompani prodhuese e përmbajtjeve mediale, që përmes mekanizmave teknologjike të depërtojnë në masë. Këtë depërtim media e realizon përmes televizionit, gazetave e deri te arritjet e fundit teknologjike të informimit si interneti

etj. Më qëllim formësimin e opinionit publik dhe ndikimit më të gjerë kulturor me përmbajtjet mediale, me efekt kryesor e kanë shtrirjen sa më të madhe të influences dhe dominimit politik mbi shoqërinë.

2. Llojet dhe etapat e zhvillimit të medias

Zhvillimi i medias nga formati kur dikur kishte funksione informimi, deri në kohët e sotme kur media lufton për treg dhe ndikim, ka kaluar një periudhe të gjatë dhe vështirë. Zhvillimi i medias ka qenë ndikuar nga zhvillimet politike e sidomos ato teknologjike. Vendet e varfëra e sidomos vendet totalitare si Shqipëria kanë mbajtur gjithmonë nën kotrollin e tyre veprimtarinë e medias, si mënyrë për të shtypur dhe mbajtur nën kontroll shoqërinë dhe sistemin politik. Por, ndryshimet ideologjike, rritja kapaciteteve teknologjike duke “shfrytëzuar sistemin digital, ndikoi në rrënimin e kufijve të mbyllur apo oazat e krijuara”⁷, nga elitat politike totalitare.

Ndërsa të paraqitura nga aspekti i sotëm i veprimit të medias, media “veprimin e tyre e realizojnë kryesisht nga katër pozita të ndryshme: **E para**, ‘në kuadër të shtetit’, që nënkupton llojin dhe pozicionin e veprimit të medias e krijuar dhe udhëhequr nga aparti i shtetit, model i të cilës e kemi pas në periudhën komuniste, që ishte një tv dhe gazetë si organ zyrtar i partisë-shtet dhe kishte monopolin e informimit publik. **E dyta**, ‘si pjesë e lëvizjes politike apo e partisë’, është model i krijimit dhe veprimit të medias edhe në kohët e sotme, që krijohen organizata mediatike, rrjete sociale në internet, në kuadër të një lëvizje politike, pra partie, me qëllim informimin e publiku për politikën e saj. **E treta**, ‘përmes korporatave private’, është lloj tipik i veprimit të medias në kohët e sotme si ndërmarrje private me bazë përfitimin, si pjesë e modelit të demokracisë liberale për treg të lirë. Dhe **e katërta**, ‘përmes ndërmarrjeve publike’⁸, model që qëndron edhe sot, e krijuar nga shteti, qeveri apo parlament, dhe e cila financohet dhe kontrollohet përmes

mekanizmave publik, gjithmonë në interesa të saj.

2. Plani global

Por, vendi dhe modeli që ka bërë ndryshimin rrënjësor në përhapjen e lirisë së informacionit dhe ndikimit të tij politik, është modeli amerikan i njohur si “Free flow of information”⁹. Ky model medial u krijua dhe u përhap “ në funksion të shtrirjes së lirisë, apo edhe të shtrirjes financiare të SHBA-së, me këtë model dhe fuqi, SHBA-të kanë qenë në gjendje ta kthejnë parimin medial ‘free flow’ në parim politik edhe në organizatën ndërkombëtare për edukim, shkencë dhe kulturë, UNESKO”¹⁰. Free flow është bërë tani parim demokratik i shtrirjes së ndikimit dhe influencës amerikane nga një pozicion agresiv tregtare përmes interesave të mediave në SHBA.

Duke analizuar këtë model dhe koncept të veprimit të medias së lirë, medias si korporatë që vepron në efekte të profitit material, pra “modelit komercial, Eduard S. Herman dhe Robert V. Mekcesni, në librin “Te Global Media”, analizojnë gjithë faktorët historikë, ekonomike dhe politike që ndikojnë në shek XX, në sistemin global medial, duke vecuar dominimin e madh të sistemeve të fuqishme transnacionale”¹¹, të cilat sipas ligjeve të tregut veprojnë si industri mediale”, sic është rasti i CNN, Al Jazeera etj. Sot ende vazhdon rivaliteti i gjithë këtyre llojeve dhe modelve mediale që kanë bazë modelin komercial me ‘median publike’, “ të konceptuara si transmetues të shërbimit publik, pjesë e hapësirës shoqërore, politike dhe kulturore të një vendi”

¹². Media e përkryer publike thuhet se sot nuk ekziston me gjithë raportet dhe fushat e mirë përcaktuara me mekanizmat e kontrollit dhe financimit. Sepse një media publike, thjeshtë duhet të përcaktojë “tre fusha të funksionimit të saj profesionale, sic janë “pavarësia financiare, menaxheriale dhe pavarësia editoriale”¹³. Të tri këto fusha janë të ndërlidhura dhe kanë një ndikim dirket në mbarëvajtjen e përgjithëshme të medias publike.

Në shumicën e vendeve, nuk po flas për ato vende që refuzojnë sistemin e qeverisjes demokratike dhe shtypinë liritë themelore të njeriu (Kina, Korea e Veriut, Kuba dhe shumë shtete latino-amerikane, në Afrike e Azi), por edhe vendet që janë në tranzicion dhe kanë arrit të konsolidojnë parimet e demokracisë, akoma nuk kanë arritë të ndërtojnë media të lira dhe larg ndikimeve të pushtetit politik.

2.1 Media shqiptare, sot

Si pjesë e zhvillimeve të përgjithëshme shoqërore, media në kohën e sotme ka shënuar një zhvillim dhe masivizim të madh në jetën politike e kulturore në të gjitha vendet e botës. Ky definim jo i qart, nënkuton hapsirën dhe rolin ndikues që ka media, në kuadër të proceseve të përgjithëshme ekonomike, dhe proceset e globalizimit në shek. XXI.

Media sot është mjet përçues jo vetëm i ngjarjeve që ballafaqohet realiteti i një shoqërie, por përçues i fjalës dhe veprimit të lirë. Sot shumica e shtetve demokratike në ligjet e tyre themelore, me norma ligjore kanë siguruar e garantuar hapësirën e lirë të shprehjes dhe veprimit të medias. Pavarësisht, që “lira e të shprehurit, liria për të shfaqur atë që mendojmë, parakupton një atmosferë sigurie, nuk është e mjaftueshme që liria të jetë e mbrojtur nga ligjet: është e nevojshme edhe që të mos ekzistoj frika”¹⁴, thekson studiuesi i zellshëm i lirisë si zhvillim, Sen. Medias shqiptare, sot, në këtë aspekt i nevojitet jo vetëm siguria dhe garantueshmëria ligjore për veprimet e saj, por pranimi i saj nga shoqëria e në veçanti politika. Ideologjia e qeverisjes së sotshme, demokracia¹⁵, parakupton lirinë e medias të pacënuar të shprehjes dhe veprimit medial.

2.3 Liria e medias dhe raportet e saj me pushtetin në Shqipëri

Liria e medias në Shqipëri dhe raportet e saj me pushtetet janë të ndryshme dhe interesante si nga konteksti historike ashtu dhe ai politik. Përgjithësisht, as Shqipëria nuk bën

përjashtim rreth trajtimit të medias dhe lirisë së saj gjatë periudhës komuniste nga vendet tjera lindore të Europës, por duhet parë më shumë në kontekstin e natyrës unike të sistemit vetqeverisës në Shqipëri. “Media ishte pronë shtetëore, të organizuara në dy sisteme të mëdha, ai i radiotelevizionit dhe gazetat e revistat informative e kulturore”¹⁶, zakonisht në shërbim të klasës politike e ideologjike. Por, nese krahasohet me mediat e pjeses tjetër te vendeve te lindjes, mund te themi se gjatë kësaj kohe, liria e veprimit te mediave shqiptare ishte zero.

Me ardhjen e demokracise, mediat pësuan një goditje të rëndë (rilindase) për tu transformuar në media gjithmone e me pak të survejuara apo monitoruara për të realizuar forma të ndryshme për informimin e publikut rreth situatës politike që po kalonte vendi. U krijuan ndërkohe gazeta të ndryshme, ndër to mund të përmendim edhe Koha Tone. Ndërsa, mediat digjitale si tv, u realizuan në mënyrë satelitore përmes inkuadrimin të një pjese informative të Radio Televizionit Publik Shqiptar, RTSH.

Pas viteve 92-93 fillon një erë e re e veprimit të medias në shqipëri dhe funksioneve të saj në raport me shoqërinë dhe pushtetin politik. Ndihej më shumë në krijimin e mediave dhanë institucionet ndërkombëtare në të gjitha format, dhe dhënies së donacioneve kryesisht nga USAID në krijimin dhe zgjerimin e games mediatikekombetare.

Por, sa mund të jenë këto media të lira dhe autonome nga ndikimet e pushtetit politik kur dijmë nivelin e zhvillimit demokratik të shqiptarëve. Sot, televizioni publik, vazhdon të financohet nga qytetarët por influenca e kësaj medie është e kapur dhe ndikuar nga oragjet qeveritare, sepse ka një shumicë që zgjedh bordet dhe përmes tyre, partia në pushtet e zgjedh njerëz të afërt duke kontrolluar kështu politikën mediatike të RTV.

Për më shumë në miratimin e kodit penal nga po ky Kuvend që dhe ka themeluar televizionin publik, shkel në mënyrë flagrante të drejtata dhe liritë e individit dhe lirinë e plotë të

veprimi gazetareskë. Përmes kësaj politika duke mos duruar dhe mos arritur të kontrolloj të gjitha mediat, penalizon dhe frikëson të drejtën dhe lirinë e informacionit. Për këtë çështje dhe mënyrë veprimi të politikës ka pas reagime të forta, si nga organizata apo agjensi të ndryshme europiane, Human Right Watch, Freedom House etj.

Edhe pse nuk mund të mohohet progresi, gazetarët dhe mediat në Shqipëri akoma ballafaqohen me presione, krahas mungesës së mbrojtjes institucionale dhe mungesës së vullnetit politik për të siguruar media të lira e shumë sfida të tjera. Reufizimi i institucioneve që gazetarët të shohim dhe të kenë qasje të lirë në informacione kur këtë e parasheh edhe ligji për qasje në dokumentat zyrtare po bëhet nga “mungesa e vullnetit politik është arsyeja kryesore se pse ky ligj nuk po zbatohet në mënyrë të duhur. Redaktorët dhe analistët theksojnë se qasja në informacione është duke u përdorur si një mjet politik për të ndalur mediat të cilat kritikojnë qeverinë dhe për të shpërblyer subjektet mediatike që kanë një reflektim pozitiv”¹⁷. Pra, trysnia dhe presioni në punën mediatike është i vazhdueshëm dhe jo fort i lire për të ardhmën demokratike të shqiperise.

C’ndodh sot me informacionin mediatik: Informacioni që nevojitet për të bërë një përjasje sipas Sen, përben një shkallë të lartë vleresuese. Përjashtimet e informacionit janë elemente të rëndësishme të përjasjes vleresuese pasi që informacioni i përjashtuar nuk lejon që të ketë ndikime të drejtperdrejta në arsyetimet vleresuese.

Se fundmi, gjendja financiare të mediave të ndryshme e rëndon veçanërisht procesi i “çmediatizimit të reklamës”. Nëse media e deritanishme në një masë të madhe ka qenë e financuar nga reklama që kishte natyrë masive, pra nuk i drejtohej thjesht një publiku të përcaktuar dhe nuk matej në forma rigorozë për sa i përket efikasitetit të saj, reklama online gjithnjë e më pak kalon medoemos nga web e mediave, por kalon kryesisht nga motorët e kërkimit dhe nga faqet e

portaleve të ndryshme që kanë më shumë vizitorë. Efikasiteti i saj matet me numrin e klikimeve mbi reklamën

3: Konkluzion

Ndikimi thelbësor që ka media në raport me politikën, e kemi theksuar, se e bart problemin ose më mirë thënë vëmendjen e studiuesve në pikën që media konsiderohet rivale e politikës. Bile media për këtë shkak është dhe vazhdon të konsiderohet edhe më fort si formë e katërt ose pushtet i katërt, për nga roli dhe ndikimi mbi shoqërinë. Ndikimi i medias shtrihet përmes një mënyrë krejt origjinale, në formësimin dhe drejtimin e opinionit publik mbi çështjet e caktuara publike. Do të ishte e padrejtë, të mos pranohej hapur roli thelbësor i medias në informimin e gjerë të publikut, ndërsa në rrethanat e sotme demokratike, media më së lehti e shtrinë ndikimin e saj në mendjet e njerëzve për një ide apo pikëpamje politike.

Sot koncepti dhe roli i medias, ka rrjedhur pra është zhvilluar krahas edhe zhvillimeve të përgjithëshme shoqërore, demokratike e globalizuese. Media i ka kontribuar shumë zhvillimit dhe triumfalizmit ideologjik të demokracisë gjatë shek XX. Por edhe media në këtë rast ka përfituar shumë, si pjesë themelore e parimeve demokratike. Aq shume ka ndikuar media në proceset shoqërore, sa që sot shoqëria dhe demokracia cilësohen në terma medial, pra shoqëri mediale, demokraci mediale. Edhe në anën tjetër, media përmes proceseve globalizuese, zhvillimeve teknologjike, i është mundësuar roli dhe ndikimi saj global në përhapjen e dijeve, njohjen dhe homogjenizmin e kulturave të ndryshme. Pavarësisht anëve pozitive e negative, media e ka zënë vendine saj kryesor në këtë proces.

Ndërsa analizimi i lirisë së medias në Shqipëri është interesant për faktin se e dale nga një sistem apo rregjim diktorial, që nuk njihen të drejtat dhe liritë e individit e aq më pak të medias, media u ballafaqua me nje mision të informimit të drejtë qytetar rreth situatës politike, ndryshime

te vullshme dhe problemeve që përjetuan për një kohë të gjatë tranzicioni. Media sot vazhdon problemet në konsolidimin e saj, profesionalizimin dhe kalimit të tranzicionit duke mos arritur të ikë nga kapja dhe shpordorimit të rolit dhe qëllimeve të saj nga elita politike. Cdo ditë e më shumë po shuhen zërat guximtar të medias, media po bëhet me pak profesionale dhe më e varur, cdo ditë kërcenohen gazetarët dhe miratimi i kodit penal vëlon shkeljen dhe mohimin e lirisë së veprimit të mediave në shqipëri.

Sic kemi trajtuar në fund, me theks të vecant kanë format e zhvillimit dhe ndikimit të medias, kemi analizuar konceptin media e pavarur, e cila nuk gjenë një përkrahje të madhe për faktin se nuk mund të ekzistojë pronar i medias pa një interes të caktuar. Edhe media publike që për funksion ka informimin në mënyrë të paanshme publikun, financuesi e kontrolluesi i saj, në këtë rast një organ i lartë politik ose qytetar, vështirë të arrijë të qëndrojë larg dorës ose ndikimit politik, por veprimtaria e të dyja formave mediatike duhet të bazohet nga pikëpamja profesionale e produkteve të tyre mediale në shërbim të shoqërisë.

Opinionit publik sipas Sen, është tematika e cila i lidh dhe rivalizon konceptet media dhe politik. Për arsyen e vetme se opinionit publik si matës i gjendjes ideore e politike në shoqëri, me qëndrimet dhe pikëpamjet e veta mbi çështje të caktuara shoqërore, duke mbështetur një ide dhe pikëpamje politike, për individët dhe grupet politike, është fusha që duhet kontrolluar e përmes saj të marrë dhe mbajë pushtetin politik.

Kur dihet se sot media e ka rolin kryesor në informimin e opinionit publik, meqë rast del në pah ndikimi i saj në drejtimin e qëndrimeve politike. Kjo paraqet rolin e medias në politike. Për politikën janë thelbësore qëndrimet e publiku në mënyrë që ata të arrijnë pajtim dhe ndikim në opinion, me idetë e tyre në marrjen dhe kontrollimin e pushtetit politik.

Bazuar edhe në qasjen e zhvillimit si liri mund të themi, pa e tepruar aspak mund të themi se ka lindur një ekonomi e mediave, e cila karakterizohet nga ligjësi ekonomike të reja.

Modeli ekzistues ekonomik i mediave konvencionale jo vetëm është treguar i paaftë ta përballojë gjendjen e krijuar, por edhe po karakterizohet nga paaftësia për t'i dhënë impulse të reja financiare tregut të mediave. Mbi të gjitha kanë ndryshuar rrënjësisht marrëdhëniet midis ofruesit dhe konsumatorit të informacionit.

Sen dallon rëndësinë e rolit instrumentale e demokracisë dhe të drejtën e njeriut nga rëndësia e tyre konstituive, përcaktimin e rëndësinë konstitutiv; “rritja e përgjithshme e lirive politike dhe civile është thelbësore në procesin e zhvillimit të vetë ‘(ibid: 288). Në të kuptuarit tim, konceptualizimin Sen është e motivuar me ‘liberalizmit’ (dmth. Orientimi filozofik). Individualizmi, dhe sovraniteti individual, shoqëria civile dhe toleranca, liria dhe racionaliteti, minimalstate dhe të tregut të lirë, janë tipare të përbashkëta e Liberalizmit dhe janë manifestuar në punën e Sen’ (shih, Sen, 1999).

Se fundmi, prespektiva e liberalizmi tradicional ka hyznizuar shpesh një treg të ideve pa pranuar se aty ka pabarazi strukturore, sidomos sipas klasave, gjinisë, orientimit seksual dhe ndarjes raciale. Në rrafshin ideal, modeli i ri do të jetë më tepër radikal sesa liberal. Ai do të ndërfitet në rrënjët e pushtetit duke shqyrtuar pa hezitim të gjitha idetë dhe institucionet e vjetra... Ky sistem i mediave duhet të qëndrojë në antagonizëm me interesat e fuqishme që nuk respektojnë modelin tonë politik”.

Bibliografi

1. Axford, Barrie; Huggins, Richard, 2001, *"New Media and Politics"*, shb. Sage Publications, London, Thousand Oaks, New Delhi.
2. Amartya Sen, Zhvillimisi Liri, 1999, perkthyer nga Shtepi botuesi Dudaj
3. Efikasiteti i saj matet me numrin e klikimeve mbi reklamën Malnes Raino: Mitgaard, Knut, 2007, *"Filozofia Politike"*, shb, Rozafa, Prishtinë.
4. Mareek, J Philippe; Wolfsfeld, Gadi, 2005, *"Political Communication in a New Era"*, sh.b, Taylor and Francis e-Library- Routledge, London and New York.
5. Mc Nair, Brian, 1999, *"An Introduction to Political Communication"*, shb, Routledge, London & New York.
6. Mill, S. Xhon, 1998, "Mbi Lirinë", Shb "Dukagjini", Prishtinë.
7. Ash, Timothy (2007-05-31). "The Stasi on Our Minds". *The New York Review of Books*. Retrieved 2014-11-17.
8. "Fellows: Timothy Garton Ash". *Hoover Institution*. Retrieved 12 November 2011.
9. "Governing Body Fellows: Professor Timothy Garton Ash". *St. Anthony's College*. Retrieved 12 November 2011.
10. "Timothy Garton Ash". *The New York Review of Books*. Retrieved 12 November 2011.

Referenca

- ¹Berisha, Ibrahim. "Media, Agjensët e Komunikimeve", Prishtinë, 2007, f. 32.
- ²Boriçi, H. Gjergji, B. Tirana, G. Ramabaja, S. "Gazetaria", Tiranë, 2000, f. 10-11.
- ³Berisha, Ibrahim. "Media dhe Tranzicioni", Prishtinë, 2007, fq. 49.
- ⁴Berisha, Ibrahim. "Media dhe Tranzicioni", Prishtinë, 2007, fq.19.
- ⁵Weber, Max. "Politika si Profesione", Shkup, 2006, f. 43.
- ⁶Zaller, John. "A Theory of Media Politics", Chicago, 1999, fq.2.
- ⁷Berisha, Ibrahim. "Media dhe Tranzicioni", Prishtinë, 2007 fq. 77
- ⁸Berisha, Ibrahim. "Media, Agjensët e Komunikimeve", Prishtinë, 2007 fq. 94
- ⁹Qarkullimi i lire i informacionit
- ¹⁰Berisha, Ibrahim. "Media, Agjensët e Komunikimeve", Prishtinë, 2007 fq. 110
- ¹¹Po aty, fq. 111.
- ¹²Po aty, fq. 111.
- ¹³Berisha, Ibrahim. "Media, Agjensët e Komunikimeve", Prishtinë, 2007 fq. 76
- ¹⁴Amartya Sen, Liria si Zhvillim
- ¹⁵Sartori, Giovanni. "Ç'është Demokracia", Tiranë, 1998, fq. 53
- ¹⁶Berisha, Ibrahim. "Media dhe Tranzicioni", Prishtinë, 2007, fq. 160
- ¹⁷Amartya Sen "Zhvillimi si liri"

Media freedom, the extent and its impact on policy

Jonida Drogu

ShLUJ “Wisdom University”

■ Abstract

What is the role of media and journalists in general cultural life compared to other traditional forms such as for example the book, at the present time where media products occupy the biggest space of cultural consumerism?

“Media serves to transform the national culture, to respect the standards and values of faith and devotion, and it will raise the entire dilemma of rebuilding stereotypes and prejudices. The world today is dominated by stereotypes and prejudices arising from the influence of media content.” Media professional in such cases, should take into account psychological and sociological sides of a society, the non-implementation or copying of media content pertaining to cultural media format created by other companies for other countries. At the same time the era of globalization with the creation of a large multinational media corporations, creates the effect of prejudices and stereotypes of this development with wide range of developments. It will be treated in this paper the analysis of the media engine and its impacts from the perspective of Amartya Sen based on the analysis that are specifically developed in the best seller “Development as Freedom” to be viewed in the Albanian reality.

■ Keywords:

Media, freedom, media culture, development as freedom, globalization, media sociology

